# RAPORTI VJETOR 2022

## Autoriteti i Aviacionit Civil

## Vizioni

Të jemi kredibilë dhe të pranuar globalisht si rregullator dhe autoritet mbikëqyrës i aviacionit civil, i radhitur para të tjerëve në rajon dhe më gjerë sa i përket sigurisë së aviacionit.

## Misioni

Të krijojmë një ambient të aviacionit civil në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, partneritetit me industrinë dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit.

# Përmbajtja

Përmbajtja ........ 2
LISTA E SHKURTESAVE ........ 5
1. MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM ........ 6
2. PËRSHKRIMI I AAC-së ........ 7
2.1 Baza ligjore ........ 7
2.2 Selia e AAC-së ........ 8
2.3 Struktura organizative e AAC-së ........ 8
2.4 Bordi Mbikëqyrës i AAC-së ........ 9
2.5 Ekzekutivi ........ 10
2.6 Objektivat strategjike të AAC-së ........ 10
3. AKTIVITETI I AAC-së NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR ........ 11
3.1 Normalizimi i hapësirës ajrore të Kosovës ........ 11
3.2 Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA) ........ 13
3.3 Raporti përfundimtar i KE mbi vizitën vlerësuese për zbatimin e Marrëveshjes HPEA në Kosovë dhe raporti vjetor i KE për Kosovën ........ 13
3.4 Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së ........ 15
3.5 Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO) ........ 15
3.6 Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA) ........ 15
3.7 Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil ........ 16
3.8 Projekti EASA IPA 5 ........ 18
4. AKTIVITETI LEGJISLATIV ........ 20
4.1 Përmirësimi i bazës ligjore ........ 20
4.2 Vështirësitë ligjore ........ 20
4.3 Aktet nënligjore ........ 20
4.4 Urdhëresat Administrative ........ 23
4.5 Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative ........ 23
4.6 Çështjet gjyqësore ........ 27
4.7 Komisioni për Shqyrtimin e Shkeljeve dhe Gjobave Administrative ........ 29
5. PROGRAMI SHTETËROR I SIGURISË (PSHS) ........ 30
5.1 Takimet e Komitetit të Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS) ........ 30
5.2 Aktiviteti i Këshillit të Sigurisë në AAC ........ 31
5.3 Rishikimi i Sistemit të Menaxhimit të Autoritetit ........ 32
5.4 Menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion (OR) ........ 32
6. SIGURIA E FLUTURIMEVE, CERTIFIKIMI DHE LICENCIMI ........ 35
6.1 Inspektimet e mjeteve të huaja ajrore në platformë ........ 35
6.2 Auditimet e operatorëve të aviacionit ........ 37
6.3 Transporti i mallrave të rrezikshme përmes ajrit ........ 39
6.4 Mbikëqyrja e aviacionit të përgjithshëm ........ 41
6.5 Fluturimet sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR) ........ 41

6.6 Fluturimet diplomatike ..... 42
6.7 Aktivitetet me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dronë) ..... 42
6.8 Gjobat administrative ..... 43
6.9 Raportimi i ndodhive në aviacion (OR) ..... 44
6.10 Mjekësia e aviacionit ..... 45
6.11 Mjetet ajrore të ndaluara në Kosovë ..... 48
6.12 Mjetet ajrore civile të regjistruara dhe ato të larguara nga regjistri i mjeteve ajrore civile ..... 48
6.13 Licencat, certifikatat dhe lejet e aprovuara, përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre ..... 49

7. SHËRBIMET E NAVIGACIONIT AJROR ..... 50
7.1 Mbikëqyrja e vazhdueshme e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror ..... 50
7.2 Auditimet ..... 50
7.3 Auditimi vlerësues nga EASA ..... 54
7.4 Mbikëqyrja e ASHNA-s si Organizatë Trajnuese (OT) ..... 54
7.5 Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s ..... 55
7.6 Dekomisionimi i pajisjeve/sistemeve në ASHNA ..... 60
7.7 Lëshimi i licencave për kontrollorët e trafikut ajror dhe vlerësimi i gradimeve ..... 61
7.8 Publikimi i Informatave Aeronautike ..... 62
7.9 Raportimi i obligueshëm i ndodhive ..... 62

8. AERODROMET ..... 63
8.1 Mbikëqyrja e vazhdueshme e sigurisë së aerodromeve ..... 64
8.2 Certifikimi i LKIA-së si organizatë për aftësime profesionale në fushën e aerodromeve ..... 65
8.3 Projekti i LKIA-së për asfaltimin e krahëve të rrugëve për lëvizjen e aeroplanëve në tokë në ANP "Adem Jashari" ..... 67
8.4 Zonat mbrojtëse dhe shënjimi i pengesave ..... 68
8.5 Shënjimi i linjave transmetuese ..... 70
8.6 Shënjimi i tymtarit në fabrikën e çimentos në Han të Elezit ..... 70
8.7 Ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të ANP "Adem Jashari" ..... 71
8.8 Mirëmbajtja e hapësirave në rrethinën e ANP "Adem Jashari" ..... 71

9. RREGULLIMI EKONOMIK I AVIACIONIT ..... 73
9.1 Aprovimi i tarifave aeroportuale ..... 73
9.2 Mbikëqyrja e vazhdueshme ekonomike e aeroportit ..... 74
9.3 Miratimi i Programit Nxitës 2020-2022 të LKIA-së për kompanitë ajrore ..... 74
9.4 Përmbledhja e realizimit të Programit Nxitës 2021-2022 të LKIA-së ..... 75
9.5 Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s ..... 75
9.6 Mbikëqyrja e vazhdueshme ekonomike e shërbyesve në tokë ..... 76
9.7 Kërkesat drejtuar Komitetit të PPP-së ..... 77

10. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ..... 79
10.1 Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet AAC-së dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ..... 79
10.2 Mbështetja e MPB-së në hartimin e strategjisë kombëtare për menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë ..... 80

10.3 Mbështetja e MPB-së në zbatimin e Rregullores për kërkim dhe shpëtim në aviacionin civil ..... 80
10.4 Bashkëpunimi me Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike ..... 81
10.5 Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ..... 82
11. PUBLIKIMET TEKNIKE PËR INDUSTRINË ..... 83
12. INFORMIMI I PUBLIKUT DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE ..... 84
12.1 Qasja në dokumente publike ..... 84
12.2 Faqja zyrtare e AAC-së në internet ..... 84
13. BURIMET NJERËZORE ..... 85
13.1 Pagat e personelit të AAC-së ..... 86
13.2 Trajnimet ..... 86
14. PROKURIMI ..... 87
15. RAPORTI FINANCIAR ..... 88
15.1 Raporti i buxhetit me shpenzime ..... 88
15.2 Të hyrat ..... 89
15.3 Pasuritë ..... 90
15.4 Grantet e përcaktuara të donatorëve ..... 90
15.5 Shpenzimet buxhetore ..... 91
15.6 Planifikimi / realizimi i buxhetit ..... 95
15.7 Investimet kapitale ..... 97
15.8 Tabela krahasuese e buxhetit për tre vitet e fundit ..... 97
15.9 Buxheti i AAC-së për vitin 2022 ..... 97
16. AUDITIMET NDAJ AAC-së ..... 98
16.1 Auditimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ..... 98
16.2 Auditimi i Brendshëm nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ..... 98
17. STATISTIKAT E TRAFIKUT AJROR ..... 99
SHTOJCA 1 - LISTA E TRAJNIMEVE ..... 100
SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-SË PËR VITIN 2022 DHE REALIZIMI I TIJ ..... 102
SHTOJCA 3 - STATISTIKAT E TRANSPORTIT AJROR 2022 ..... 114

# LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| **AAC** | Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës |
| **AIP** | Agjencia për Informim dhe Privatësi |
| **AMC** | Qendra e Mjekësisë së Aviacionit |
| **AME** | Ekzaminues Mjekësor i Aviacionit |
| **ANP** | Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" |
| **ASHNA** | Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **EASA** | Agjencia Evropiane për Sigurinë e Aviacionit |
| **ECAC** | Konferenca Evropiane e Aviacionit Civil |
| **EUROCONTROL** | Organizata Evropiane për Sigurinë e Navigacionit Ajror |
| **HPEA** | Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit |
| **IATA** | Asociacioni Ndërkombëtar i Kompanive Ajrore |
| **ICAO** | Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil |
| **IKAP** | Instituti Kosovar për Administratë Publike |
| **IPA** | Instrumenti i Para-anëtarësimit |
| **ISO** | Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit |
| **KE** | Komisioni Evropian |
| **KFOR** | Misioni i NATO-s në Kosovë |
| **KHAIA** | Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike |
| **KTA** | Kontrolli i Trafikut Ajror |
| **LAC** | Ligji për Aviacionin Civil |
| **LKIA** | Kompania private që operon ANP "Adem Jashari" |
| **MFPT / MF** | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| **MMPHI** | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| **MIE** | Ministria e Integrimit Evropian |
| **MPB** | Ministria e Punëve të Brendshme |
| **MPJD / MPJ** | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës |
| **MAP** | Ministria e Administratës Publike |
| **MPMS** | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| **NATO** | Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior |
| **PKZMSA** | Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së |
| **PSHS** | Programi Shtetëror i Sigurisë |
| **SAP** | Sistemi i mjetit ajror pa pilot (droni) |
| **SIMFK** | Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës |
| **SMC** | Sistemi për menaxhimin e cilësisë |
| **SPR** | Standardet dhe praktikat e rekomanduara të ICAO-s |
| **SHNA** | Shërbimet e Navigacionit Ajror |
| **ZKA** | Zyra Kombëtare e Auditimit |
| **ZKM** | Zyra e Kryeministrit të Kosovës |

# 1. MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



Të nderuar lexues,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj juve, palëve të interesuara dhe dashamirësve të aviacionit, raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Ky raport ofron një përmbledhje të të arriturave dhe veprimeve në lidhje me aviacionin civil në Republikën e Kosovës, por po ashtu shfaq edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur aviacioni civil gjatë vitit të kaluar.

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2022, ka ndërmarrë veprime të ndryshme për ngritjen e sigurisë dhe menaxhimit institucional për të përballuar sfidat dhe për të ndjekur trendet ndërkombëtare në aviacionin civil. AAC-ja ka arritur të përmbushë me sukses të gjitha aktivitetet e planifikuara mbikëqyrëse me qëllim të garantimit të operimeve të sigurta dhe në përputhje me standardet në fuqi. Kjo është arritur përmes inspektimeve, auditimeve, licencimeve dhe certifikimeve. AAC-ja poashtu ka arritur të realizojë të gjitha aktivitetet legjislative të planifikuara për vitin e kaluar.

Gjatë vitit 2022 në ASHNA dhe ANP "Adem Jashari" janë realizuar shumë projekte të rëndësishme infrastrukturore për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen e nivelit të sigurisë së aviacionit civil, të gjitha këto projekte janë mbikëqyrur dhe aprovuar sipas përgjegjësive të AAC-së.

Gjatë vitit 2022 janë ndërmarrë aktivitete për finalizimin e hapjes së korridoreve me Shqipërinë dhe pas përmbushjes së të gjitha kushteve teknike sipas standardeve ndërkombëtare, KFOR-i ka proceduar kërkesën formale për ndryshimin e NATO SPINS për të autorizuar hapjen e rrugëve ajrore me shtetin shqiptar. Kjo do të mundësojë përfundimisht që rrugët ajrore me Shqipërinë të bëhen pjesë e rrugëve ajrore në EUROCONTROL.

AAC-ja vazhdon të përballet me sfida në rrafshin tekniko-profesional të ndërlidhura me faktin që AAC-ja, për shkaqe politike jashtë fushëveprimit të saj, ende nuk është anëtare e barabartë e familjes së organizatave evropiane dhe globale të aviacionit.

AAC-ja por edhe aviacioni civil në Republikën e Kosovës kanë sfida të shumta që kërkojnë përkushtim të shtuar profesional, rritje të llogaridhënies, por edhe reforma institucionale.

# 2. PËRSHKRIMI I AAC-së

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës është themeluar si agjenci e pavarur rregullatore në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil. Nga 1 janari 2009, AAC-ja ka marrë kompetencat e plota në përputhje me këtë ligj. Në shtator të vitit 2022, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, AAC ka marrë statusin e Agjencisë rregullatore në pajtim më Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

AAC-ja është e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror nënkupton miratimin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë. AAC-ja ka kapacitet të plotë juridik dhe për punën e vet deri në shtator të vitit 2022 ju ka përgjigjur Kuvendit të Republikës së Kosovës kurse nga shtatori 2022 me hyrjen ne fuqi të Ligjit nr. 08/L-063 llogaridhënia e AAC nga kuvendi ka kaluar në qeverinë e Republikës se Kosovës.

## 2.1 Baza ligjore

Më 13 mars 2008, Parlamenti i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil. Ligji ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në pajtim me nenin 130 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili kërkon themelimin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Më dt.05 shtator 2022 është publikuar në Gazetën Zyrtarë të Republikës së Kosovës Ligji nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura. Me ketë ligj është ndryshuar statusi i AAC nga një agjenci e pavarur rregullatorë në një agjenci rregullatore, në pajtim më Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Mbikëqyrja e përformancës dhe veprimtarisë së AAC-së, me hyrjen në fuqi të ligjit 08/L-063 është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës, e cila ushtrohet nëpërmjet Ministrit përgjegjës për transport në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Ligji për Aviacionin Civil, me ndryshime, është ligj që parasheh funksionimin e AAC-së dhe rregullimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Me këtë ligj, AAC-së i janë dhënë kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore në formë të rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe vendimeve, me të cilat zbatohen më konkretisht dispozitat e Ligjit për Aviacionin Civil dhe standardeve ndërkombëtare të nxjerra nga ICAO dhe BE.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit 08/L-063 janë implikuar edhe ndryshime tjera që kanë të bëjnë me bartjen e disa përgjegjësive në fusha të caktuara nga Ministria përgjegjëse për transport tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Nga hyrja në fuqi e këtij Ligji AAC do të shqyrtoj kërkesat të operatorëve ajrorë që kanë të bëjnë më aprovimin e fluturimeve.

### 2.2 Selia e AAC-së

Selia e AAC-së është në rrugën "Zejnel Salihu" nr. 22, në Prishtinë. Me kërkesë të AAC-së, Ministria e Punëve të Brendshme kishte nxjerrë Vendimin nr. 1044/2020, më 23 dhjetor 2020, për akomodimin e AAC-së në ish objektin e Gjykatës Komunale në Prishtinë. Zhvendosja e AAC-së në këtë objekt shtetëror nga objekti privat, duke përfshirë të gjithë dokumentacionin, asetet (inventarin e zyrave, pajisjet teknologjike, etj.), është kryer në fillim të muajit mars 2021. Ky objekt ka hapësirë të mjaftueshme për numrin e nëpunësve të AAC-së, duke u ofruar atyre kushte solide për punë. Në këtë objekt shpenzimet komunale i bartë MPB-ja dhe AAC-ja lirohet nga barra e qirasë.

### 2.3 Struktura organizative e AAC-së

Në bazë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm, struktura organizative e AAC-së përbëhet nga 30 nëpunës të ndarë në njësitë administrative si në vijim:

a) Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm:
   i. Drejtori i Përgjithshëm (1);
   ii. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm (1);
   iii. Zyrtare Ekzekutive (1); dhe
   iv. Zyra për Çështje Ligjore të Aviacionit (1);
b) Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve (7);
c) Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror (4);
d) Departamenti i Aerodromeve (4);
e) Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit (3);
f) Departamenti për Siguri dhe Cilësi (1); dhe
g) Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore (6).

Organogrami i AAC-së:




* Pozita të planifikuara për rekrutim

## 2.4 Bordi Mbikëqyrës i AAC-së

Në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil, veprimtaria e AAC-së mbikëqyrej nga Bordi Mbikëqyrës i AAC-së, i cili përbëhej nga pesë anëtarë. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-063 Bordit Mbikëqyrës të AAC-së i ka pushuar mandati i tij dhe si rrjedhojë është shpërbërë.

Bordi vepronte me orar jo të plotë dhe duhej të takohej së paku një herë në çdo tremujor kalendarik. Kryesuesi përfaqësonte Bordin në publik dhe menaxhonte e organizonte punën e Bordit. Vendimet e Bordit merreshin me shumicë votash dhe kishte kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve nëse ishin të pranishëm së paku tre anëtarë. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të AAC-së janë emëruar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/34, të datës 07.10.2020. Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së i ka dorëzuar Bordit Mbikëqyrës raportet gjithëpërfshirëse të punës së AAC-së për dy tremujorët e parë të vitit 2022.

Bordi Mbikëqyrës i AAC-së ka qenë funksional deri më 21 shtator 2022.

## 2.5 Ekzekutivi

AAC udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm, si organi më i lartë i drejtimit ekzekutiv dhe administrativ. Në punën e tij të përditshme ai mbështetet nga strukturat udhëheqëse.

Drejtori i Përgjithshëm ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime, dhe në përputhje me ligjet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike, përfshirë këtu menaxhimin dhe raportimin e rregullt financiar. Ai punon me orar të plotë. Drejtori i Përgjithshëm është zyrtar i AAC-së, i cili është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe vendimmarrjen në AAC. Sipas nenit 26 te Ligjit nr 08/L-063 mbikëqyrja e performancës dhe veprimtarisë se AAC-se është përgjegjësi e Qeverise se Kosovës, e cila ushtrohet nëpërmjet Ministrit përgjegjës për transport në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive te Pavarura.

## 2.6 Objektivat strategjike të AAC-së

AAC-ja përcjell Objektivat Strategjike për periudhën pesëvjeçare 2019-2023, të hartuara dhe miratuara në fund të vitit 2018. Objektivat strategjike i shërbejnë AAC-së si bazë e mirë për planifikimet vjetore që i bën organizata.

AAC-ja gjatë vitit 2022 ka përcjellë objektivat strategjike në vijim: Zbatimi i plotë i përgjegjësive rregullatore; Normalizimi i hapësirës ajrore; Zbatimi i Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS); Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare (ky objektivi nuk varet nga AAC-ja); Lidhja e marrëveshjeve teknike ndërkombëtare dhe rajonale.

Gjatë hartimit të planit të performances për vitin 2023, objektivat janë ri-definuar duke u përqendruar më shumë në përgjegjësit e AAC dhe funksionet mbikëqyrëse të AAC-së, si:

1. Plotësimi i legjislacionit sekondar;
2. Certifikimi i operatorëve, licencimi i personelit dhe mbikëqyrja e vazhdueshme; dhe
3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstitucional dhe normalizimi i hapësirës ajrore.

# 3. AKTIVITETI I AAC-së NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR

## 3.1 Normalizimi i hapësirës ajrore të Kosovës

Hapësira ajrore e Kosovës që nga shtatori i vitit 1999 është pjesë e "Hapësirës së Përbashkët Operacionale të Ballkanit – JOA" të NATO-s, nën kontrollin operacional të Qendrës së Kontrollit të Operimeve të Kombinuara Ajrore 5 (Combined Air Operations Control 5 - CAOC5), e cila në vitin 2014 është transferuar te Qendra Torrejon e Operimeve të Kombinuara Ajrore (Combined Air Operation Centre Torrejon CAOC TJ). Kjo hapësirë ajrore është hapësirë e kontrolluar, në të cilën ofrohen shërbime të trafikut ajror.

Në bazë të marrëveshjes në mes të NATO/KFOR-it dhe Hungarisë, hapësira e lartë ajrore e Kosovës (mbi 6205 m ) që nga prilli i vitit 2014 menaxhohet nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë, HungaroControl, i cili u ofron shërbime mjeteve ajrore që e mbikalojnë këtë hapësirë. Vazhdimi i ofrimit të këtyre shërbimeve nga HungaroControl është bërë në vitin 2019, pas përfundimit të periudhës pesëvjeçare të filluar në vitin 2014.

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës (nën 6205 m) menaxhohet/kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), e cila ofron shërbime të navigacionit ajror për aeroplanët civilë gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës me qëllim të aterrimit dhe ngritjes nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Gjithashtu, shërbime ofrohen edhe për fluturimet e KFOR-it, EULEX-it dhe fluturimet e aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të vendit. Hapësira e ulët ajrore është e klasifikuar si hapësirë e klasit D dhe G, në përputhje me dispozitat mbi klasifikimin e hapësirës ajrore nga Aneksi 11 i ICAO-s.

**Hapësira e ulët ajrore e Kosovës**

Në hapësirën e ulët ajrore aktualisht janë vetëm 2 korridore që përdoren për trafik komercial për vajtje-ardhje nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari". Këto janë XAXAN dhe SARAX në pjesën jugore të Kosovës në drejtim të Maqedonisë së Veriut.

Në kuadër të diskutimeve për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, më 18 qershor 2020 ASHNA ka nënshkruar Letër Marrëveshje me ofruesin shqiptar të shërbimeve AlbControl Tirana ACC (Area Control Center), përmes së cilës janë hapur edhe dy pika tjera, KUKAD dhe ARBER, në kufirin me Republikën e Shqipërisë, të cilat mund të shfrytëzohen për koordinim të fluturimeve, siç është paraqitur në Figurën 1.

Pikat KUKAD dhe ARBER janë pika të cilat në baza taktike mund të përdoren për koordinim të trafikut komercial ndërmjet ASHNA-s dhe AlbControl-it, mirëpo të njëjtat ende nuk janë të planifikueshme për fluturime (flight plannable).




Figura 1. Pikat e reja, KUKAD dhe ARBER për koordinimin e fluturimeve me Tirana ACC

Pas përfundimit të luftës, hapësira e lartë ajrore e Kosovës ka qenë e mbyllur për mbikalime të mjeteve ajrore civile, dhe nën autoritetin e NATO-s. Kjo hapësirë u hap për fluturime komerciale në vitin 2014, nën menaxhimin e HungaroControl-it. Kontrollorët tanë të trafikut ajror ofrojnë shërbime në hapësirën e ulët ajrore dhe menaxhojnë ngritjet dhe aterrimet në/nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, si dhe fluturimet tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës (të kryera në shumicën e rasteve nga helikopterët e KFOR-it).

Gjatë vitit 2022, nuk ka pasur takime në kuadër të takimeve për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (BANM).  Por janë zhvilluar takimet të rregullta të AAC dhe ASHNA me KFOR dhe ICETRA për të finalizuar hapjen e korridoreve me Shtetin Shqiptar. Si rezultat i përfundimit të të gjitha kërkesave teknike lidhur me hapjen e rrugëve ajrore me Shqipërinë, dhe pas vlerësimit të KFOR përmes ICETRA se hapja e

rrugëve ajrore me Shqipërinë i plotëson të gjitha kushtet teknike sipas standardeve ndërkombëtare, KFOR ka proceduar kërkesën formale për ndryshimin e NATRO SPINS për të autorizuar hapjen e rrugëve ajrore me Shqipërinë. Kjo përfundimisht ka mundësuar rrugët ajrore me Shqipërinë të bëhen pjesë EUROCONTROL.

Gjithsesi, këto pika ende nuk janë duke u përdorur si Flight Plannable (Flight), pasi që është e nevojshme të kryhen veprime nga Albcontrol dhe AACSh për të bërë ndryshimet e nevojshme në Network Manager (EUROCONTROL). Sidoqoftë tani pas publikimit të SPINS nuk ka asnjë kufizim për ndryshimin e atributeve të këtyre pikave (ARBER dhe KUKAD) në Network Manager.

### 3.2 Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA)

Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit - HPEA (*ang. European Common Aviation Area - ECAA*) është një marrëveshje multilaterale e cila krijon treg unik dhe rregulla të përbashkëta në fushën e aviacionit, e nënshkruar në mes të qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian, Islandës, Norvegjisë dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor. UNMIK-u e ka nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të Kosovës dhe e ka deklaruar atë përkohësisht të aplikueshme më 10 tetor 2006. Republika e Kosovës, përmes Deklaratës së Pavarësisë, përveç tjerash, ka marrë përsipër të gjitha detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë edhe ato të nënshkruara në emrin e saj nga UNMIK-u. Këto detyrime përfshijnë edhe zbatimin e Marrëveshjes HPEA. Zbatimi i Marrëveshjes HPEA në Republikën e Kosovës është bërë i detyrueshëm përmes Ligjit për Aviacionin Civil dhe që nga viti 2015 përmes Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje është i paraparë nëpër dy faza tranzitore. Sipas vlerësimit të KE-së, janë dy çështje të mbetura për kalimin e Kosovës në Fazën II të HPEA-së: zbatimi i Direktivës për kohën e punës dhe heqja e një dispozite në Ligjin e Aviacionit për të drejtat e udhëtarëve. Edhe pse Kuvendi ka amenduar Ligjin për aviacionin civil në kuadër të racionalizimit të agjencive dhe ndryshimit të linjave të raportimit në vitin 2022, nuk është hequr dispozita e përmendur më lartë. Gjatë vitit 2022 nuk është proceduar në Kuvend Ligji i ri i punës përmes të cilit planifikohet të zbatohet Direktiva për kohën e punës.

AAC-ja mban të freskuar në faqen e saj zyrtare në internet "Tabelë Ekuivalence Acquis Communautaire - legjislacion i Republikës së Kosovës në fushën e aviacionit" që pasqyron legjislacionin kombëtar që transponon legjislacionin që rrjedh nga Marrëveshja HPEA në rendin e brendshëm juridik.

### 3.3 Raporti përfundimtar i KE mbi vizitën vlerësuese për zbatimin e Marrëveshjes HPEA në Kosovë dhe raporti vjetor i KE për Kosovën

Raporti përfundimtar i vizitës vlerësuese të ndërmarrë në vitin 2020 i është dorëzuar AAC-së nga Komisioni Evropian më 17 qershor 2022. Raporti është shpërndarë te institucionet e vlerësuara si dhe është përgatitur një përmbledhje me gjetjet e

identifikuara në raport. Sipas raportit final, Kosova ka përmbushur Fazën I të Marrëveshjes, me përjashtim të kërkesës për fshirje të Nenit 95.2 të LAC dhe transpozimit të Direktivës për kohën e punës.

Raporti vlerëson se transpozimi i saktë i rregullave të HPEA për mbrojtjen ekonomike dhe të konsumatorit është arrit në masë të madhe me vetëm një çështje të mospërputhjes në Ligjin për Aviacionin Civil (neni 95.2) që kërkon rregullim, dhe e cila është ende në proces. Lidhur me lëminë e Menaxhimit të Trafikut Ajror, është vërtetuar se Kosova ka përmbushur të gjitha kërkesat për krijimin e Autoritetit Mbikëqyrës Kombëtar. Kërkesa për ndarjen e Ofruesit të Shërbimit të Trafikut Ajror dhe Autoritetit Mbikëqyrës Kombëtar (AAC) është përmbushur. Kosova ka mbyllur pothuajse të gjitha rekomandimet që vijnë nga vlerësimi i EASA-s i kryer në nëntor 2016.

Sa i përket sigurisë së aviacionit, raporti thotë se Kosova tashmë ka miratuar pothuajse plotësisht të gjitha rregullat e sigurisë dhe zbatimin e ndërlidhur, në një nivel që është mbi kërkesat për përfundimin e Fazës I. Si përfundim i përgjithshëm, kushtet e përcaktuara në marrëveshjen për të përfunduar Fazën I janë përmbushur pothuajse plotësisht. Lidhur me hetimin e aksidenteve ajrore, vlerësimi ka treguar zbatim pothuajse të plotë efektiv, me një përjashtim në lidhje me planin e emergjencave të aksidenteve të aviacionit civil. Gjithashtu, ka shqetësim në lidhje me kohëzgjatjen e punësimit të stafit të KHAIA-s. Në përgjithësi Kosova plotëson kërkesat relevante të HPEA në fushën e aerodromeve. Poashtu në raport shënohet si mangësi pamundësia e Kosovës për t'iu qasur organizatave ndërkombëtare. Sa i përket sigurimit të aviacionit, raporti konstaton se aktivitetet e monitorimit të pajtueshmërisë së aeroportit dhe entiteteve tjera të rregulluara, kryhen nga autoriteti përkatës rregullisht, por jo plotësisht në pajtim me Rregulloren (KE) 18/2010. Thuhet se duhet të ndërmerret ri-trajnim dhe certifikim i inspektorëve kombëtarë, për t'iu mundësuar atyre zbatimin e metodologjisë së standardizuar për monitorimin e një grupi të plotë të kërkesave të BE-së dhe klasifikimin e saktë të gjetjeve.

Më 12 tetor 2022, KE ka publikuar Raportin për Kosovën për vitin 2022.

Sipas përkthimit zyrtar, Raporti në pjesën e Transportit Ajror thotë:

***Lidhur me transportin ajror, Kosova është pjesë e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) dhe mbulohet nga marrëveshjet e qiellit të vetëm evropian. Sektori vazhdon të përballet me një numër sfidash që dalin nga mungesa e anëtarësimit të Kosovës në disa organizata ndërkombëtare të aviacionit civil. Mangësitë institucionale të agjencisë së shërbimit të navigacionit ajror dhe autoritetit të aviacionit civil, si dhe mungesa e të ardhurave nga menaxhimi i hapësirës së sipërme ajrore janë po ashtu janë çështje. Riorganizimi i ardhshëm i autoritetit të aviacionit civil dhe reformat administrative duhet të pasqyrojnë parimet e reformës së administratës publike, si dhe rrethanat dhe kërkesat specifike të sektorit të aviacionit. Kosova vazhdoi të përafrohet me acquis të BE-së sipas marrëveshjes së ECAA-së. Inkurajohet që të vazhdohet puna për të harmonizuar me pikat e mbetura të fazës së parë të ECAA-së. Zgjerimi i pistës në aeroportin e Prishtinës dhe instalimi i sistemeve***

***të reja të aterrimit, navigimit, metrologjisë dhe radiokomunikimeve pritet të rrisin nivelin e sigurisë së operacioneve ajrore.***

### 3.4 Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

AAC-ja ka raportuar me shkrim në ZKM për përgatitjen e Takimit të VI të Nën-Komitetit për Transport të datës 15 mars 2022 lidhur me progresin e arritur që nga raportimi i kaluar. Në konkluzionet e takimit identifikohen dy çështje të dala nga Marrëveshja HPEA: fshirja e paragrafit 95.2 të Ligjit për aviacionin civil dhe transponimi i Direktivës për kohën e punës.

Agjenda e Takimit të VI të Komitetit për MSA e mbajtur më 23 nëntor 2022 nuk ka paraparë ndonjë temë në agjendë për aviacionin.

Për vitin 2022, AAC-ja ka planifikuar dhe zbatuar transponimin e 7 rregulloreve të BE-së. Realizimi i PKMZSA 2022 nga ana e AAC është 100% për vitin 2022.

### 3.5 Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)

ICAO është agjenci e specializuar e OKB-së, e cila nxjerr standarde ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, të detyrueshme për 193 shtetet e saj anëtare. AAC luan rol mbështetës ndaj Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës kur të merret vendimi politik për të aplikuar për anëtarësim në këtë organizatë. Në tetor 2022, AAC ka komunikuar me MPJD lidhur me kërkesat që ata kanë pasë për këtë çështje meqë sipas MPJD ekziston mundësia që ICAO të futet në listën e organizatave me prioritet për t'u anëtarësuar.

### 3.6 Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA)

AAC-ja ka vazhduar përpjekjet për të lidhur marrëveshje teknike të quajtura "Aranzhime të punës" me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (ang. European Aviation Safety Agency - EASA). EASA është agjenci e specializuar e BE-së, me përgjegjësi në fushën e sigurisë së aviacionit civil. Këto aranzhime do t'i mundësonin AAC-së qasje në bazën evropiane të të dhënave të sigurisë së aviacionit (ECCAIRS - Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve), do të krijonin kornizën e nevojshme për inspektim të performancës së AAC-së nga EASA si dhe për asistencë nga EASA në zbatimin e plotë të dispozitave përkatëse të Marrëveshjes HPEA. Deri më tani, EASA nuk ka hyrë në aranzhime kontraktuale me AAC-në për arsye të natyrës politike, jashtë fushëveprimit dhe mundësive të AAC-së apo institucioneve tjera të Republikës së Kosovës.

Në përgjigje të letrës së DP të AAC-së dërguar EASA-s të datës 20 dhjetor 2021, më dt. 28 janar 2022 është përgjigjur Drejtori Ekzekutiv i EASA i cili ka thënë se nuk e shohin të nevojshme një tjetër vizitë të EASA në AACK në Kosovë në vitin 2022. Megjithatë, EASA ruan mundësinë për të vepruar në baza ad hoc në rast të ndonjë rrethane të

paparashikuar. Sa i përket kërkesës së AAC-së në Kosovë për t'iu bashkuar grupeve këshillimore të EASA-s dhe për të fituar qasje në bazat e të dhënave të administruara nga EASA, ai thotë se kanë marrë parasysh kërkesën dhe janë në konsultime me Komisionin Evropian për këto çështje dhe se do të njoftojnë sapo të kenë informacione të mëtejshme.

Në vitin 2016 AAC kishte bërë kërkesë për shfrytëzimin e shërbimeve te EGNOS *Safety of Life (SoL)* për nevoja të ASHNA, por që kërkesa nuk ishte trajtuar pasi që për shfrytëzimin e këtij shërbimi ishte kërkuar një miratim nga EASA, por kjo agjenci nuk e kishte lëshuar asnjëherë këtë deklaratë për Kosovën.

Gjatë vitit 2022, AAC ka përsërit kërkesën për shfrytëzimin e shërbimeve EGNOS dhe është trajtuar kërkesa me KFOR dhe ICETRA, dhe pas disa diskutimeve me KFOR, kërkesa e AAAC është përkrahur edhe nga KFOR dhe ICETRA dhe kemi pranuar konfirmin se EASA do te realizoj një vizitë vlerësuese gjatë vitit 2023 dhe do të mundësoj shfrytëzimin e këtij shërbimit për ASHNA.

### 3.7 Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil

AAC-ja i kushton rëndësi të madhe bashkëpunimit me autoritetet homologe të rajonit, duke marrë parasysh se të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë duke kaluar nëpër të njëjtën sfidë - atë të harmonizimit të legjislacionit, rregullave dhe standardeve në aviacionin civil me ato të BE-së. Për të formalizuar këtë bashkëpunim, janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh për bashkëpunimin teknik që nga themelimi i AAC-së në vitin 2009.

Në vazhdën e koordinimeve të aktiviteteve të nisura në dhjetor të vitit 2020, edhe gjatë këtij viti janë zhvilluar disa aktiviteteve në lidhje me përdorimin e hapësirës së Kosovës për procedurën e uljes në aeroportin e Kukësit. Përdorimi i hapësirës së Kosovës për procedurën e uljes në aeroportin e Kukësit është ndryshim që afekton hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës si i tillë është trajtuar nga SHNA, sipas procedurës për ndryshime, sipas manualit të SHNA-së. Ky ndryshim është trajtuar edhe në pjesën e këtij raporti që ka të bëjë me ndryshimet. Deri në ndryshimet në NATO SPINS që është paralajmëruar nga KFOR se do te ndodhë në janar të vitit 2023, publikimi i RMZ1 është bërë përmes NOTAM.

Departamenti i aerodromeve ka vazhduar edhe më tutje bashkëpunimin ndërshtetëror midis Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe AAC-ve të rajonit. Gjatë vitit 2022, në kuadër të marrëveshjes dypalëshe, inspektorët e aerodromeve kanë pranuar ftesë zyrtare nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë, për tu bërë pjesë e auditimit gjithëpërfshirës të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza", në kuadër të procesit të mbikëqyrjes të certifikatës kundrejt rregullores së EASA 139/2014. Pas përfundimit të rishikimit të dokumentacionit dhe materialit të prezantuar, nga data 12 deri me 16 dhjetor 2022 është realizuar auditimi një javor që përfshiu sistemin e menaxhimit të sigurisë, planin emergjent, karakteristikat fizike dhe infrastrukturën e aerodromit, etj. Përveç kësaj është audituar edhe pjesa tjetër për

shërbimet operative si shërbimi për zjarrfikje dhe shpëtim, shërbimi operimeve ne platformë, transporti i mallrave të rrezikshme, siguria e lëvizjes se automjeteve në fushën ajrore, mirëmbajtja e fushës ajrore dhe menaxhimi i rrezikut nga bota shtazore, si dhe kontrolli i pengesave në zonat mbrojtëse të aeroportit.

Ky auditim i përbashkët u vlerësua shumë pozitiv nga të dyja palët sepse mundësoi shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizave të inspektorëve që më tutje do të aplikohen në interes të ngritjes së standardeve të aviacionit të të dy shteteve, dhe për më shumë krijoi një lidhje edhe më të ngushtë në mes të dy institucioneve.

Më ftesë të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë (AACSH), në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoM) në mes të AACK dhe AACSh Vlerësuesi i Autorizuar Mjekësor (AMA) ka marrë pjesë në disa inspektime dhe vizita me qëllim të aprovimit në cilësinë e Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) në Republikën e Shqipërisë. Mjekut AMA i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,ju janë pranuar zyrtarisht kredencialet edhe nga Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Më datë 13 korrik 2022 në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoM) në mes të Autoritetit te Aviacionit Civil te Kosovës (AAC) dhe Autoritetit te Aviacionit Civil te Shqipërisë (AACSH), si rezultat i kërkesës së auditorëve nga Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) dhe me ftesë të Sektorit të Licencimit dhe Mbikëqyrjes në AACSh, mjeku AMA, së bashku me inspektorët e AACSh, mori pjesë në procesin e auditimit të Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit në Republikën e Shqipërisë (AeMC), Spitalit 'SALUS' në Tiranë, që u zhvillua nga ana e ICAO, si pjesë e ICAO Universal Safety Oversight Audit Programme (USOAP) – Continuous Monitoring Approach (CMA).

Pas marrjes së përgjegjësive të reja lidhur me aprovimi ne fluturimeve, bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit te Aviacionit Civil, AAC ka bashkëpunuar me AACSh dhe janë zhvilluar dy takime, njëri në Tiranë dhe tjetri në Prishtinë dhe janë shkëmbyer praktikat dhe procedurat lidhur me aprovimin e fluturimeve që aplikohen në të dy vendet.

Për më tepër bazuar në marrëveshjen në mes të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Kroacisë (CCAA) për bashkëpunim dhe shkëmbim të ekspertizës, inspektorët SAFA të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve në bashkëpunim me inspektorët SAFA të CCAA-së kanë realizuar 12 inspektime të përbashkëta të aeroplanëve të operatorëve të huaj të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Splitit (LDSP) si dhe 12 inspektime të përbashkëta të aeroplanëve të operatorëve të huaj të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Dubrovnikut (LDDU).

Në muajin gusht dy Inspektor të DSF-së ishin pjesëmarrës në trajnimin praktik në vend pune (On-the-job-Training) në Aeroportin e Dubrovnikut të Kroacisë. Po ashtu ky

trajnim ishte obligativ për mirëmbajtjen e kredencialeve të inspektorit të aviacionit, si dhe vazhdimit të inspektimeve SAFA.

## 3.8 Projekti EASA IPA 5

AAC-ja është pika e kontaktit për një numër projektesh të asistencës teknike në aviacion që i ofrohen vendit tonë nga BE-ja në kuadër të instrumenteve të disponueshme për shtetet që synojnë anëtarësim në BE. Gjatë vitit 2022, vëllim më i madh i asistencës teknike ka qenë nga fondet e BE-së përmes Projektit EASA IPA 5, ndërsa ofrerta nga AAC-ja e Francës për të mbuluar vetëm tarifën shkollore për pesë trajnime të caktuara nuk është pranuar nga AAC-ja.

EASA IPA 5 është një projekt i asistencës teknike i financuar nga KE-ja dhe i implementuar nga EASA (Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit). Ky projekt është vazhdim i projekteve të mëparshme IPA. Implementimi i IPA 5 ka filluar nga data 01 shkurt 2020 dhe ka zgjatur për 36 muaj, deri në janar 2023. Secili aktivitet është koordinuar ndërmjet AAC-së së Kosovës dhe EASA-s për të marrë parasysh nivelin e zhvillimit të industrisë dhe nevojat specifike që kanë inspektorët e aviacionit të AAC-së drejt zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore në fusha të ndryshme të aviacionit civil.

Më 28 janar 2022 është mbajtur takimi i dytë online i Komitetit Drejtues të Projektit EASA IPA 5 (Mbështetja e BE-së për transpozimin dhe zbatimin e acquis të BE-së në fushën e aviacionit), në të cilin takim AAC-ja është përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe dy zyrtarë të tjerë të AAC-së. Gjatë takimit është miratuar Plani i Punës i projektit, i cili përfshinte aktivitetet që janë zhvilluar nga marsi 2022 deri në janar 2023. Sipas këtij plani, AAC-ja e Kosovës do të përfitonte nga një numër i madh i trajnimeve në të gjitha fushat e mbikëqyrjes së sigurisë.

Në kuadër të projektit aktual, EASA IPA 5, gjatë vitit 2022, AAC-ja ka përfituar nga dhjetë (10) aktivitetet e mëposhtme:

1. Trajnimi online për certifikimin dhe mbikëqyrjen e Aprovimeve Specifike (RVSM, LVO, EFB), 5-8 prill 2022, Prishtinë, Kosovë;
2. Punëtoria për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e Sipërfaqeve të Kufizimit të Pengesave (Obstacle Limitation Surfaces), 5-7 prill 2022, Tiranë, Shqipëri;
3. Mbështetja nga ekspertët e AAN-së (Autoritetit të Aviacionit Civil të Austrisë - Austro Control GmbH) në shkëmbimin e përvojave në implementimin e Rregullores (EU) 2019/1383 (Rregullorja (EU) 1321/2014 për Vlefshmërinë Ajrore të Vazhdueshme), 11-13 prill 2022, Vjenë, Austri;
4. Mbështetja në terren për vlerësimin dhe analizën e planit të implementimit të PBN-it (Performance-Based Navigation) dhe të procedurave GNSS (Global Navigation Satellite Systems) në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës Nënë Tereza dhe në Aeroportin e Kukësit, 12-14 prill 2022, Tiranë, Shqipëri;
5. Trajnimi për menaxhimin e platformës së aerodromit, 4-6 maj 2022, Shkup, Maqedonia e Veriut;

6. Punëtoria për operimet me balonë, 1-3 qershor 2022, Shkup, Maqedonia e Veriut;
7. Mbështetja në terren për rishikimin dhe përditësimin e Sistemit të Monitorimit të Përputhshmërisë (për Malin e Zi, Kosovën dhe Serbinë), 19-23 shtator 2022, Podgoricë, Mali i Zi;
8. Punëtoria për implementimin e Trajnimit të Bazuar në Dëshmi (Evidence-Based Training - EBT), 13-14 tetor 2022, e organizuar nga JAA TO, Amsterdam, Holandë;
9. Trajnimi për Teknikat e Auditimit (Auditing Techniques Training), 17-20 tetor 2022, Podgoricë, Mali i Zi; dhe
10. Punëtoria për rishikimin e Sistemit të Menaxhimit të Autoritetit dhe rekomandimet, 5-9 dhjetor 2022, Prishtinë, Kosovë.

Sa i përket dy trajnimeve (vizitave për shkëmbim të përvojave) nga fusha e aerodromeve (Mbikëqyrja e aerodromeve (inspektimet në hije) dhe Certifikimi dhe mbikëqyrja e shërbimeve të shpëtimit dhe fikjes së zjarrit - Programe trajnimi për personelin e aerodromit), të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2022 dhe të cilat janë mbajtur në muajin maj 2022, në Spanjë, inspektorët e AAC-së nuk kanë marrë në to pjesë për shkak të mos pajisjen së tyre me viza nga autoritetet spanjolle. AAC-ja e Spanjës kishte qenë e vetmja AAC që kishte aplikuar për mbajtjen e këtyre trajnimeve.

Ndërsa, sa i përket Punëtorisë për implementimin dhe mbikëqyrjen e kërkesave për Licencat e Operimit, të planifikuar në Planin e Punës për vitin 2022 dhe që është mbajtur nga 10-11 tetor 2022, në Beograd, Serbi, për shkaqe objektive zyrtarët e MMPHI-së e kanë anuluar pjesëmarrjen në këtë punëtori.

Po ashtu, dy aktivitete të tjera të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2022, aktiviteti 3 - Certifikimi dhe mbikëqyrja e organizatave të aprovuara dhe të deklaruara të trajnimit të pilotëve dhe aktiviteti 17 (nga fusha e SHNA-së) - Mbikëqyrja e Rregulloreve 255/2010, 2019/123 dhe 2015/340, janë anuluar pasi që EASA nuk ka arritur të sigurojë ekspertë për mbajtjen e tyre, por EASA do të mundohet t'i përfshijë ato në projektin e ardhshëm IPA 6.

# 4. AKTIVITETI LEGJISLATIV

AAC-ja në bazë të kompetencave të dhëna në Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, është e autorizuar të nxjerrë akte nënligjore për zbatim të Ligjit për Aviacionin Civil, me të cilat bëhet përvetësimi i standardeve ndërkombëtare të aviacionit civil (të njohura si Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara "SPR" e anekseve të Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil - Konventa e Çikagos) dhe të atyre për zbatim të legjislacionit të BE-së në fushën e aviacionit civil, si ato në kuadër të Marrëveshjes HPEA, ashtu edhe të tjerat, të cilat vlejnë për vendet e BE-së, por që ende nuk janë bërë zyrtarisht pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

AAC-ja bën zbatimin e legjislacionit të BE-së në përputhje të plotë me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 3/2013 të Qeverisë së Kosovës për standardet e hartimit të akteve normative. Kjo ndër të tjera nënkupton që secila projekt-rregullore e hartuar nga AAC-ja, që zbaton një akt nënligjor të BE-së, kalon nëpër procedurën e miratimit nga ZKM, departamentit përgjegjës për Integrimeve Evropiane para se të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm.

## 4.1 Përmirësimi i bazës ligjore

Ligji për aviacionin civil, është ligj që i takuar grupit të parë të ligjeve pas pavarësisë. Plotësimin/ndryshimin e ligjit, kur është e nevojshme, duhet ta iniciojë Ministria përgjegjëse për Transport, si ministri e linjës, ndërsa hisedarë të këtij procesi janë AAC, MPB dhe KHAIA, si institucione publike me përgjegjësi në fushën e aviacionit civil. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-063, brenda gjashtë (6) muajve, AAC obligohet të harton dhe miraton Rregulloren për organizimin e brendshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

## 4.2 Vështirësitë ligjore

Siç u tha më lart, Ligji për Aviacionin Civil dhe aktet nënligjore që burojnë prej tij i kanë mundësuar AAC-së ushtrimin e përgjegjësive të veta dhe zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare të vendit në fushën e sigurisë së aviacionit civil, pa ndonjë vështirësi për t'u theksuar.

## 4.3 Aktet nënligjore

AAC-ja aplikon procedurë transparente gjatë nxjerrjes së akteve nënligjore në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2012 të AAC-së për procedurat e konsultimit publik. Të gjitha aktet nënligjore të AAC-së i nënshtrohen procesit të konsultimit publik të palëve të interesit. Ky konsultim ndjek procedurat dhe afatet kohore të dhëna, gjatë të cilit, çdo palë interesi, qoftë person fizik apo juridik, ka të drejtën e dhënies së komenteve, sugjerimeve apo të kërkimit të informacioneve shtesë nga strukturat e

AAC-së, të cilat e nxjerrin një projekt-akt në konsultim publik. Forma e marrjes së këtyre komenteve/sugjerimeve nga palët e interesit mund të jetë me organizim të tryezave të rrumbullakëta, varësisht nga numri i të interesuarve, apo nëpërmes korrespondencës elektronike. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, strukturat e AAC-së brenda 2 javëve janë të obliguara që të përgatisin një raport, në të cilin do t'i ofrojnë përgjigjet e tyre në komentet e pranuara, ndërsa duhet të shpjegojnë arsyet për pranimin apo mospranimin e sugjerimeve për ndryshim të dispozitave të projekt-aktit nënligjor që është objekt i konsultimit publik.

Publikimi i akteve nënligjore të AAC-së bëhet në platformën elektronike të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

Në vazhdim janë aktet nënligjore, të cilat janë nxjerr gjatë vitit 2022:

- Rregullore (AAC) nr. 01/2022 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 01/2020, rregullores (AAC) nr. 17/2017 dhe rregullores (AAC) nr. 09/2020 në lidhje me kërkesat për menaxhimin e trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror, projektimin e strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësinë e të dhënave, sigurinë e pistës dhe shfuqizimin e rregullores (AAC) nr. 08/2015.

  Qëllimi i kësaj rregulloreje është zbatimi në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës, i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/469 e datës 14 shkurt 2020. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 20 janar 2022.

- Rregullore (AAC) NR. 02/2022 për ndryshimin e rregullores (AAC) NR. 05/2015 lidhur me vlefshmërinë në mënyrë automatike të licencave të ekuipazhit të fluturimit të bashkimit dhe trajnimit për ngritje dhe aterrim;

  Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores së Komisionit (BE) 2018/1065 e 27 korrik 2018 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1178/2011 lidhur me vlefshmërinë në mënyrë automatike të licencave të ekuipazhit të fluturimit të Bashkimit dhe trajnimit për ngritje dhe aterrim, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 15 prill 2022.

- Rregullore (AAC) NR. 03/2022 për ndryshimin e rregullores (AAC) NR. 05/2015 lidhur me deklarimin e organizatave për ofrimin e trajnimeve;

  Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores së Komisionit (BE) 2018/1119 e datës 31 korrik 2018 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1178/2011 lidhur me deklarimin e organizatave për ofrimin e trajnimeve, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 15 prill 2022.

- Rregullore (AAC) NR. 04/2022 për ndryshimin e Rregullores (AAC) NR. 05/2015 që përcakton kriteret teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil në përputhje me rregulloren (AAC) NR. 05/2020. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 26 prill 2022;

  Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/27 e 19 dhjetor 2018 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 1178/2011 që përcakton kriteret teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 2018/1139, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës.

- Rregullore (AAC) NR. 05/2022 për ndryshimin e rregullores (AAC) nr. 05/2015 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative që ndërlidhen me ekuipazhin ajror të aviacionit civil në pajtueshmëri me rregulloren (AAC) NR. 05/2020. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 26 prill 2022.

  Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2018/1974 e datës 14 dhjetor 2018 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1178/2011 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative që ndërlidhen me ekuipazhin ajror të aviacionit civil në pajtueshmëri me Rregulloren (AAC) nr. 2018/1139, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës.

- Rregullore (AAC) nr. 06/2022 që ndryshon dhe korrigjon rregulloren (AAC) nr. 01/2019 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore në bazë të rregullores së AAC-së nr. 03/2009, në lidhje me kërkesat për planifikimin dhe menaxhimin e karburantit/energjisë, dhe në lidhje me kërkesat për programet mbështetëse dhe vlerësimin psikologjik të ekuipazhit të fluturimit, si dhe testimin e substancave psikoaktive;

  Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2021/1296 e datës 4 gusht 2021. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 27 shtator 2022.

- Rregullore (AAC) nr. 07/2022 për plotësimin e Rregullores (AAC) NR. 09/2017 për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil, në lidhje me skemën e përbashkët evropiane të klasifikimit të rrezikut;

  Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2020/2034 të 6 tetorit 2020. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 30 shtator 2022.

- Rregullore (AAC) NR. 08/2022 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 09/2020 për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/navigimit ajror dhe funksioneve tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre, në lidhje me kërkesat e raportimit dhe kanalet e raportimit ndërmjet organizatave, dhe kërkesat për shërbimet meteorologjike;

  Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores zbatuese të Komisionit (BE) 2021/1338 e 11 gushtit 2021. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 30 shtator 2022.

Është hartuar edhe kjo projekt-rregullore:

- Rregullorja (AAC) NR. XX/2022 në lidhje me ngritjen dhe aterrimin e helikopterëve jashtë aerodromeve

  Projekt-rregullorja në fjalë pritet të hyj në fuqi gjatë vitit 2023.

## 4.4 Urdhëresat Administrative

- Urdhëresa Administrative (AAC) NR. 01/2022 për rreziqet që paraqiten gjatë rritjes së aktiviteteve të aviacionit

  Qëllimi i kësaj Urdhërese Administrative është të zbatojë Buletinin e Informacionit të Sigurisë së EASA-s (SIB) 2022-06 në Republikën e Kosovës. Kjo Urdhëresë është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më dt. 28 korrik 2022.

## 4.5 Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative

Në vijim janë listuar vendimet ekzekutive dhe ato administrative të lëshuara nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së gjatë vitit 2022:

**a) Vendimet ekzekutive:**

- Vendimi 01/ZDP/VE/2022, dt. 12 janar 2022 për Revokim të Certifikatës së Aerodromit me Nr. Ref. RKS.ADR.C.001 të dt. 08 nëntor 2018;
- Vendimi 02/ZDP/VE/2022, dt. 21 janar 2022 për vazhdim të aprovimit për shërbime në tokë për palë të treta për subjektit afarist "Ex Fis" sh.p.k.;
- Vendimi 03/ZDP/VE/2022, dt. 09 mars 2022 për aprovim të programit nxitës;
- Vendimi 04/ZDP/VE/2022, dt. 30 mars 2022 për vazhdim të aprovimit për shërbime në tokë për palë të treta për LKIA sha.
- Vendimi 05/ZDP/VE/2022, dt. 14 prill 2022, për korrigjimin e Certifikatës së organizatës trajnuese për KTA;

- Vendimi 06/ZDP/VE/2022, dt. 04 maj 2022, për autorizim të Qendrës së Mjekësisë së Punës në Gjakove si QMA;
- Vendimi 07/ZDP/VE/2022, dt. 29 qershor 2022, për pranimin e programeve të aprovuara paraprakisht për trajnime profesionale deri në certifikim te tyre.
- Vendimi 08/ZDP/VE/2022, dt. 22 shtator 2022, për caktimin e komisionit për shqyrtim të aprovime/lejeve për të drejta të trafikut;
- Vendimi 09/ZDP/VE/2022, i dt. 11 tetor 2022 për shfuqizim të Rregullores (AAC) 04/2015 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore;
- Vendimi 10/ZDP/VE/2022, i dt. 12 dhjetor 2022 për autorizim të Qendrës së Mjekësisë së Punës në Gjakovë si QMA;
- Vendimi 11/ZDP/VE/2022, i dt. 16 dhjetor 2022 për caktim të tarifës terminale të ASHNA-s për vitin 2023; dhe
- Vendimi 12/ZDP/VE/2022, i dt. 28 dhjetor 2022 për zbatim në rendin juridik të CS/AMC/GM në fushën e aerodromeve.

**b) Vendimet administrative:**

- Vendimi 01/2022, dt. 12 janar 2022 për caktimin e zyrtarëve për të cilët kërkohet qasje ne SIMFK;
- Vendimi 02/2022, dt. 13 janar 2022 për caktimin e zyrtarit për ushtrim te funksionit për te cilin kërkohet qasje ne SIMFK për menaxhim te parasë se gatshme;
- Vendimi 03/2022, dt. 13 janar 2022 për zëvendësimin e anëtarit të tretë i Komisioni për shqyrtimin e shkeljeve administrative;
- Vendimi 04/2022, dt. 18 janar 2022, për autorizim te përdorimit të veturave edhe pas orarit zyrtar për menaxherin e kontratës për Sigurimin Fizik të Objektit dhe Pasurisë së AAC;
- Vendimi 05/2022, dt. 04 shkurt 2022, për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbimet e dizajnimit";
- Vendimi 06/2022, dt. 04 shkurt 2022 për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me derivate";
- Vendimi 07/2022, dt. 04 shkurt 2022, për caktimin e Komisioni për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Pajisje të IT-së";
- Vendimi 08/2022, dt. 04 shkurt 2022, për caktimin e Komisionit për përzgjedhjen e modelit të përshtatshëm të pajisjeve të teknologjisë informative sipas kërkesave për furnizim;
- Vendimi 09/2022, dt. 10 shkurt 2022, për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material zyrtar";
- Vendimi 10/2022, dt. 14 shkurt 2022, për ndryshimin e Vendimit 09/2022;

- Vendimi 11/2022, dt. 22 shkurt 2022, për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikacioneve teknike për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material higjienik);
- Vendimi 12/2022, dt. 12 mars 2022, për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për përditësimin e Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave;
- Vendimi 13/2022, dt. 17 mars 2022, për caktimin e Komisionit për përpilim të specifikacioneteve teknike për aktivitete të prokurimit.
- Vendimi 14/2022, dt. 14 prill 2022 për zëvendësim të anëtarëve të Komisionit Disiplinor;
- Vendimi 15/2022, dt. 15 prill 2022 për caktimin e stafit mbështetës në AGA, DSF dhe DSC;
- Vendimi 16/2022, dt. 19 prill 2022 për caktimin e personit përgjegjës për mbështetje teknike dhe administrative për PSHS;
- Vendimi 17/2022, dt. 26 prill 2022 për ndryshimin e anëtarit të Komisionit të caktuar me Vendimin me nr. Ref 02/2021;
- Vendimi 18/2022, dt. 05 maj 2022 për caktimin e menaxherit kontratës dhe mbikëqyrësit të menaxherit të kontratës për furnizim me pajisje të IT-së;
- Vendimi 19/2022, dt.12 maj 2022 për caktimin e anëtareve në Komision të vlerësimit të tenderit;
- Vendimi 20/2022, dt. 11 maj 2022 për zbatim të Vendimit 215/2022 dt. 21.04.2022 të KPMSHC;
- Vendimi 21/2022, dt. 18 maj 2022 për caktimin e Menaxher të Kontratës dhe mbikëqyrësit të tij për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbimet e dizajnimit për Agjenci të Pavarura;
- Vendimi 22/2022, dt. 18 maj 2022 për caktimin e anëtarit të komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me letër për kopje- për nevojat e Agjencive të Pavarura";
- Vendimi 23/2022, dt. 23 maj 2022 për caktimin e Komisionit për Pranimin e Pasurisë jo Financiare, apo furnizimeve për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me pajisje te TI;
- Vendimi 24/2022, dt. 01 qershor 2022, për caktimin e Menaxher it i Kontratës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me letër për kopje për Agjencitë e Pavarura";
- Vendimi 25/2022, dt. 20 qershor 2022, për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi i automjeteve ";
- Vendimi 26/2022, dt. 20 qershor 2022, për kalimin e kompetencave të sigurisë së aviacionit ne ZDP;
- Vendimi 27/2022, dt. 21 qershor 2022, për caktimin e Komisionit për Pranimin e Pasurisë jo Financiare për aktivitetin e prokurimit Furnizim me letër për kopje për nevojat e Agjencive të Pavarura;
- Vendimi 28/2022, dt. 21 qershor 2022 për caktimin e Menaxherit te Kontratës dhe mbikëqyrësit për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje të TI-së dhe pajisje tjera përcjellëse";
- Vendimi 29/2022, dt. 21 qershor 2022 për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetet e prokurimit : auditor i

pavarur për Departamentin për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rregullim ekonomik të aviacionit;

- Vendimi 30/2022, dt. 22 qershor 2022 për ndryshimin e Vendimin 25/2022;
- Vendimi 31/2022, dt. 22 qershor 2022 për heqjen e kredencialeve të inspektoreve, nëpunësve civil që nuk i kanë këto përgjegjësi të përshkruara ne akt emërime; dhe
- Vendimi 32/2022, dt. 24 qershor 2022 për ndryshimin e Vendimin 25/2022.
- Vendimi 33/2022, dt. 08 korrik 2022, për mënyrën e mbajtjes së procesverbaleve në AAC;
- Vendimi 34/2022, dt. 25 korrik 2022, për zbatim të Vendimit Nr.57/2014 i datës 26.12.2014 të KPMSHC;
- Vendimi 35/2022, dt. 02 gusht 2022, për caktimin e zyrtarit për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me gota të plastikës dhe gota të letrës pë zyre";
- Vendimi 36/2022, dt. 02 gusht 2022, për caktimin e zyrtari për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me ujë për pije";
- Vendimi 37/2022, dt. 02 gusht 2022, për caktimin e Komisioni për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Sistemimi, skenimi, regjistrimi, ndarja në grupet kryesore, grup dhe nen grupe të materialeve arkivore";
- Vendimi 38/2022, dt. 02 gusht 2022, për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Spote publicitare";
- Vendimi 39/2022, dt. 02 gusht 2022, për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetin e prokurimit me titull "Sallë për aktivitete ( konferenca, trajnime)";
- Vendimi 40/2022, dt. 04 gusht 2022, për caktimin e zyrtarit për qasje ne dokumente publike;
- Vendimi 41/2022, dt. 05 gusht 2022, për caktimin e Komisioni për Pranimin e Pasurisë jo Financiare, apo furnizimeve "Furnizim me pajisjet të TI-së";
- Vendimi 42/2022 09 gusht 2022 për caktimin e menaxherit të kontratës për aktivitetin e prokurimit " Furnizim me karburante Lot 2"
- Vendimi 43/2022, dt. 12 gusht 2022, për shfuqizim të Vendimit 33/2022
- Vendimi 44/2022, dt. 06 shtator 2022, për caktimin e komisionit për përgatitjen e specifikacioneve teknike për databaze te akteve normative;
- Vendimi 45/2022, dt. 06 shtator 2022, për caktimin e komisionit për përgatitjen e specifikacioneve teknike për software për dizajnim të sipërfaqeve të mbrojtura nga pengesa e aerodromeve;
- Vendimi 46/2022, dt. 16 shtator 2022, për zbatim të Vendimit A.nr.2586/2022 të KPMSHC-së;
- Vendimi 47/2022, dt. 19 shtator 2022, për caktimin e menaxherit të kontratës për furnizim me letër për kopje;
- Vendimi 48/2022, dt. 23 shtator 2022, për caktimin e menaxherit të kontratës për shërbime të transportit ajror;

- Vendimi 49/2022, dt. 26 shtator 2022, për aprovim të pushimit pa pagesë të nëpunësit civil (inspektori i aerodromeve);
- Vendimi 50/2022, dt. 27 shtator 2022, për aprovim të pushimit pa pagesë të nëpunësit civil (zyrtari certifikues);
- Vendimi 51/2022, dt. 29 shtator 2022, për caktimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit me titull "Sallë për trajnime dhe konferenca";
- Vendimi 52/2022, dt. 29 shtator 2022, për caktimin e zyrtarit për specifikacione teknike për "Furnizim me tapeta muri për zyre".
- Vendimi 53/2022, i dt. 04 tetor 2022 për caktimin e Menaxherit te Kontratës dhe mbikëqyrësit për aktivitetin e prokurimit "Sigurim i automjeteve";
- Vendimi 54/2022, i dt. 04 tetor 2022 për zbatim të Vendimit Nr.636/2022 te KPMSHC;
- Vendimi 55/2022, i dt. 04 tetor 2022 për zbatim të Vendimit Nr.703/2022 te KPMSHC;
- Vendimi 56/2022, i dt. 11 tetor 2022 për ndryshim të afatit të Vendimit 37/2022
- Vendimi 57/2022, i dt. 11 tetor 2022 për zbatim të Vendimit Nr. 645/2022 të KPMSHCK-së të dt. 21.09.2022
- Vendimi 58/2022, i dt. 17 tetor 2022 për caktimin e menaxherit të kontratës për "furnizim me ujë të pijes"
- Vendimi 59/2022. i dt. 19 tetor 2022 për caktimin e Menaxhere e Kontratës për aktivitetin e prokurimit "Sall për trajnime dhe konferenca për nevojat e AAC-së";
- Vendimi 60/2022. i dt. 01 nëntor 2022 për caktimin e Komisionit për Inventarizim të Pasurisë jo Financiare;
- Vendimi 61/2022, i dt. 01 nëntor 2022 për caktimin e Komisionit për Vlerësim dhe Zhvlerësim të Pasurisë jo Financiare;
- Vendimi 62/2022, i dt. 07 nëntor 2022 për ndryshim të Vendimit nr. 60/2022;
- Vendimi 63/2022, i dt. 21 nëntor 2022 për zbatim të Vendimit Nr.57/2014 i datës 26.12.2014 të KPMSHC;
- Vendimi 64/2022, i dt. 24 nëntor 2022 për ndryshim të Vendimit 60/2022;
- Vendimi 65/2022, i dt. 15 dhjetor 2022 për caktim të Komisionit për pranim të pasurisë jo financiare " furnizim me ujë të pijes";
- Vendimi 66/2022, i dt. 14 dhjetor 2022 për refuzimin e kërkesës së nëpunësit civil për ndryshim të akt emërimit; dhe
- Vendimi 67/2022, i dt. 27 dhjetor 2022për caktimin e grupit punues për hartimin e Rregullores së Brendshme.

### 4.6 Çështjet gjyqësore

#### a) Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës A.nr. 646/19

AAC ka pranuar më 07 dhjetor 2021 Aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës A.nr. 646/19 përmes së cilit është detyruar që në afat prej 30 ditësh ti paraqes Gjykatës

përgjigje në padinë e paditësit "ExFis: shpk kundër AAC-së, për shqyrtim të ligjshmërisë së Vendimit të AAC-së 03/VE/ZDP/2019 të dt. 14 shkurt 2019, duke paraqitur prapësimet procedurale dhe duke u deklaruar se a e pranon apo jo padinë e paditësit.

AAC më datën 10 janar 2022 i ka kthyer përgjigjen në këtë padi Gjykatës Themelore të Prishtinës, përmes së cilës ka kontestuar padinë e paditësit si të pabazuar dhe ka konsideruar që AAC ka vepruar konform legjislacionit në fuqi dhe në të njëjtën kohë nuk i ka shkaktuar asnjë dëm të paditurit.

Më datën 27 tetor 2022 AAC ka pranuar Aktvendimin KA.nr. 99/22, përmes së cilit është pezulluar procedura sipas padisë së paditësit "Ex Fix" shpk kundër AAC-së për anulim të Vendimit 03/VE/ZDP/2019 të dt. 14.02.2019.

**b) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës A.nr. 53/2019**

Më 25 shkurt 2022 është marrë Aktgjykimi nga Gjykata Themelore e Prishtinës A.nr. 53/2019 përmes së cilit është aprovuar kërkespadia e AAC-së si e bazuar, për anulim të Vendimit të KPMSH-së A.nr. 690/2018.

**c) Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës A.nr. 1757/21**

AAC ka pranuar më dt. 09 qershor 2022 Aktvendimin nga Gjykatës Themelore të Prishtinës A.nr. 1757/21 përmes së cilit është detyruar që në afat prej 30 ditësh ti paraqes Gjykatës përgjigje në padinë e paditësit Agjencia e Shërbimit të Navigimit Ajror, kundër Vendimit të Komisionit të Ankesave të AAC-së me Nr. 2021/KSHA/21 të dt. 26 korrik 2021.

AAC më datën 04 korrik 2022 i ka kthyer përgjigjen në këtë padi Gjykatës Themelore të Prishtinës, përmes së cilës ka kontestuar padinë e paditësit si të pabazuar dhe ka konsideruar që AAC ka vepruar konform legjislacionit në fuqi, si rezultat i kësaj ka kërkuar të mbetet në fuqi Vendimi i Komisionit të Ankesave përbrenda AAC-së.

**d) Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës C.nr. 1413/2021**

AAC ka pranuar më dt. 12 gusht 2022 Aktvendimin nga Gjykatës Themelore të Prishtinës C.nr. 1413/2021 përmes së cilit është detyruar që në afat prej 15 ditësh ti paraqes Gjykatës përgjigje në padinë e paditësit Albulena Gërxhaliu, për kompozim të pagave.

AAC brenda afatit ligjor i ka kthyer përgjigje gjykatës duke kundërshtuar padinë.

## 4.7 Komisioni për Shqyrtimin e Shkeljeve dhe Gjobave Administrative

Gjatë vitit 2022 nuk janë inciuar procedura të reja për shqyrtimin e shkeljeve administrative, por Komisioni për Shqyrtimin e Shkeljeve dhe Gjobave Administrative ka ofruar përgjigje në pyetjet/kërkesat e parashtruara nga Bordi Mbikëqyrës i AAC-së për arsyeshmërinë e vendimit, të nxjerrë në nëntor 2021, për mos shqiptimin e gjobës administrative ndaj operatorit LİMAK Kosovo International Airport sh.a. (LKIA) dhe refuzimin e kërkesës së iniciuesit të procedurës (zyrtarit të Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit - BNRREA) për shqiptimin e gjobës administrative ndaj LKIA-së, në lidhje me mosrespektimin e urdhrave dhe direktivave të AAC-së nga ana e LKIA-së.

# 5. PROGRAMI SHTETËROR I SIGURISË (PSHS)

Sipas Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (LAC), AAC-ja, si autoritet me përgjegjësi në sigurinë e aviacionit civil, duhet të iniciojë dhe koordinojë hartimin dhe zbatimin e Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS) së aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Hartimi dhe zbatimi i PSHS-së është edhe njëra nga objektivat strategjike të AAC-së për periudhën 2019-2023.

Ky është një sistem i përbashkët i të gjitha institucioneve me rol në sigurinë dhe politikat e aviacionit civil, siç janë përcaktuar në LAC, në të cilin përshkruhet veprimtaria e secilit entitet shtetëror me rol në sigurinë e aviacionit, për rregullimin dhe menaxhimin e sigurisë në aviacionin civil.

Standardet për hartimin e këtij programi janë të caktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), përmes Aneksit 19 "Menaxhimi i Sigurisë" të Konventës së Çikagos. Ky Aneks ka hy në fuqi në nëntor të vitit 2013 dhe shtetet ratifikuese të Konventës janë të detyruara ta zbatojnë plotësisht atë në planet afatmesme të punës. Republika e Kosovës ende nuk ka pasur mundësi të aderojë në këtë Konventë, mirëpo përmes Ligjit për Aviacionin Civil ka marrë obligim për zbatimin e të gjitha standardeve të ICAO-s. Zbatimi i Aneksit 19 të ICAO-s është kryer përmes Rregullores nr. 04/2018 të AAC-së për "Menaxhimin e Sigurisë" dt. 17 gusht 2018. Për të përmbushur kërkesat e PSHS-së, gjatë vitit 2022 janë ndërmarrë veprimet e përshkruara më poshtë:

## 5.1 Takimet e Komitetit të Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS)

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur tri takime të Komitetit për Programin Shtetëror të Sigurisë (PSHS) në aviacionin civil, nga të cilat dy ishin të jashtëzakonshme dhe një i rregullt. Më 23 mars 2022 është mbajtur takimi i 10-të i Komitetit për PSHS-në, i cili ka qenë i jashtëzakonshëm, më 02 nënor 2022 është mbajtur takimi i 11-të, i cili po ashtu ka qenë i jashtëzakonshëm, dhe 29 dhjetor 2022 është mbajtur takimi i 12-të i këtij Komiteti, i cili ka qenë i rregullt. Të tria takimet janë thirrur nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, z. Bujar Ejupi, i cili është njëhohësisht edhe zyrtar përgjegjës për PSHS-në në Republikën e Kosovës.

Në takime është diskutuar për informacionet për sigurinë e aviacionit civil të shpërndara në mediat sociale nga Sindikata e Punëtorëve të AAC-së - SPAAC, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura (ndryshimin e Ligjit të Aviacionit Civil), për progresi në fushën e kërkimit dhe shpëtimit, për ndryshimet infrastrukturore në ASHNA, për ligjin për pagat në sektorin publik dhe ndikim që ai mund ta ketë në ikjen e punonjësve të aviaionit civil nga Kosova, për mbulimin e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës që tani mbulohet nga HungaroControl, si dhe për zhvillimet e përgjithshme në aviacionit civil, sipas fushave të përgjegjësive së institucioneve të përfaqësuara në Komitet. Takimet e Komitetit mbahen me qëllim të

përmbushjes së përgjegjësive të këtij Komiteti dhe të zyrtarit përgjegjës për PSHS-në, siç janë përshkruar në dokumentin "Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komitetit".



Pamje nga takimi i tretë i Komitetit për PSHS-në, të mbajtur në ambientet e ASHNA-s

Komiteti për Programin Shtetëror të Sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Kosovës është themeluar me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 05/96, të datës 22.06.2016. Anëtarë të këtij Komiteti përveç AAC-së janë edhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA).

## 5.2 Aktiviteti i Këshillit të Sigurisë në AAC

Gjatë vitit 2022, janë mbajtur dy takime të Këshillit të Sigurisë së aviacionit në AAC, i pari më 19 prill 2022 i cili ka vazhduar me 16 maj 2022 dhe i dyti më 27 dhjetor 2022.

Në takimin e parë, Këshillit i është paraqitur për shqyrtim pasqyra e ndodhive të raportuara në AAC, me theks në ndodhitë me status të hapur, ndërsa në takimin e dytë, është diskutuar për një ankesë të pranuar në AAC nga operatori ASHNA, si dhe është diskutuar për zbatimin e Rregullores së AAC-së nr. 07/2022 për klasifikimin e rrezikut (ERCS - skema e përbashkët evropiane për klasifikimin e rrezikut) dhe nevojën për familjarizim me këtë rregullore nga AAC-ja dhe nga industria që do ta zbatojë atë.

### 5.3 Rishikimi i Sistemit të Menaxhimit të Autoritetit

Nga 5-9 dhjetori 2022, në zyrat e AAC-së, është mbajtur punëtoria: Rishikimi i Sistemit të Menaxhimit të Autoritetit dhe Rekomandimet, me mbështetjen e ekspertëve nga Austro Control (Autoriteti Austriak i Aviacionit Civil), z. Mario Lenitz (Menaxheri i Cilësisë - Funksioni i Monitorimit të Përputhshmërisë) dhe z. Raul Ortiz de Urbina (Menaxher i Sigurisë dhe Mbikëqyrjes).

Ky trajnim është mbajtur në kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Teknik të EASA-s, EASA IPA-5. Trajnimi është mbështetur nga EASA për ta rishikuar performancën e Sistemit të Menaxhimit të Autoritetit (SMA) të AAC-së kundrejt kërkesave të autoritetit të rregullave implementuese, pasi që Kosova nuk i nënshtrohet Programit Universal të Auditimit të Mbikëqyrjes të Sigurisë (USOAP) të ICAO-së dhe Vizitave të Standardizimit të EASA-s dhe nuk përfiton në aspektin e të paturit të një pike referimi në lidhje me performancën e sistemit të saj të menaxhimit të autoritetit, i cili është duke u zhvilluar vazhdimisht.

Ky rishikim gjithashtu i ka mundësuar AAC-së të mësojë për praktikat më të mira për krijimin dhe mirëmbajtjen e një Sistemi efikas të Menaxhimit të Autoriteteve. Dhe qëllim i trajnimit ka qenë të sigurojë një sërë rekomandimesh dhe të përcaktojë një plan veprimi për përmirësimin e Sistemit SMA të përqendruar në kërkesat "thelbësore" të autoritetit me shembuj nga ARx.GEN dhe ATM/ANS.AR.

### 5.4 Menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion (OR)

Me qëllim të ngritjes së sigurisë së aviacionit, duke parandaluar aksidentet dhe incidentet, AAC-ja mbledh dhe analizon informacione të nevojshme të sigurisë së aviacionit civil përmes sistemit të saj të raportimit të ndodhive. Këto informacione i mundësojnë AAC-së dhe industrisë që të informohen për rreziqet e sigurisë me të cilat ballafaqohen, me qëllim të mbështetjes së spektrit të plotë të aktiviteteve në menaxhimin e sigurisë, duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e veprimeve lehtësuese aty ku është e përshtatshme. Informacionet relevante të sigurisë raportohen, mblidhen, ruhen, mbrohen, shkëmbehen, shpërndahen dhe analizohen në përputhje me kërkesat e Rregullores së AAC-së nr. 09/2017 për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil.

Gjatë vitit 2022, në baza dyjavore, ndodhitë e pranuara në AAC janë përmbledhur dhe dërguar në KHAIA, ashtu siç ka kërkuar KHAIA nga AAC-ja në një takim të mbajtur kohë më parë. Këto të dhëna të pasqyruara në formë tabelare i dërgohen KHAIA-s çdo dy javë.

Gjatë vitit 2022, AAC-ja ka pranuar raportime për gjithësejt 263 ndodhi në aviacionin civil, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me numrin e ndodhive të raportuara gjatë viteve të fundit. Kjo natyrisht përkon edhe me rritjen e numrit të operimeve krahasuar me vitin 2021, i cili kishte pësuar nga kufizimet në fluturime për shkak të pandemisë.

Numri i përgjithshëm i ndodhive të raportuara në AAC, që nga viti 2006 deri në fund të vitit 2022 ka arritur në gjithsejtë 2107 ndodhi. Besohet se nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në numrin e raportimeve të ndodhive krahasuar me numrin e fluturimeve dhe kjo tregon nivelin e vetëdijesimit të pjesëmarrësve në industrinë e aviacionit dhe përkushtimin e tyre për të raportuar, si dhe mund të tregojë nivelin e kënaqshëm të sigurisë në aviacionin civil.

Ndodhitë e raportuara janë koduar në kategori të ndryshme sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi dhe bashkë me kategoritë e ndodhive të dy viteve të mëparshme janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm, i cili është bazuar në të dhënat e nxjerra nga baza e të dhënave e AAC-së në platformën softuerike ECCAIRS 5 (Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve).




Kategorizimi i ndodhive të raportuara gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 (kodimi i ndodhive sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi)

Nga grafiku i mësipërm mund të vërehet se në krahasim me kategoritë e ndodhive të viteve 2020 dhe 2021, kategoritë e vitit 2022 të cilat kanë pasur rritje, disa prej të cilave më të ndjeshme, dhe kanë ndikuar në rritjen e numrit të përgjithshëm të ndodhive janë:

- ATM (menaxhimi i trafikut ajror/komunikimi, navigimi dhe vrojtimi);
- BIRD (goditja e shpendëve);
- CABIN (ngjarja e lidhur me sigurinë e kabinës);
- MAC (airprox/ alarmimi ACAS/ humbja e ndarjes/ (afër) përplasjes në ajër);
- RI (futja në pistë - e automjetit, mjetit ajror ose e personit);

- SEC (e lidhur me sigurimin, e cila përmban nënkategorinë e ndodhive të lidhur me sulmet me laser);
- WILD (përplasja me kafshët e egra); dhe
- WSTRW (gradienti i shpejtësisë së erës ose bubullima).

Ndërsa, kategoritë e ndodhive që kanë pësuar rënie të konsiderueshme në vitin 2022 janë:

- ADRM (aerodromi); dhe
- NAV (gabimi në navigacion).

Për sqarim, dy nga 263 ndodhitë e raportuara në vitin 2022 janë të koduara në dy kategori.




| | janar | shkurt | mars | prill | maj | qershor | korrik | gusht | shtator | tetor | nëntor | dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2020 | 7 | 7 | 10 | 4 | 2 | 4 | 13 | 14 | 14 | 15 | 5 | 6 |
| 2021 | 7 | 10 | 13 | 10 | 30 | 22 | 38 | 18 | 26 | 19 | 13 | 19 |
| 2022 | 14 | 21 | 16 | 18 | 23 | 22 | 31 | 33 | 37 | 17 | 14 | 17 |

Numri i ndodhive të raportuara në baza mujore gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022

Siç mund të shihet në grafikun e mësipërm, nga 263 ndodhitë e pranuara në AAC gjatë vitit 2022, muajt me numrin më të madh të ndodhive janë muajt e verës (korrik, gusht dhe shtator) kur edhe numri i fluturimeve është më i madh. Po ashtu, gjatë këtyre muajve ka ndodhur edhe numri më i madh i goditjeve të shpendëve.

Ndodhitë e raportuara po ashtu janë klasifikuar në klasa të ndryshme bazuar në ashpërsinë e ndikimit të tyre në operimet e sigurta të mjeteve ajrore dhe në njerëzit në bordin e tyre, por jo të gjitha ndodhitë e vitit 2022 nuk janë klasifikuar ende.

# 6. SIGURIA E FLUTURIMEVE, CERTIFIKIMI DHE LICENCIMI

## 6.1 Inspektimet e mjeteve të huaja ajrore në platformë

Programi i Inspektimit të mjeteve të huaja ajrore në platformë (SAFA) është një Program Evropian në lidhje me performancën e inspektimeve në platformë të mjeteve ajrore të përdorur nga operatorët e vendeve të treta ose të përdorura nga operatorët nën mbikëqyrjen rregullatore të një shteti tjetër anëtar të BE-së (SACA).

Programi rregullohet nga Rregullorja e (AAC) Nr. 04/2015 mbi kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore, e ndryshuar me Rregulloren (AAC) Nr. 10/2017, Rregulloren (AAC) Nr. 14/2017 si dhe Rregulloren (AAC) Nr. 15/2017, të cilat parashikojnë inspektimin e mjeteve ajrore të dyshuar (bazuar p.sh. në informacionin përkatës të sigurisë të mbledhur nga Shtetet pjesëmarrëse ose në analizën e rregullt të bazës së të dhënave të centralizuara të kryer nga EASA) të jo-pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme (ose standardet ndërkombëtare të sigurisë ose standardet e BE-së). Inspektimet në platforme mund të kryhen edhe në mungesë të ndonjë dyshimi, në këtë rast përdoret një procedurë kontrollit të rastësishëm në platformë.



Për më tepër bazuar në Nenin 50 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve mund të bëjnë inspektimin në platformë dhe/ose kontrollimin në vend, të mjeteve ajrore nga vendet të cilat janë anëtarë të BE-së ose HPEA, si dhe të vendeve të tjera ndërkombëtare, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

Këto inspektime, pra inspektimet SAFA kryhen në baza jo-diskriminuese, si dhe Inspektoret SAFA, pas informacioneve, do tu lejohet qasje e menjëhershme dhe e pakufizuar në çdo kohë dhe në çdo aeroplan civil i cili gjendet brenda Kosovës me qëllim që të sigurojë se mjeti ajror është i përshtatshëm për fluturim dhe se është duke u operuar në përputhje me këtë Ligj dhe me rregulloret për zbatimin e këtij ligji.

Bazuar në informata e mësipërme Inspektoret e Departamentit te Sigurisë se Fluturimeve gjatë vitit 2022 kanë kryer tridhjete (30) inspektime të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj (SAFA - Vlerësimi i Sigurisë së Mjeteve të Huaja Ajrore), të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

Ky numër i inspektimeve të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj paraqet një ngritje afërsisht 30% nga viti paraprak (2021) i cili kishte rënie të mëhershme të numrit të inspektimeve si pasojë e situatës së krijuar me pandeminë globale të virusit Corona (COVID-19) dhe shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik nga Qeveria e Republikës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

Në vijim janë të listuara kompanitë ajrore të inspektuara të cilat operojnë në ANP "Adem Jashari". Janë inspektuar aeroplanët e këtyre kompanive ajrore:

**Swiss International Airlines**
IATA: LX
ICAO: SWR

**Austrian Airlines**
IATA: OS
ICAO: AUA

**ETF Airways**
IATA: LI
ICAO: EZZ

**LOT Polish**
IATA: LO
ICAO: LOT

**Trade Air**
IATA: TD
ICAO: TDR

**Bul Air**
IATA: LZ
ICAO: LZE

**EasyJet Switzerland SA**
IATA: DS
ICAO: EZS

**Eurowings**
IATA: EW
ICAO: EWG

**Wizz Air UK**
IATA: W9
ICAO: WUK

**Bul Air**
IATA: LZ
ICAO: LZE

**Edelweiss**
IATA: WK
ICAO: EDW

**Wizz Air Hungary**
IATA: W6
ICAO: WZZ

**Enter Air Sp.**
IATA: OF
ICAO: ENT

**SunExpress**
IATA: XQ
ICAO: SXS

**SkyUp Airlines**
IATA: PQ
ICAO: SQP

**Elitavia / San Marino**
IATA: MA
ICAO: EAU

**Norwegian Air Shuttle**
IATA: DY
ICAO: NOZ

**Alpavia d.o.o.**
IATA: S5
ICAO: APP

**BH Airlines**
IATA: 8H
ICAO: BGH

**Chair Airlines**
IATA: GM
ICAO: GSV

**Turkish Airlines/AnadoluJet**
IATA: TK
ICAO: THY

**Pegasus Airlines**
IATA: PC
ICAO: PGT

**Turkish Airlines/AnadoluJet**
IATA: TK
ICAO: THY

**GP Aviation**
IATA: GP
ICAO: GPX

**Avion Express**
IATA: X9
ICAO: NVD

**EasyJet Europe**
IATA: EC
ICAO: EJU

**Trade Air**
IATA: C3
ICAO: TDR

**Eurowings**
IATA: EW
ICAO: EWG

**TUI Fly**
IATA: TB
ICAO: JAF

**Cavok Air**
IATA: --
ICAO: CVK

Gjatë këtyre inspektimeve vlen të përmendet fakti qe Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve nuk kanë konstatuar ndonjë gjetje të kategorisë 3 (veprime korrigjuese para fluturimit), apo ndonjë gjetje e kategorisë 2 apo 1 (informatë operatorit si dhe shtetit te operatorit).

### 6.2 Auditimet e operatorëve të aviacionit

Auditimi i operatoreve të aviacionit civil është një proces për promovimin dhe mbikëqyrjen ne zbatimin e rregulloreve dhe standardeve të aviacionit, të cilat së bashku përshkruajnë një nivel të lartë të sigurisë në aviacionin civil.

Punonjësit profesional të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2022 në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit te këtij procesi, kanë realizuar një numër të auditimeve te cilat, me qëllim të verifikimit të zbatimit të masave në kuadër të planit të

veprimit të hartuar dhe të paraqitur nga ana e operatoreve te aviacionit civil, duke u bazuar në dokumentet relevante të hartuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA), Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO). Për më tepër qëllimi i këtij plani ishte edhe mbikëqyrja e rikthimi gradual te operimeve në transportin ajror pas pandemisë publike shëndetësore për shkak të virusit COVID-19, me theks të veçantë duke u bazuar në Listën Kontrolluese (check-list) të hartuar nga EASA, me qëllim të zbatimit në mënyrë uniform të masave për frenimin e përhapjes së COVID-19 në kontinentin evropian.

Më datë 4 gusht 2022 Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve kanë kryer inspektimin e organizatës se aprovuar për trajnime në mallra të rrezikshme në lidhje me organizimin e trajnimit nga ana e tyre për Kategorinë 12 (Cat.12) për mallra të rrezikshme. Ky inspektim është mbajtur nga ana e Inspektorëve të DSF-së ndaj organizatës trajnuese për mallra të rrezikshme "LIMAK - Kosovo International Airport" J.S.C.

Për më tepër, Inspektorët e Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve kanë kryer inspektimin dhe kanë e shqyrtuar aplikimin si dhe aprovimin e programeve te trajnimeve për mallra te rrezikshme, te ofruesit "LIMAK - Kosovo International Airport" J.S.C. të cilat janë:

- Për personelin e Kategorisë së Klasës 5,
- Për personelin e Kategorisë së Klasës 7,
- Për personelin e Kategorisë së Klasës 8,
- Për personelin e Kategorisë së Klasës 9, dhe
- Për personelin e Kategorisë së Klasës 10.

Në fund pas aprovimit të programe te trajnimeve për mallra te rrezikshme, Autoriteti i Aviacionit Civil ka lëshuar numrat për pjesëmarrësit në trajnim (RNP).

Më datë 04 nëntor 2022 Inspektorët e Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve kanë kryer Auditimin e Organizatës Trajnuese për Paraglajdizëm "Akademia e Aviacionit "Artan Venhari" konform aprovimit te lëshuar nga Autoritetit i Aviacionit Civil te Kosovës ne mbështetje te Ligjit Nr. 03/L-051 për aviacionin civil.

Për më tepër më datë 18 mars 2022 në mbledhjen e rregullt te punës së Kuvendit të Federatës Aeronautike të Kosovës me ç'rast ishte prezentë edhe Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AACK) ne baze te Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të AAC-së dhe Federatës Aeronautike për delegim të mbarëvajtjes së "Rregullores për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të paraglajdëve dhe deltaplanëve" nga AAC tek Federata.

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës në vazhdimësi ka mbështetur Federatën Aeronautike në zhvillim të aviacionit sportiv e rekreativ në Kosovë, e cila pa këtë përkrahje do të kishte të pamundur arritjen e rezultateve të jashtëzakonshme të pilotëve paraglajdistëve në arenën ndërkombëtare. Dhe është duke punuar në delegimin e disa përgjegjësive nga AAC tek Federata.

Kuvendi i Federatës Aeronautike të Kosovës u zotua të zhvillojë edhe më tej rregulloren e cila rregullon kushtet e operimit të paraglajdëve dhe deltaplanëve në Kosovë, me ç'rast bashkëpunimi i ngushtë me AAC-në u ripërsëritur si prioritet për Kuvendin dhe Bordin e Federatës, sipas marrëveshjes së bashkëpunimin federata pasi ti plotësoj kushtet dhe tregon se ka kapacitete të mjaftueshme për marrjen e përgjegjësisë, të dy palët mund të iniciojnë procesin e bartjes së disa përgjegjësi tek Federata.

Më datë 14 tetor 2022 u zhvillua auditimi i Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë (QKMP) nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, respektivisht nga Sektorit i Mjekësisë së Aviacionit (AMS) i Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve (DSF).

Ky auditim u realizua në përputhje me rolin e AAC-së si Autoritet Mbikëqyrës Kombëtar (AMK), ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-51 për Aviacionin Civil, Pjesa 7, Neni 78 dhe me qëllim të zbatimit të kërkesave ligjore që dalin nga Rregullorja e AAC-se Nr. 5/2015, me ndryshime, që përcakton kriteret teknike dhe procedurat administrative në lidhje me pjesëtarët e ekuipazhit në aviacionin civil dhe Rregullorja Nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

### 6.3 Transporti i mallrave të rrezikshme përmes ajrit

Çdo vit e më tepër është në ngritje e sipër numri i dërgesave të mallrave të rrezikshme të cilat transportohen me rrugë ajrore. Me rritjen e ngarkesave ajrore të parashikuara në 4.9% çdo vit gjatë 5 viteve të ardhshme, numri i dërgesave të mallrave të rrezikshme do të rritet ndjeshëm. Me kaq shumë mallra të rrezikshme që transportohen përmes ajrit, rregullat e sigurisë duhet të ndiqen saktësisht. Autoriteti i Aviacionit Civil bazuar në identifikimin e rreziqeve dhe informatave të publikuara nga ICAO (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil) punon për të ndryshuar rregulloret duke u ofruar palëve të interesuara udhëzimet më aktuale se si të trajtojnë dhe transportojnë mallrat e rrezikshme në mënyrë të sigurt.

Është e rëndësishme të cekim se çfarë është një mall i rrezikshëm përpara transportimin të tijë. Sipas Manualit të Rregulloreve për Mallrat e Rrezikshme (DGR) të AAC-së, "Mallrat e rrezikshme (të njohura gjithashtu si materiale të rrezikshme ose materiale hazard "hazmat") janë artikuj ose substanca që janë në gjendje të paraqesin rrezik për shëndetin, sigurinë, pronën ose mjedisin dhe të cilat tregohen në listë të mallrave të rrezikshme (sipas Rregullores së AAC për Mallrat të Rrezikshme si dhe klasifikimin e tyre). Për shkak se AAC-ja merr pjesë në një proces të rreptë rregullator, mallrat e rrezikshme mund të transportohen nga ajri në mënyrë të sigurt dhe të sigurt kur këto udhëzime ndiqen nga afër.

Në bazë të Neneve 57 dhe 59 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe Nenit 7 të Rregullores Nr. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportimit të mallrave të

rrezikshme përmes ajrit në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2022 është rritur numri i përgjithshëm i lejeve për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit.

Po ashtu është me rendësi te përmendet edhe rritja e kompanive ajrore që operojnë në ANP "Adem Jashari", të cilat paraprakisht janë të licencuara dhe posedojnë leje për import të armëve dhe municionit, të lëshuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), respektivisht materialeve radioaktive të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB).

Pra gjatë vitit 2022 Autoriteti i Aviacionit Civil ka lëshuar gjithsejtë 209 (dyqind e nëntë) leje për transport ajror të mallrave të rrezikshme përmes ajrit në Republikën e Kosovës, nga ana e kompanive ajrore të licencuara nga autoritetet përkatëse dhe të aprovuara për të transportit të mallrave të rrezikshme. Deri në bartjen e përgjegjësive për aprovimin e fluturimeve nga Ministria tek AAC, lejet e lëshuara për transport ajror të mallrave të rrezikshme janë lëshuar si shtesë e lejeve të leshura nga Ministria, prandaj edhe në lejet e AAC për të transportit të mallrave të rrezikshme ishte shënimi se kjo leje nuk nënkupton leje të operimit, në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, siç është definuar ne Ligjin Nr, 03/L-051 për Aviacion Civil, Rregulloren MI (2015) dhe AIP Kosova dhe se për lëshimin e lejes se operimit përgjegjës është Departamenti i Aviacionit Civil ne Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) të Republikës së Kosovës www.mit-ks.net.




Numri i transportit të mallrave të rrezikshme gjatë vitit 2022 janë transportuar nga këto kompani ajrore:

| Numër | Kompania Ajrore | Numri i Lejeve të lëshuara |
|---|---|---|
| 1 | "Turkish Airlines" | 127 |
| 2 | "Pegasus Hava Tasimaciligi" | 52 |
| 3 | "Austrian Airlines" | 22 |
| 4 | "Air Meridian" | 4 |
| 5 | "CAVOK Air" | 2 |
| 6 | "Swiss International Airlines" | 1 |
| 7 | "ASL Airlines" | 1 |

Në përgjithësi numri i lejeve për transportit ajror të mallrave të rrezikshme të lëshuara gjatë vitit 2022 janë në përgjithësi dyqind e nëntë (209), e cila paraqet numrin më të madh të këtyre lejeve gjerë me këtë datë.

## 6.4 Mbikëqyrja e aviacionit të përgjithshëm

Gjatë vitit 2022 ka pasur një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve të aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të Republikës se Kosovës, ku përfshihen fluturimet sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR) me aeroplanë dhe helikopterë, pastaj operime me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dron) dhe operime me balonë me ajër të nxehtë, të cilat sipas bazës ligjore dhe procedurave përkatëse, kanë kaluar nëpër procesin e miratimit nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) në koordinim të ngushtë me Policinë e Republikës së Kosovës si dhe njësitin ajror të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR J3-Air).

Vlen të përmendet këtu fakti se njësiti KFOR j3-Air ka mbështetur procesin e normalizimit të përdorimit të hapësirës ajrore mbi Kosovë që nga viti 1999, duke udhëhequr takimet e normalizimit të aviacionit në Ballkan. Në këto takime marrin pjesë rregullisht përfaqësues të vendeve aleate, autoritetet e navigacionit ajror, autoritetet ushtarake si dhe organizatat ndërkombëtare përkatëse, duke përfshirë Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit dhe EUROCONTROL ndër të tjera.

## 6.5 Fluturimet sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR)

Gjatë vitit 2022 Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka lëshuar gjithsejtë katërmbëdhjetë (14) aprovime për fluturim sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR). Të gjitha këto aprovime janë lëshuar në koordinim të ngushtë me njësitin ajror të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR J3 Air).

Po ashtu vlen të përmendet se Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës gjatë vitit 2022 ka miratuar dy kërkesa, në territorin e Republikës së Kosovës, të zhvillohet fushata e

vaksinimit nga ajri të kafshëve të egra kundër tërbimit. Kjo fushatë është zhvilluar në tërë Ballkanin Perëndimor si pjesë e iniciativës rajonale të kontrollit të kësaj sëmundjeje tek kafshët, prandaj të njëjtit kanë kryer këto fluturime të aeroplanëve edhe në territori si dhe afër zonave kufitare të Republikës së Kosovës.



Vaksinimi nga ajri ishte një procedurë moderne e cila garantonte vaksinimin e sigurt të kafshëve të egra, kurse i gjithë procesi i shpërndarjes së vaksinimit ishte realizuar përmes ajrit dhe në mënyrë të kontrolluar nëpër të gjitha zonat malore, duke përjashtuar qendrat urbane dhe sipërfaqet ujore.

### 6.6 Fluturimet diplomatike

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2022 ka proceduar kërkesat e dërguara nga  Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës tek njësiti ajror i Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR J3Air) kërkesat për aprovimin e shtatëdhjetë e shtatë (77) fluturimeve diplomatike. Të gjitha këto kërkesa janë aprovuar dhe proceduar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës se Kosovës.

### 6.7 Aktivitetet me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dronë)

Sipas Rregullores (AAC) Nr. 01/2021 për Sistemet e mjeteve ajrore pa pilot, të gjithë operatorët e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot apo siç njihen ndryshe me emërtimin "dron" janë të obliguar të regjistrojnë dronët e tyre në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës varësisht peshës së tyre.

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2022 ka regjistruar njëzet e shtatë (27) aplikues të rinj për operime me sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP). Numri total i operatorëve të dronëve të regjistruar në Republikën e Kosovës për vitet 2017-2022 ka arritur në dyqind e njëzet e gjashtë (226) operatore te sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP).



Po ashtu janë aprovuar edhe dhjetë (10) operime të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot të regjistruar në vende të tjera. Aprovimi i operatorëve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot, është bërë në koordinim të ngushtë me Policinë e Republikës së Kosovës si dhe njësitin ajror të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR J3-Air).

Në vazhdën e aktiviteteve rregullatore të parapara me legjislacionin në fuqi Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve organizoi provimin për testin e njohurive për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (dronëve) të Kategorisë 3. Këtij provimi i është nënshtruar një (1) kandidat i cili ka kaluar me sukses këtë test. Me këtë rast kandidatit i është ndarë certifikata për këtë kategori të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot, duke i uruar suksese dhe operime të sigurta në të ardhmen.

## 6.8 Gjobat administrative

Vitet e fundit ka pasur një rritje të madhe të aktivitetit të fluturimit në distancë të mjeteve ajrore pa pilot. Numri i operatorëve të regjistruar tani tejkalon numrin dyqind (200) dhe vazhdon të rritet. Janë bërë më shumë fluturime se vitet e kaluara si dhe shumëllojshmëria e arsyeve për këto fluturime po zgjerohet me futjen e teknologjive dhe aftësive të reja.

Për t'i realizuar plotësisht të gjitha këto, duhet të sigurohemi që mjetet ajrore pa pilot te cilët operojnë nga distanca, duhet të vazhdojnë të përdoren në mënyrë të sigurt. Duhet të cekim se një nga mënyrat se si do ta arrijmë këtë siguri është edhe shqiptimi i gjobave për operatoret e mjeteve ajrore pa pilot. AAC ka marrëveshje me Policinë e Kosovës për shqiptimin e gjobave si dhe identifikimin e personave te cilët operojnë pa leje ne vendin tonë.

Në përputhje me Rregulloren (AAC) Nr. 01/2017 për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (SAP), të përditësuar, gjatë vitit 2022, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka lëshuar gjithsejte katërmbëdhjetë (14) vendime për shqiptimin e gjobave për shkeljet në lidhje me operimet e paautorizuara me dronë (SAP). Po ashtu, janë lëshuar edhe faturat përkatëse dhe pas kryerjes së pagesave nga palët e gjobitura, është udhëzuar Policia e Kosovës për lirimin e dronëve të konfiskuar.

### 6.9 Raportimi i ndodhive në aviacion (OR)

Me qëllim të ngritjes së sigurisë së aviacionit, duke parandaluar aksidentet dhe incidentet, AAC-ja mbledh dhe analizon informacione të nevojshme të sigurisë së aviacionit civil përmes sistemit të saj të raportimit të ndodhive. Këto informacione i mundësojnë AAC-së dhe industrisë që të informohen për rreziqet e sigurisë me të cilat ballafaqohen, me qëllim të mbështetjes së spektrit të plotë të aktiviteteve në menaxhimin e sigurisë, duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e veprimeve lehtësuese aty ku është e përshtatshme. Informacionet relevante të sigurisë raportohen, mblidhen, ruhen, mbrohen, shkëmbehen, shpërndahen dhe analizohen në përputhje me kërkesat e Rregullores së AAC-së nr. 09/2017 për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil.

Nga data 22 qershor 2022 deri më datë 06 tetor 2022, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka menaxhuar sistemin e raportimit të ndodhive në aviacion, që përfshin kontrollimin dhe korrigjimin e të dhënave, procesimin dhe kontrollin e raporteve të ndodhive, futjen dhe arkivimin e ndodhive në softuerin ECCAIRS, mbylljen e ndodhive dhe menaxhimin e bazës së të dhënave në ECCAIRS, nxjerrjen e të dhënave nga baza e të dhënave për nevoja të ndryshme dhe paraqitjen e tyre në formë grafike, si dhe përgatitjen e listave përmbledhëse të ndodhive të raportuara. Gjatë kësaj periudhe, janë procesuar 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) ndodhi (prej nr. 22/104 deri nr. 22/218). Para dhe pas kësaj periudhe sistemi i raportimit të ndodhive në aviacion është menaxhuar nga Departamenti i Sigurisë dhe Cilësisë.

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve (DSF) ka ndihmuar Departamentin për Siguri dhe Cilësi (DSC) në lidhje me menaxhimin e sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion. DSC-së i janë ofruar modelet e grafikëve të përdorur në listat përmbledhëse të ndodhive të raportuara të përgatitura nga DSF-ja dhe dokumentet e përgatitura për publikim në platformën digjitale Nextcloud, si dhe janë ofruar këshilla për trajtimin e raporteve për mallrat e rrezikshme dhe artikujt e ndaluar të zbuluar nga Sigurimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka pranuar raportime për gjithsejtë dyzet e nëntë (49) ndodhi në aviacionin civil. Ndodhitë e raportuara janë koduar në kategori të ndryshme sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi dhe të bazuara në të dhënat e nxjerra nga baza e të dhënave e AAC-së në platformën softuerike ECCAIRS 5 (Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve). Nga dyzet e nëntë (49) ndodhitë e hetuara/trajtuara nga DSF-ja, nëntë (9) janë mbyllur, ndërsa të tjerat janë ende në hetim e sipër.

Numri i ndodhive të nënkategorisë së sulmeve me laser ndaj mjeteve ajrore, në vitin 2022, ka qëndruar relativisht i vogël, me nëntë (9) ndodhi, gjë që është shumë e mirëpritur pasi që shndritja e rrezeve laserike drejt mjeteve ajrore në fluturim paraqet pengesë të madhe për pilotët dhe mund t'i verboj ata gjatë fazave kritike të fluturimit, siç janë ngritja dhe aterrimi, e që si rrjedhojë kjo paraqet rrezik serioz për sigurinë e udhëtarëve dhe ekuipazheve, si dhe të njerëzve që jetojnë në afërsi të aeroporteve. Këto sulme përbëjnë vepra penale dhe kryhen qëllimisht nga persona të papërgjegjshëm. Këto ndodhi të sulmeve me laser ndaj mjeteve ajrore janë përcjellë tek institucionet e sigurisë (Policia) për hetime të mëtejme.

Në përfundim të këtij vitit, pra vitit 2022 numri i përgjithshëm i ndodhive të pranuara dhe proceduara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ka arritur në 2107.

### 6.10 Mjekësia e aviacionit

Mjekësia e Aviacionit është një proces mjekësor që ndërthur aspektet e mjekësisë parandaluese, profesionale, mjedisore dhe klinike me fiziologjinë dhe psikologjinë e njeriut në fluturim. Kjo ka të bëjë me shëndetin dhe sigurinë e atyre që fluturojnë, si ekuipazhit ashtu edhe pasagjerëve, si dhe me përzgjedhjen dhe performancën e atyre që kanë licenca të aviacionit.

Aviacioni mund të kontribuojë në përhapjen e shpejtë të sëmundjeve ngjitëse - pothuajse në tërë globin i cili mund të arrihet brenda një kohe të shkurtër. Numri i pasagjerëve reduktohet ndjeshëm nga urgjencat e shëndetit publik, duke reduktuar të ardhurat për ekonomitë kombëtare, si dhe për linjat ajrore dhe kompanitë mbështetëse. Mjekësia e Aviacionit kontribuon në zbutjen dhe menaxhimin e rreziqeve të tilla shëndetësore dhe ngjarjeve të tjera të shëndetit publik.

Seksioni i Mjekësisë së Aviacionit punon në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Evropiane të Aviacionit Civil (EASA), Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), Asociacionin Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA), si dhe agjencitë e OKB-së si Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO). Gjithashtu bashkëpunon dhe konsultohet me zyrtarët kryesor mjekësor të autoriteteve të vendit tonë pra të Ministrisë së Shëndetësisë se Republikës se Kosovës.

Gjatë vitit 2022 Sektori i Mjekësisë se Aviacionit, pranë Departamentit te Sigurisë se Fluturimeve ka përfunduar një numër te larte te detyrave te përshkruara me legjislacionin përkatës. Me poshtë do te përmenden punët e përfunduara nga ky sektor.

Më datë 18 janar 2022 në Qendrën e Mjekësisë se Aviacionit (AeMC) ne Gjakovë janë kryer ekzaminimet mjekësore për 4 (katër) kontrollorë të trafikut ajror të Agjencisë se Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA).

Më datë 26 janar 2022 është kryer inspektimi ad-hoc në mjediset e Aeroportit Ndërkombëtar te Prishtinës "Adem Jashari" me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të masave për frenimin e përhapjes së COVID-19, me theks të veçantë në zbatimin e ndryshimit të konfigurimit të portës së nisjeve/arritjeve të pasagjerëve në terminal.

Më datë 10 shkurt 2022 zyrtarisht përmes letrës, në emër të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit te Aviacionit Civil (AAC), është kontaktuar Zëvendës Ministri i shëndetësisë, me qëllim të trajtimit të problematikës të mungesës së një mjeku me njohuri/trajnim në fushën e mjekësisë së aviacionit në kuadër të Qendrës Aero-mjekësore (AeMC) në Gjakovë, mungesë kjo që është vlerësuar si gjetje, gjatë auditimeve/inspektimeve të rregullta që janë bërë nga AAC-ja në Qendrën në Gjakovë që nga viti 2016;

Më datë 09 mars 2022 UD i Drejtorit të Qendrës në Gjakovë, ka njoftuar se ka marrë mbështetje nga Drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), për nisjen e procedurës për përzgjedhjen e një mjeku nga Qendra në Gjakovë, që do të dërgohej për trajnim jashtë vendit në fushën e mjekësisë së aviacionit, kurse Sektori i Mjekësisë së Aviacionit (AMS), në emër të AAC-së, ka shprehur gatishmërinë e plotë që të ofrojë mbështetje teknike-profesionale në këtë proces;

Më datë 04 maj 2022 përmes Vendimit Ekzekutiv të Drejtorit të Përgjithshëm (AAC) i është vazhduar autorizimi Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës (QKMP) në Gjakovë në cilësinë e Qendrës Aero-Mjekësore (AeMC) edhe për gjashtë (6) muaj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Më datë 13 maj 2022 operatori i Aeroportit Ndërkombëtar te Prishtinës ka njoftuar për ndryshimin-revizionin e masave për frenimin e përhapjes së COVID-19, në kuadër të Planit të Veprimit për luftimin e COVID-19, pas masave të aprovuara nga Qeveria e Kosovës (më datë 30 prill 2022) dhe ndryshimeve të fundit të Protokollit të Sigurisë së Shëndetit në Aviacion (Aviation Helath Safety Protocol), të shpallura nga EASA më 11 maj 2022.

Më datë 18 dhe 19 maj 2022 në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoM) në mes të Autoritetit te Aviacionit Civil te Kosovës (AAC) dhe Autoritetit te Aviacionit Civil te Shqipërisë (AACSh), me ftesë të AACSh, është realizuar follow–up i auditimit të spitalit "Salus" në Tiranë, në ekip me përbërje të kombinuar me inspektorët e Sektorit të Licencimit dhe të Mbikëqyrjes së AACSh. Ky institucion shëndetësor është i certifikuar në cilësinë e AeMC-së në Republikën e Shqipërisë që nga marsi i vitit 2021.

Më datë 13 qershor 2022 Drejtori i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë (QKMP) ka njoftuar AAC-në, se është përzgjedhur drejtori i ri i këtij institucioni;

Më datë 30 qershor 2022 me ftesë të AACSh është realizuar një vizitë pune e mjekut AMA në Tiranë, gjatë të cilës është bërë pranim-dorëzimi i të gjithë dokumentacionit me natyrë konfidenciale mjekësore të personelit të aviacionit civil të Republikës së Shqipërisë, nga Qendra Aero-Mjekësore e autorizuar (AeMC) në AACSh. Tani e tutje këtë dokumentacion do ta administrojë mjeku AMA i AACK, kredencialet e të cilit i ka pranuar edhe AACSh ;

Më datë 13 korrik 2022 në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoM) në mes të AACK dhe AACSh, si rezultat i kërkesës së auditorëve të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) dhe me ftesë të Sektorit të Licencimit dhe Mbikëqyrjes në AACSh, mjeku AMA, së bashku me inspektorët e AACSh, mori pjesë në procesin e auditimit të Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit në Republikën e Shqipërisë (AeMC), Spitalit 'SALUS' në Tiranë, që u zhvillua nga ana e ICAO, si pjesë e Programit të Auditimit të Mbikëqyrjes Universale të Sigurisë (ICAO - Universal Safety Oversight Audit Programme - USOAP) – Qasja së Monitorimit të Vazhdueshëm (Continuous Monitoring Approach - CMA) në AACSh, gjatë muajit korrik.

Më datë 26 gusht 2022 është vendosur komunikimi zyrtar ndërinstitucional me Drejtorin e Përgjithshëm të ri të Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë.

Më datë 13 shtator 2022 në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoM) në mes të AACK dhe AACSh, me ftesë të AACSh, është realizuar një vizitë pune e mjekut AMA në Tiranë, ku janë marrë në administrim dosjet e personelit të aviacionit civil që operojnë në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë kryer ekzaminimet aero-mjekësore në Qendrën e Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) - Spitalin 'SALUS' në Tiranë në periudhën korrik-gusht 2022.

Gjithashtu është shqyrtuar edhe një rast i referuar nga punëdhënësi në Sektorin e Licencimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit Ajror në AACSh, që lidhej me vlerësimin e shkallës së aftësive psiko-fizike të zyrtarit përkatës-personel i aviacionit civil.

Më datën 14 tetor 2022 në kuadër të planit të aktiviteteve mbikëqyrëse të AAC u zhvillua auditimi i rregullt i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës (QKMP) në Gjakovë e cila është e autorizuar në cilësinë e Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC-Aero-Medical Centre).

Më datë 31 tetor dhe 01 nëntor 2022 në Qendrën Aero-mjekësore në Gjakovë janë kryer ekzaminimet mjekësore për 15 (pesëmbëdhjetë) kontrollorë të trafikut ajror të Agjencisë se Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA).

Më datë 02 nëntor 2022 me ftesë të Kabinetit të U.D të Ministrit të Shëndetësisë, është zhvilluar takimi ndërinstitucional në mes të përfaqësuesve të AAC-së, të Ministrisë së Shëndetësisë, të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK-së) dhe të Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë. Temë kryesore ishte gjetja e rrugëzgjidhjes që një mjek nga përbërja e personelit të Qendrës në Gjakovë të aftësohet në fushën e mjekësisë së aviacionit, aftësim ky që mund të kryhet vetëm jashtë vendit;

Më datë 13 dhjetor 2022 është dorëzuar Raporti i auditimit të Qendrës në Gjakovë i cili rezultoi me një gjetje të nivelit të dytë dhe një rekomandim. Ky raport ju dorëzua Qendrës, e cila pasi u pajtua me gjetjen e pranoi raportin në fjalë;

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoM) në mes të AACK dhe AACSh, më datë 27 dhjetor 2022, me ftesë të AACSh, është realizuar një vizitë pune e mjekut AMA në Tiranë. Gjatë vizitës, u shqyrtua aplikimi për ri-certifikim i mjekut AME të autorizuar nga AACSh, si dhe u administruan Raportet e ekzaminimeve mjekësore që u dorëzuan në Sektorin e Licencimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit Ajror në periudhën shtator-nëntor 2022 nga ana e Qendrës Aero-Mjekësore (AeMC) – Spitalit "Salus" në Tiranë;

### 6.11 Mjetet ajrore të ndaluara në Kosovë

Bazuar në legjislacionin Evropian, i transponuar në vendin tonë konform marrëveshjes për HPEA, ekzistojnë kompani ajrore janë të cilat janë të ndaluara të operojnë në hapësirën ajrore evropiane duke përfshirë edhe hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, pasiqë këto kompani ajrore janë të pa sigurta dhe/ose ju mungon mbikëqyrja e mjaftueshme nga autoritetet e tyre përkatëse të licencimit. Lista e kompanive ajrore të ndaluara hartohet nga Komisioni Evropian në konsultim të ngushtë me autoritetet e sigurisë së aviacionit të të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tyre.

Sipas nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, aeroplanët e kompanive ajrore që u është ndaluar nga Bashkimi Evropian (BE) të operojnë në hapësirën ajrore të shteteve anëtare të BE-së, nuk u lejohet të fluturojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Për më tepër, lista e përditësuar e BE-së e kompanive ajrore të ndaluara është e postuar në faqen zyrtare të internetit të AAC-së. Gjatë vitit 2022 nuk është realizuar asnjë fluturim i ndonjë kompanie nga kjo listë e BE-së në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

### 6.12 Mjetet ajrore civile të regjistruara dhe ato të larguara nga regjistri i mjeteve ajrore civile

Në vitin 2022 AAC-ja nuk ka regjistruar apo larguar nga regjistri i mjeteve ajrore civile asnjë mjet ajror.

## 6.13 Licencat, certifikatat dhe lejet e aprovuara, përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre

| Licencë/certifikatë/leje | Referenca në aktet ligjore | Numri |
|---|---|---|
| Leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit | Neni 57 i LAC dhe Rregullore 04/2020 | 209 |
| Leje për operime të aviacionit të përgjithshëm | LAC, Neni 2 dhe 75 | 14 |
| Leje për regjistrimin e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot | Rregullore 01/2021 | 27 |
| Leje për operim të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot me regjistrim të huaj | Rregullore 01/2021 | 10 |
| Gjoba për operim të pa-autorizuar të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot | Rregullore 01/2017 | 14 |
| Licenca për pilot të paraglajdit | Rregullore 06/2020 | 1 |
| Licenca për pilot të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot | Rregullore 01/2021 | 1 |
| Certifikatë mjekësore, klasa 3 | LAC, Neni 37 | 19 |
| Certifikatë mjekësore, klasa 2 | LAC, Neni 37 | - |
| Certifikatë mjekësore, klasa 1 | LAC, Neni 37 | - |

# 7. SHËRBIMET E NAVIGACIONIT AJROR

Më 19 gusht 2016, AAC-ja e ka certifikuar ASHNA-n për një periudhë 5 vjeçare për ofrimin e këtyre shërbimeve: shërbimet e trafikut ajror (KTA), shërbimet e komunikimit, navigimit dhe survejimit (KNS), shërbimet e informatave aeronautike (SHIA) dhe shërbimet meteorologjike (MET). Certifikata është lëshuar në bazë të nenit 78 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe kritereve të sigurisë, qëndrueshmërisë ekonomike dhe sigurimit që dalin nga Rregulloret nr. 9/2009 dhe nr. 7/2012, që transponojnë në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës Rregulloren (KE) nr. 550/2004 dhe Rregulloren (KE) nr. 1035/2011 përkatësisht.

Pas përfundimit të periudhës 5 vjecare, ASHNA ka aplikuar formalisht për ripërtërirje të certifikatës me 09.07.2021. Ky proces është verifikuar gjatë auditimeve të vazhdueshme dhe konform kërkesave të përbashkëta të përshkruara në Rregulloren nr. 09/2020, që transponon Rregulloren nr. 2017/373 të BE-së dhe të cilat janë kusht për certifikim si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, si dhe në Rregulloren nr. 01/2018 mbi kërkesat për ofruesit e shërbimeve në lidhje me trajnimin dhe vlerësimin e kompetencës për personelin e elektronikës të sigurisë të trafikut ajror (ATSEP).

## 7.1 Mbikëqyrja e vazhdueshme e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) është certifikuar si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror për herë të parë më 19 gusht 2016 dhe ricertifikuar më 19 gusht 2021. Departamenti i SHNA-së është përgjegjës për të mbikëqyrur mirëmbajtjen dhe respektimin e kushteve të certifikatës nga ana e ASHNA-s, përmes auditimeve të rregullta, vizitave dhe inspektimeve ad-hoc.

Gjatë vitit 2022, AAC-ja ka realizuar katër auditime sipas planifikimeve vjetore për auditime dhe katër auditime të sistemeve të reja të instaluara, duke verifikuar njëherit përmbushjen e kërkesave rregullative.

## 7.2 Auditimet

### a) Auditimi në periudhën 14-18 mars 2022

Gjatë periudhës 14-18.03.2022, është realizuar auditimi i sigurisë në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Qëllimi i auditit ka qenë verifikimi i përmbushjes së kërkesave të Rregullores nr. 09/2020 mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, përkatësisht Aneksin IV mbi kërkesat specifike për Ofruesit e Shërbimeve të Trafikut Ajror (Pjesa–ATS), përkatësisht seksionin 1, 2 dhe 3. Po ashtu është audituar edhe Rregullorja nr. 02/2016, e cila transpozon Aneksin 10 të ICAO-s për telekomunikacionin aeronautik, Rregullorja nr. 04/2019 mbi vendosjen e kërkesave për ndarjen e kanaleve të

komunikimit me zë për Qiellin e Vetëm Europian dhe Rregullorja nr. 16/2010 mbi vendosjen e kërkesave për aplikimin e protokolit për transmetimin e porosive të fluturimit.

Gjatë këtij auditimi janë identifikuar 2 gjetje dhe 4 observime.

### b) Auditimi i "Sistemi i radio-komunikimit ASHNA-Golesh"

Më 6 prill 2022, është realizuar auditimi në lidhje me verifikimin e mbarëvajtjes së implementimit të ndryshimit "Sistemi i radio komunikimit ASHNA-Golesh".

Gjatë auditit, për secilin sistem është konfirmuar statusi i implementimit dhe është verifikuar përmbushja e rekomandimeve të dala nga vlerësimet e sigurisë, si dhe është përgatitur raporti i auditimit mbi ndryshimin e radiokomunikimit, i realizuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, AACK/SHNA/AUDIT/1-31. Sistemet e radikomunikimit ASHNA-GOLESH, për të cilat u realizu auditimi, përfshijnë sisitemet si: VCSS SITI, VCR, Radiot Jotron dhe Frekuencat e reja.

Lloji i këtij auditi të realizuar ndërlidhet me auditimet të cilat realizohen para pranimit të ndryshimit nga ana e AAC-së. Pranimi i ndryshimit shtjellohet edhe tek pjesa për ndryshime, në vijim të këtij raporti.

### c) Auditimi i "Sistemi AIM"

Më datë 12 maj 2020, nga ASHNA është pranuar kërkesa për miratim final të ndryshimit "Sistemi AIM", së bashku me planin e veprimit të sigurisë DOV si dhe dokumentin e miratuar nga ASHNA për hyrjen në operim të sistemit AIM.

Në datat 17 dhe 19 maj 2022, Departamenti i SHNA-së ka realizuar një auditim të dedikuar në ASHNA për të audituar këtë ndryshim. Gjatë auditimit, për secilin nën-sistem është konfirmuar statusi i implementimit, si dhe është verifikuar përmbushja e rekomandimeve të dala nga vlerësimet e sigurisë. Për këtë auditim është përgatitur raporti i auditimit të sigurisë i realizuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, 2022 AACK/SHNA/AUDIT/1-32".

SHNA-ja ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA për sistemin AIM, përfshirë: AeroDB, CRONOS, eTOD, ICE, FPDAM, FPSAT, WePub, AIM Portal, PLX.

Trajtimi i ndryshimit "Sistemi AIM" do të shtjellohet tek kapitulli i ndryshimeve në vazhdim të këtij raporti.

### d) Auditimi i "Sistemi i ri i Survejimit"

Auditimi i gjendjes së këtij sistemi, përkatësisht Radarit të instaluar në Gjakovë, u verifikua në auditimin dy ditor të datës 11.05.2022, të realizuar në ASHNA dhe vizitës

në terren, të realizuara në vendin e instalimit të Radarit, pra në aeroportin e Gjakovës me 13.05.2022.

Gjatë auditimit është vërejtur që si projekt ka qenë shumë afër përfundimit, pasi që punët teknike kishin përfunduar, përfshirë këtu montimin e kokës radarike, sistemin e procesimit të të dhënave, UPS-ave për të garantuar vazhdimin e funksionimit në rast të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike dhe monitorëve për vizualizim të të dhënave radarike dhe atij për monitorim në rast të ndonjë keqfunksionimi.

Ky ndryshim ende nuk është pranuar nga AAC-ja.

**e) Auditimi në periudhën 12-15 dhe 20-22 korrik 2022**

SHNA-ja ka realizuar auditimin nga 12-15 dhe 20-22 korrik 2022, në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA). Qëllimi i auditit ka qenë verifikimi i përmbushjes së kërkesave të Rregullores nr. 09/2020 mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, përkatësisht Aneksin VI kushtet specifike për ofruesit e shërbimeve të informacioneveaeronautike (Pjesa-AIS), Aneksi VIII kushtet specifike për ofruesit e shërbimeve të komunikimit, navigimit ose mbikëqyrjes (Pjesa-CNS). Po ashtu janë audituar edhe Rregullorja nr. 03/2011 mbi kalibrimin e instalimeve aeronautike nga ajri, Rregullorja nr. 09/2014 mbi hartat aeronautike, Rregullorja nr. 01/2022, e cila ndryshon Rregulloren nr. 01/2020, Rregulloren nr. 17/2017 dhe Rregulloren nr. 09/2020 në lidhje me kërkesat për menaxhimin e trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror, projektimin e strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësinë e të dhënave, sigurinë e pistës dhe shfuqizon Rregulloren nr. 08/2015, dhe si rrjedhojë ka qenë subjekt i auditimit. Po ashtu, është audituar edhe Rregullorja nr. 10/2011 mbi aprovimin e procedurave të fluturimit.

Ekipi i auditorëve, gjatë kësaj periudhe audituese ka identifikuar gjithsej 7 gjetje dhe 7 observime. SHNA-ja ka pranuar planin me hapat korrektues dhe me afatet e propozuara për implementimin e gjetjeve.

**f) Auditimi "Sistemet e Meteorologjisë"**

Data 20.07.2022 është dedikuar për auditimin e sistemeve të reja të meteorologjisë, të instaluara në ASHNA. Qëllimi i auditimit ka qenë verifikimi i mbarëvajtjes së implementimit të ndryshimit për sistemet e METEO-s, si pjesë e ndryshimit në kuadër të projektit të zgjatjes së pistës, dhe përmbushja e rekomandimeve të sigurisë të dala nga vlerësimet përkatëse të sigurisë.

Në kuadër të zgjatjes së pistës parashihej instalimi i një sistemi të ri AWOS (Cat III), azhurnimi i AWOS-it ekzistues, instalimi i sistemit VOLMET dhe i sistemit të parashikimit.

Gjatë auditit SHNA-ja është informuar se pjesa e ndryshimit, përditesimi i sistemit ekzistues AWOS (sistemi i vjetër i AWOS-it), nuk është realizuar sipas kërkësave të

specifikacionit teknik fillestar, pasi që operatori ekonomik, ka vlerësuar që është më e përshtatshme të instalohet komplet një sistemi i ri back-up i AWOS-it se sa të bëhet përditesimi i sistemtit ekzistues, duke marrë parsysh që ky sistem është isntaluar në vitin 2004.

Gjatë auditimit është realizuar një vizitë në terren, ku janë parë nga afër të gjithë sesnorët e instaluar në pozicionet e duhura pranë pistës. Si rrjedhojë, gjatë auditimit të realizuar më 20 korrik, të dedikuar për sistemin AWOS, Volmet dhe ATIS, nuk është identifikuar ndonjë gjetje.

**g) Auditimi në periudhën 03-07 tetor 2022**

SHNA-ja ka realizuar auditimin e sigurisë nga 3 deri me 7 tetor 2022, në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA). Qëllimi i auditimit ka qenë verifikimi i përmbushjes së kërkesave të Rregullores nr. 09/2020 mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, përkatësisht Aneksi V për kërkesat specifike për ofruesit e shërbimeve meteorologjike (Pjesa-MET), të Rregullores nr. 09/2017 në lidhje me Raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil, të Rregullores nr. 09/2009, përkatësisht të Kapitullit II në lidhje me rregullat për ofrimin e shërbimeve, si dhe ët Rregullores nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

Rregullorja nr. 09/2020, tek Pjesa-AIS është ndryshuar me Rregulloren 01/2022, e cila ndryshon Rregulloren nr. 01/2020, Rregulloren nr. 17/2017 dhe Rregulloren nr. 09/2020 në lidhje me kërkesat për menaxhimin e trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror, projektimin e strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësinë e të dhënave, sigurinë e pistës dhe shfuqizon Rregulloren nr. 08/2015, dhe si rrjedhojë ka qenë subjekt i auditimit. Po ashtu, është audituar edhe Rregullorja nr. 10/2011 mbi aprovimin e procedurave të fluturimit.

Ekipi i auditorëve, gjatë kësaj periudhe audituese ka identifikuar gjithsej 6 gjetje dhe 2 observime. Më 09.11.2022, SHNA-ja ka pranuar planin me hapat korrektues dhe me afatet e propozuara për implementimin e gjetjeve.

**h) Auditimi në periudhën 19-23 dhjetor 2022**

Gjatë periudhës së tremujorit të fundit, SHNA-ja ka realizuar auditimin e sigurisë në periudhën 19-23 dhjetor 2022, në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Qëllimi i auditimit ka qenë verifikimi i kërkesave rregullative të Rregullores nr. 19/2017 e cila ka të bëjë me kërkesat teknike dhe procedurat administrative që ndërlidhen me licencat dhe certifikatat e KTA-ve, të Rregullores nr. 07/2018 në lidhje me kërkesat për identifikimin e vëzhgimin aeroplanëve për Qiellin e Vetëm Evropian, si dhe të Rregullores nr. 04/2019 në lidhje me vendosjen e kërkesave për ndarjen e kanaleve të komunikimit me zë për Qiellin e Vetëm Evropian.

Gjatë këtij auditimi është identifikuar një gjetje. Raporti i auditimit pritet të dorëzohet gjatë muajit janar 2023, sipas afateve procedurale të SHNA-së.

### 7.3 Auditimi vlerësues nga EASA

Më 26 tetor 2017, AAC-ja ka pranuar raportin final të auditimit vlerësues të EASA-s, të mbajtur në periudhën 21-25 nëntor 2016 në AAC. Edhe pse ky raport është pranuar me pothuajse një vit vonesë, Departamenti i SHNA-së ka vazhduar adresimin e gjetjeve të identifikuara gjatë këtij auditimi në përputhje me planin e përpiluar të hapave korrektues. Më 20 dhjetor 2017, plani i hapave korrektues i është dorëzuar ekipit auditues të EASA-s, ndërsa plani është pranuar zyrtarisht nga EASA më 23 shkurt 2018.

Plani fillestar (Versioni 8.0) i dorëzuar tek EASA ka përmbajtur 49 hapa korrektues të cilët adresojnë 23 gjetjet e ngritura nga ekipi auditues. Të gjithë 49 hapat e propozuar nga AAC-ja kanë qenë të pranueshëm nga EASA, por është kërkuar edhe shtimi/propozimi i disa hapave të tjerë, duke rezultuar me gjithsej 58 hapa në planin e fundit (Versioni 10.0), i cili është pranuar zyrtarisht më 23 shkurt 2018. Në ndërkohë, pas komunikimeve me EASA-n është kaluar edhe në Versionin 11 dhe 12 të planit korrektues me 57 veprime korrektuese.

Më 17 maj 2019, Departamenti i SHNA-së ka dorëzuar Versionin 13.0 të Planit të Veprimeve Korrigjuese (Corrective Action Plan - CAP). Më 18 korrik 2019, SHNA-ja ka pranuar njoftimin nga udhëheqësi i ekipit vlerësues të EASA-s se dëshmitë e dorëzuara në maj të vitit 2019, si dhe Versioni 13.0 i Planit të Veprimeve Korrigjuese, janë të pranueshme për ta. Momentalisht, nga gjithsej 57 hapa sa janë gjithsej, 55 janë të mbyllur.

Gjatë vitit 2021 janë përmbushur edhe 2 hapat e mbetur me Versionin 14.0 të CAP. Ky CAP është dorëzuar tek EASA me 15.02.2022, duke ndjekur proceduren e mëhershme të shkëmbimit të dokumenteve/evidencave. Por SHNA-ja nuk ka pranuar ende një përgjigje.

### 7.4 Mbikëqyrja e ASHNA-s si Organizatë Trajnuese (OT)

ASHNA është certifikuar më 19 dhjetor 2017 nga AAC-ja për një periudhë 3 vjeçare për të ofruar shërbimet që i takojnë një Organizate Trajnuese për Kontrollorët e Trafikut Ajror (KTA), siç janë: trajnimet për njësi për KTA dhe trajnimet e vazhdueshme për KTA.

Procesi i certifikimit ka filluar në vitin 2016 kur ASHNA ka aplikuar për certifikim. Me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 19/2017 të AAC-së, e cila zëvendësoi Rregulloren nr. 05/2012, në bazë të së cilës në atë kohë ASHNA ishte u certifikuar si OT, AAC-ja ishte obliguar që të bëjë zëvënësimin e certifikatës së atëhershme në formatin e ri të përcaktuar në Rregulloren nr. 19/2017. Në përputhje me këtë kërkesë, më 04.01.2019 AAC-ja ka zëvëndësuar certifikatën e lëshuar në vitin 2017 me certifikatën CAAK/ANS/1-2019, sipas formatit të ri të paraparë me rregulloren e lartpërmendur.

Që nga koha e certifikimit, ASHNA OT është audituar disa herë përgjatë këtyre viteve nga Departamenti i SHNA-së, brenda kornizave të procesit të mbikëqyrjes së vazhdueshme, për të garantuar dhe verifikuar se OT vazhdon të plotësojë të gjitha kërkesat e rregullores.

Lëshimi i Certifikatës dëshmon për sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, por që kërkon angazhim të vazhdueshëm nga ana e ASHNA-s për respektimin e kushteve të certifikimit dhe për ngritje edhe më tutje të cilësisë së shërbimeve.

### 7.5 Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s

Gjatë vitit 2022, AAC-ja ka trajtuar ndryshimet si më poshtë:

#### a) Ndryshimi CH/2022/04 - Integrimi i sistemeve të Kullës së Trafikut Ajror

Më 21.03.2022, duke iu referuar disa takimeve të realizuara ndërmjet ASHNA-s dhe AAC-së, përkatësisht auditimit të muajit mars, ASHNA ka bërë kërkesë pranë SHNA-së për rishikimin dhe riklasifikimin e ndryshimit nga madhor në atë minor.

Pas dërgimit të dokumentacionit në lidhje me këtë ndryshim si dhe bazuar në bisedat gjatë auditimit në ASHNA (14-18 mars 2022), ku SHNA-ja ka parë nga afër implementimin e këtij ndryshimi, si dhe duke iu referuar takimit/vizitës të muajit shtator të vitit 2021, ky ndryshim është riklasifikuar si ndryshim i vogël dhe është vazhduar me implementim sipas procesit dhe procedurës së ndryshimit që është pjesë e Manualit MMS të ASHNA-s.

#### b) Ndryshimi “Sistemi për shkëmbim të të dhënave operacionale (Operational data exchange system)”

Më 30.03.2022 është njoftuar ndryshimi “Operational data exchange system”, për të cilin ASHNA ka dorëzuar dy dokumente (PSF22-003-CHN Operational data exchange system dhe PSF22-003-SAA Concept Document  Operational data exchange system).

Në lidhje me këtë ndryshim është inicuar edhe vlerësimi i sigurisë i cili do të dërgohet në AAC.

#### c) Ndryshimi CH/2018/08 - Zgjatja e pistës

##### i. “Sistemi i radio komunikimit ASHNA-Golesh”

Sistemi i radio komunikimit ASHNA-Golesh është pjesë e ndryshimit “CH/2018/08 - Zgjatja e pistës”.  Më 21.03.2022, me kërkesën për klasifikim, ASHNA ka dorëzuar:

- Vlerësimin e sigurisë "Ndryshimi i radio frekuencave", versioni 1.0, datë 10.02.2020;
- Dokumentin "Autorizim individual për radio frekuenca", datë 13.07.2020;
- Dokumentin "Autorizim individual për radio frekuenca", datë 24.06.2021.

Mirëpo, ASHNA është njoftuar që ndryshimi është në kuadër të ndryshimit "Zgjatja e pistës" dhe që do të trajtohet në kuadër të këtij ndryshimi.

Siç është cekur edhe më lart, Sistemi i radio komunikimit ASHNA-Golesh është pjesë e ndryshimit "CH/2018/08 - Zgjatja e pistës", i cili është njoftuar me 22 maj 2018.

Në bazë të Rregullores së AAC-së nr. 09/2020 mbi mbikëqyrjen e sigurisë së shërbimeve të navigacionit ajror si dhe Rregullores së AAC-së nr. 11/2009 për ndërveprueshmëri (Interoperability), SHNA-ja ka kërkuar nga ASHNA që për secilin sistem të bëhet nga një dosje e cila do të përfshinte Vlerësimin e plotë të Sigurisë, Planet e veprimeve, Dosjen teknike, Specifikacionet relevante teknike, Deklaratën e Verifikimit (DoV) , "flight check", si dhe evidencat për realizimin dhe verifikimin e sistemeve. SHNA-ja ka mbikëqyrur vazhdimisht implementimin e këtij ndryshimi, si gjatë auditimeve të planifikuara, ashtu edhe me anë të auditimeve dhe inspektimeve ad-hoc.

Më 06 prill 2022, SHNA-ja ka realizuar një auditim të dedikuar në ASHNA për të audituar këtë ndryshim. Për këtë auditim është shkruar edhe më lart, tek pjesa e auditimeve (Pika 7.2) e këtij raporti.

Më 30 maj 2022, është pranur kërkesa nga ASHNA për largimin e VCSS Garex nga miratimi, pasi që për momentin nuk ka qenë e mundur të realizohet pranueshmëria në vendin e instalimit (SAT). Më 31 maj 2022, AAC-ja ka miratuar këtë kërkesë dhe ka njoftuar ASHNA që në momentin e realizimit të SAT për VCSS Garex të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm dhe se ndryshimi do të trajtohet ndaras. Gjithashtu, më 01.06.2022, në lidhje me këtë ndryshim SHNA-ja ka realizuar edhe një takim me ASHNA-n, me ç'rastë është vendosur që të dërgohet dokumentacioni që kërkohet në raportin e auditimit, por pa përfshirë VCSS Garex.

Më 06 qershor 2022, SHNA-ja ka pranur versionet finale të dokumenteve për këtë ndryshim dhe ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA, ku ka vërejtur se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar dhe konform rregulloreve në fuqi për Sistemin e radio komunikimit ASHNA- GOLESH, duke përfshirë: VCSS SITI, VCR, Radiot Jotron dhe Frekuencat e reja.

Andaj, nga sa u tha më sipër, duke iu referuar auditimeve, inspektimeve dhe dokumentacioneve në lidhje me këto procedura, më 09.06.2022 është bërë pranimi i këtij ndryshimi.

### ii. Ndryshimi në lidhje me Sistemin e Komunikimit VCSS GAREX

Sistemi i radio komunikimit, përfshirë edhe përditësimin e sistemit GAREX, ka qenë pjesë e ndryshimit "CH/2018/08 - Zgjatja e pistës".

Ndryshimi në lidhje me pjesën tjetër të Sistemit të Radio Komunikimit VCSS ka qenë i pranuar më parë, sqaruar në pikën i. më sipër, mirëpo jo edhe pjesa për GAREX, pasi që në atë kohë ekzistonin disa probleme teknike, që ndërlidheshin me kalimin automatik nga kanali A dhe B i këtij Sistemi dhe si rrjedhojë ky system nuk e ka kaluar pranimin teknik SAT. Bazuar në këtë rast, aprovimi i sistemit GAREX ishte shtyer deri në rregullimin e këtij problemi.

SHNA-ja nga 03 deri më 07 tetor 2022 ka realizuar një auditim të planifikuar në ASHNA, pjesë e të cilit ka qenë edhe sistemi VCSS GAREX, me ç'rast është vërtetuar se kalimi automatik nga kanali A dhe B ishte i mundur dhe që ishin plotësuar kushtet për aprovimin e ndryshimit.

Andaj, nga sa u tha më sipër, duke iu referuar auditimeve, inspektimeve dhe dokumentacioneve në lidhje me këtë sistem, ndryshimi i Sistemit VCSS GAREX, si pjesë e projektit "zgjatja dhe ngritja e kapaciteteve të pistës", është pranuar më 09.11.2022, pasi që ishin marrë të gjitha masat për të evituar ndonjë problem në sigurinë e operimeve dhe pas përmbushjes së të gjitha kërkesave që dalin nga rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

### iii. Ndryshimi "Procedurat PBN"

Edhe ky ndryshim është implementuar në kuadër të projektit të zgjatjes së pistës në vitin 2018.

Më 02 qershor 2022, SHNA-ja ka pranuar dokumentin "Airspace Change", dhe pas rishikimit ishin vërejtur disa mospërputhshmëri dhe është kërkuar nga ASHNA që t´i përmirësonte ato dhe ta ridërgonte këtë dokument së bashku me shtojcat relevante.

Më 08 qershor 2022, SHNA-ja ka pranur versionin final të dokumentit "Airspace change" përmes të cilit pasqyrohet ndryshimi i hapësirës ajrore së bashku me të gjitha dokumentet relevante që kërkohen me procedurat në fuqi për këtë lloj ndryshimi.

Departamenti i SHNA-së ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA, përfshirë edhe dokumentin "Airspace change" dhe "flight check-ut", dhe ka konstatuar se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar dhe konform rregulloreve në fuqi për Procedurat e Fluturimit PBN si në vijim:

- BKPR_PBN_IAC_RWY17,
- BKPR_PBN_ILS_LOC_Y_RWY17,
- BKPR_SID_PBN_RWY17,
- BKPR_STAR_RNAV_RWY17,

- BKPR_PBN_IAC_RWY35,
- BKPR_PBN_TO_ILS_IAC_RWY35,
- BKPR_SID_PBN_RWY3,
- BKPR_STAR_RNAV_RWY35.

Andaj, nga sa u tha më sipër, duke iu referuar auditimeve, inspektimeve dhe dokumentacioneve në lidhje me këto procedura, më 09 qershor është bërë pranimi i këtij ndryshimi.

#### iv. Ndryshimi "Sistemet e Meteorologjisë"

Sistemet e meteorologjisë janë pjesë e ndryshimit "CH/2018/08 - Zgjatja e pistës".

Në bazë të Rregullores së AAC-së nr. 09/2020 mbi mbikëqyrjen e sigurisë së shërbimeve të navigacionit ajror si dhe Rregullores së AAC-së, nr. 11/2009 për ndërveprueshmëri (Interoperability), SHNA-ja ka kërkuar nga ASHNA që për këtë sistem të bëhet dosja e cila do të përfshinte Vlerësimin e plotë të Sigurisë, Planet e veprimeve, Dosjen teknike, Specifikacionet relevante teknike, Deklaratën e Verifikimit (DoV), SWAL, trajnimet e stafit, si dhe evidencat për realizimin dhe verifikimin e sistemeve.

Më 08 korrik 2022, SHNA-ja ka pranuar dokumentacionin përfundimtar, me ç'rast pas rishikimit të tyre, është planifikuar dhe më 20 korrik 2022 është realizuar auditimi i dedikuar për këtë ndryshim, për të cilin u diskutua tek pjesa e auditimeve (Pika 7.2) e këtij raporti.

SHNA-ja ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA për këtë ndryshim dhe ka konstatuar se i gjithë dokumentacioni ishte i kompletuar dhe konform rregulloreve në fuqi për sistemet në vijim:

- Komplet sistemin e ri të AWOS-it;
- Komplet sistemin back-up të AWOS-it;
- Sistemin VOLMET; dhe
- Sistemin ATIS.

Andaj, duke iu referuar auditimeve, inspektimeve dhe raportit të detajuar të përpiluar nga Inspektorët e SHNA-së, ky ndryshim u pranua më 01 gusht 2022.

### d) Ndryshimi CH/2021/01 "Operimet në Kukës"

Më 25.02.2022, ASHNA ka dorëzuar kërkesën për pranimin e ndryshimit në lidhje me operimet në Kukës së bashku me dosjen për "Airspace Change Proposal".

Duke i'u referuar komunikimeve për këtë çështje dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar, SHNA ka konfirmuar që janë plotësuar kërkesat teknike

sipas legjislacionit në fuqi, andaj Departamenti i SHNA-së nuk ka pasur kërkesa tjera sa i përket këtij ndryshimi.

SHNA pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik i cili bie në fushëveprimin e SHNA-së, me 25.02.2022 ka pranuar nga aspekti teknik ndryshimin "CH/2021/01".

Deri në ndryshimet në NATO SPINS që është paralajmëruar nga KFOR se do te ndodhë në janar të vitit 2023, publikimi i RMZ1 si pjesë e ndryshimit është bërë përmes NOTAM.

**e) Ndryshimi CH-2019-06 "Sistemi AIM"**

Ndryshimi CH-2019-06 "Sistemi AIM", është njoftuara nga ASHNA më 24 tetor 2019 dhe ka të bëjë me furnizim me sistemin Aeronautical Information Management (AIM).

Sikurse në rastin e mëparshëm është kërkuar që të bëhet dosja e cila do të përfshinte vlerësimin e plotë të sigurisë, planet e veprimeve, dosjen teknike, specifikacionet relevante teknike, DOV, si dhe evidencat për realizimin dhe verifikimin e sistemeve.

Po ashtu, deparamenti i SHNA-së ka mbikëqyrur vazhdimisht implementimin e këtij ndryshimi madhor, si gjatë auditimeve të planifikuara ashtu edhe me anë të auditeve ad-hoc dhe inspektimeve.

Me datë 12 maj 2020, nga ASHNA kemi pranuar kërkesen për miratim final të këtij ndryshimi, së bashku me planin e veprimit të sigurisë, DOV si dhe dokumentin e miratuar nga ASHNA për hyrje në operim të sistemit AIM.

SHNA në datat 17 dhe 19 maj 2022 ka realizuar një audit të dedikuar në ASHNA për këtë ndryshim. Gjatë auditit, për secilin nën-sistem është konfirmuar statusi i implementimit, si dhe është verifikuar përmbushja e rekomandimeve të dala nga vlerësimet e sigurisë, i elaboruar në pjesën më lartë.

Departamenti i SHNA-së ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA, dhe kemi vërejtur se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar dhe konform rregullorve në fuqi për sistemin AIM përfshirë AeroDB, CRONOS, eTOD, ICE, FPDAM, FPSAT, WePub, AIM Portal dhe PLX.

Andaj nga sa u tha më lartë, duke iu referuar auditimeve, inspektimeve dhe raportit të auditi, me 03 qershor është bërë prani i pjesshëm i ndryshimit "Sistemi AIM", pasi që janë marrë të gjitha masat për të evituar ndonjë problem në sigurinë e operimeve dhe se përmbushen të gjitha kërkesat që dalin nga rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

**f) Ndryshimi "Sistemi i ri i Survejimit"**

Me 09.12.2022 përmesë një emaili ASHNA ka paraqitur kërkesen për aprovimin e ndryshimit **PSF18-005-SAA Sistemi i ri i Survejimit,** i cili është instaluar në lokacionin e Aeroportit të Gjakovës. Dokumentet e dorëzuara në lidhje me këtë ndryshim janë:

- Njoftimi i ndryshimit;
- Vlerësimi i Sigurisë;
- Dosja teknike (FAT, SAT trajnimet, specifikimi teknik);
- Planin e sigurisë (plani i veprimit dhe zbatimi i masave mitiguese nga SAA);
- DOV; dhe
- EC Decleration.

Pas pranimit dhe analizimit të këtyre dokumenteve dhe referuar raportit të auditit të realizuar për këtë system me 11 deri me 13 maj 2022 u kërkua të dërgohen edhe dokumentet si në vijim:

- SWAL (garantimi i nivelit të softverit);
- Dëshminë për Interoperabilitet;
- Flight check report, i nënshkruar;
- SAT-i i nënshkruar;
- Dëshmi për vendosje të linjave të komunikimit Aeroport i Gjakovës - ASHNA; dhe
- DoV (Deklarata e verifikimit) e riplotësuar.

Pas pranimit të këtyre dokumenteve, do të shqyrtohet pranimi i ndryshimit nga SHNA.

## 7.6 Dekomisionimi i pajisjeve/sistemeve në ASHNA

**a) Dekomisionimi i gjeneratorit 500KW Konçar**

Me 15.08.2022, ASHNA ka dorëzuar dokumentin PSF22-007-CHN përmes së cilit njoftohet inicimi i procedures së dekomisionimi të gjeneratorit 500KW Konçar me lokacion te Kulla e Vjetër.

SHNA duke i'u referuar ndryshimeve paraprake në lidhje me dekomisionimin e pajisjeve që janë jasht funksionit (viti 2013), si dhe procedurës për dekomisionim në MMS-in e ASHNA-së, ka kërkuar të dërgohet edhe dokumentacioni si në vijim:

1. Argumenti i Sigurisë (Safety Argumentation);
2. Raporti i njësisë përgjegjese për mirëmbajtjen e gjeneratorit përmes të cilit konfirmohet se ky dekomisionim nuk ka ndonjë efekt në sigurinë e operimeve.

Këto dokumente u dorëzuan me 16.08.2022.

**b) Dekomisionimi i gjeneratorëve 2x250KW, DVOR-it të vjetër dhe pajisjeve të Meteorologjisë**

Me 05.09.2022, ASHNA ka dorëzuar dokumentet për dekomisionimin e gjeneratorëve 2x250KW në lokacionin e Kullës së Vjetër, DVOR-it të vjetër dhe pajisjeve të Meteorologjisë.

Si në rastin më lartë ASHNA ka dorëzar dokumentet e kërkuara ndërsa SHNA e ka njoftuar që këto ndryshime klasifikohet si ndryshime që nuk ka nevojë të rishikohen nga AAC, por duhet te implementohen bazuar në procedurën për ndryshimet sipas MMS-it të ASHNAs.

## 7.7 Lëshimi i licencave për kontrollorët e trafikut ajror dhe vlerësimi i gradimeve

AAC-ja është përgjegjëse për lëshim dhe ripërtëritjen e licencave të kontrollorëve të trafikut ajror, të cilët ofrojnë shërbimet e kontrollit ajror në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror në sigurinë e fluturimeve, kontrollorët duhet të përmbushin një varg të kërkesave dhe kushteve për të mirëmbajtur licencat dhe miratimet e tyre, të cilat dalin nga Rregullorja nr. 19/2017 e AAC-së që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

Kërkesat kryesisht ndërlidhen me nivelin e kompetencës profesionale, që përfshijnë ndjekjen e trajnimeve profesionale përditësuese dhe ushtrimin e detyrave të kontrollorit të trafikut ajror për një numër të caktuar të orëve brenda vitit. Kontrollorët gjithashtu, në baza vjetore, i nënshtrohen vlerësimit profesional për të verifikuar nivelin e aftësive.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe zotërimit të gjuhës angleze, pasi që komunikimi në aviacionin ndërkombëtar bëhet në këtë gjuhë. Niveli i zotërimit të gjuhës angleze vlerësohet në mënyrë periodike dhe merret parasysh gjatë lëshimit apo ripërtëritjes së licencës. Kontrollorët gjithashtu duhet të kenë shëndet të mirë, në përputhje me kërkesat ligjore, dhe kjo verifikohet në mënyrë të rregullt nga AAC-ja si pjesë e procesit të licencimit.

Detajet me licencat e ripërtërira dhe rivalidim të gradimeve, për vitin 2022, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

| Licencimi i Kontrollorëve të Trafikut Ajror (KTA) | Numri i të licencuarve |
|---|---|
| Ripërtërirja e licencave për KTA-të (miratimeve të njësisë) | 1 |
| Licensim i KTA-ve te rinjë | 5 |
| Rivalidimi i miratimeve të gjuhës | 4 |
| Rivalidimi/ripërtëritja e gradimeve për instruktorë/asesorë | 19 OJTI<br>6 Asesorë |
| Licencimi i studentëve KTA | 0 |

### 7.8 Publikimi i Informatave Aeronautike

Gjatë tremujorit të parë është publikuar AIP AMDT 01/2022, me data efektive 28 janar 2022, dhe një AIP AIRAC 02/2022, me datë të publikimit 24.02.2021, ndërsa me datë efektive 24.03.2022, të cilët përmbajnë informata të cilat është dashur të publikohen në dokumentin e Publikimit të Informatave Aeronautike (AIP), sipas afateve kohore të parapara.

Po ashtu, gjatë tremujorit të parë janë publikuar: NOTAM-i A0028/22, i cili e zëvendëson A0646/21, NOTAM-i A0092/22, i cili e zëvendëson NOTAM-in A0055/22, në kuadër të masave të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhes prill-qershor është publikuar AIP AIRAC 03/2022 dhe është dhënë aprovimi për vazhdim të procedurave të publikimi të AIP AIRAC 04/2022, me datë të publikimit 14.07.2021, ndërsa me datë efektive 11.08.2022.

Gjatë periudhës korrik-shtator është publikuar AIP AIRAC 05/2022, publikuar më 11 gusht dhe bërë efektiv më 08.09.2022, AIP SUP 01/2022 publikuar dhe bërë efektiv më 18.07.2022 dhe AIP SUP 02/2022 publikuar dhe bërë efektiv më 29.08.2022.

Gjatë periudhës tetor-dhjetor është publikuar AIP AIRAC 06/2022, publikuar më 03.11.2022 dhe bërë efektiv më 01.12.2022 si dhe AIP AIC 01/2022 i publikuar më 29.10.2022.

### 7.9 Raportimi i obligueshëm i ndodhive

Përgjatë vitit 2022, ASHNA ka vazhduar raportimin e ndodhive tek AAC-ja sipas Manualit të brendshëm të Menaxhimit të Sigurisë dhe në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 09/2017. Janë raportuar gjithsej 139 ndodhi në fushëveprimin e shërbimeve të navigacionit ajror. Për të gjitha ato ndodhi për të cilat SHNA-ja ka dyshuar që mund të ndikojnë në siguri, ka kërkuar hetim nga ana e ASHNA-s, ku të gjitha ndodhitë janë trajtuar me seriozitet nga të dyja palët. Shumica e ndodhive janë mbyllur.

# 8. AERODROMET

Sipas Ligjit nr. 03/L-51 për Aviacionin Civil, AAC-ja është përgjegjëse për rregullimin dhe zhvillimin e politikave të aerodromeve dhe ofruesve të shërbimeve në tokë, duke verifikuar zbatimin e standardeve të aplikueshme të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe duke siguruar një ambient të sigurt të aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Varësisht nga natyra e operimeve dhe shkalla e shfrytëzimit, aerodromet civile kategorizohen në aerodrome të certifikuara, aerodrome të aprovuara dhe aerodrome të regjistruara. Në kuadër të AAC-së, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për certifikim, aprovim dhe regjistrim të aerodromeve në dispozicion për shfrytëzim civil në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe fushat ajrore dhe heliportet. Gjithashtu, me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave që rregullojnë qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në Republikën e Kosovës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për vlerësimin e sigurisë së ofruesve të shërbimeve në tokë në aerodromet e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve në tokë për furnizim të aeroplanëve me karburant.

Gjithashtu, për t'u siguruar se aftësimi profesional dhe trajnimi i punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të aerodromit të cilët vetë japin shërbime në tokë, bëhet sipas standardeve dhe kritereve të përcaktuara me legjislacionin përkatës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për certifikim të organizatave të aftësimit profesional në fushën e aerodromeve.Ky proces, ndër të tjera, përfshinë vlerësimin dhe dhënien e rekomandimit për certifikim. Si pjesë e rëndësishme e këti procesi është edhe vlerësimi si dhe aprovimi i instruktorëve për programet përkatëse, bazuar në dispoziatat e legjisilacionit në fuqi.

Me qëllim të mirëmbajtjes së sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Kosovës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për caktimin dhe monitorimin e zonave mbrojtëse të aerodromeve. Ky departament koordinon bashkëpunimin mes operatorëve të aerodromeve, departamentit përgjegjës në ASHNA, subjekteve juridike/personave fizik, të cilët kanë në pronësi apo planifikojnë të ndërtojnë një objekt brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve apo ndonjë objekt të lartë kudo në territorin e Republikës së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse për lëshimin e lejeve të ndërtimit sipas Ligjit për ndërtim. Departamenti i aerodromeve duhet të sigurojë që të gjitha palët e përfshira i respektojnë dispoziatat dhe procedurat e përshkruara në rregulloren mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe rregulloren për shënjimin e pengesave.

Për të verifikuar dhe siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit të aplikueshëm vendor dhe ndërkombëtar, Departamenti i Aerodromeve bën mbikëqyrje të vazhdueshme të sigurisë së aerodromeve, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe organizatave të

aftësimeve profesionale përmes auditimeve, inspektimeve dhe monitorimit të aktiviteteve të tyre.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" fillimisht është certifikuar më 1 dhjetor 2008 nga AAC-ja si aeroport ndërkombëtar në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil, Rregulloren e AAC-së nr. 1/2008 për aerodromet dhe standardet dhe praktikat e rekomanduara të ICAO-s. Në vitin 2011 aeroporti është dhënë në koncesion dhe menaxhimi i tij ka kaluar në duart e operatorit privat, konzorciumit turko–francez "Limak - Aéroports de Lyon" (Limak Kosovo International Airport sh.a.). Më 8 nëntor 2013, bazuar në kërkesat ligjore, me rastin e transferimit të operimeve në terminalin e ri, AAC-ja ka amandamentuar certifikatën e operatorit "Limak Kosovo International Airport" sh.a. (LKIA). Më tej, pas hyrjes në fuqi të Rregullores nr. 17/2017 të AAC-së që përcakton dispozitat dhe procedurat administrative lidhur me aerodromet, që e ka zbatuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 139/2014 me të njëjtin emër, më 8 nëntor 2018, AAC-ja ka certifikuar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe operatorin e aerodromit "Limak Kosovo International Airport" sipas standardeve më të larta të sigurisë së aerodromeve dhe në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian. Përfundimisht, me finalizimin e projektit infrastrukturor të zgjatjes së pistës nga 2.500 në 3.040 metra, së bashku me ngritjen e kategorisë për operim me sistemin preciz të aterrimit, me 21.12.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ka lëshuar certifikatën e operimit për kod referent të aerodromit 4E, bazuar në karakteristikat dhe performancën e aeroplanëve më të mëdhenj që janë planifikuar të operojnë në ANP "Adem Jashari".

Në bazë të Rregullores nr. 4/2011 të AAC-së për qasje në tregun e shërbimeve në tokë, e cila është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 5/2019, më 1 janar 2012 AAC-ja ka lëshuar aprovimin për kompaninë "ExFis" Sh.P.K. si furnizues i shërbimeve në tokë për kategorinë e shërbimeve të furnizimit me derivate dhe vajra, kurse me 1 qershor 2012, është aprovuar operatori LKIA për ofrim të shërbimeve në tokë në disa kategori në ANP "Adem Jashari". Departamenti i aerodromeve, bazuar në legjislacionin pëkatës, në dhjetor të vitit 2018, rrespektivisht në qershor të vitit 2019, ka rekomanduar zgjatjen e aprovimeve për këta dy operatorë. Mbikëqyrja e rregullt e tyre bëhet përmes planit vjetor të mbikëqyrjes së siguriё, përmes auditimeve inspektimeve si dhe trajtimit të ndodhive të ndëlidhura me operimin e tyre.

## 8.1 Mbikëqyrja e vazhdueshme e sigurisë së aerodromeve

Një nga funksionet themelore të Departamentit të Aerodromeve, për garantimin e sigurisë së aerodromeve në Republikën e Kosovës, është zbatimi i sistemit efektiv të mbikëqyrjes. Mbikëqyrja efektive e sigurisë bëhet përmes vlerësimit dhe aprovimit të manualeve, programeve dhe procedurave të ndryshme të operatorit, miratimeve të vlerësimeve të sigurisë, dhe veçanërisht përmes kryerjes së inspektimeve formale (me apo pa njoftim paraprak të operatorit), bazuar në planin vjetor të mbikëqyrjes, apo duke iu përgjigjur situatës që mund të paraqesë nevojën për vigjilencë shtesë në siguri.

Sipas planit të aktiviteteve për monitorimin e rregullt dhe verifikimin e zbatimit të standardeve të aplikueshme për operatorin e ANP "Adem Jashari" dhe ofruesve të shërbimeve në tokë, inspektorët e Departamentit të Aerodromeve gjatë vitit 2022 kanë përmbushur plotësisht planin e mbikëqyrjes së sigurisë për këtë vit, duke realizuar gjashtë (6) inspektime të planifikuara prej të cilëve një (1) tek furnizuesi i aprovuar i aeroplanëve me karburant. Shtatë (7) inspektime "ad-hoc" që nuk janë planifikuar paraprakisht në planin e mbikëqyrjes por janë realizuar si përgjigje ndaj çështjeve të ndryshme sigurie, një (1) auditim i infrastrukturës të organizatës për aftësimin profesional, si dhe dy (2) inspektime tjera, jashtë aeroportit, për të verifikuar zbatimin e kërkesave për shënjim të objekteve të larta në përputhje me dispozitat e Rregullores (AAC) Nr. 09/2018 për zonat mbrojtëse të aerodromit.




Pamje nga inspektimi

## 8.2 Certifikimi i LKIA-së si organizatë për aftësime profesionale në fushën e aerodromeve

Gjatë muajit dhjetor 2021, operatori i ANP "Adem Jashari" - LKIA ka aplikuar për certifikim të organizatës për aftësime profesionale, por poashtu ka parashtruar edhe një kërkesë në AACK për zgjatje të afatit për certifikim, me qenë se Rregullorja (AAC) Nr. 07/2020 për aftësimin profesional për punonjësit të cilët kryejnë detyra që ndikojnë në sigurinë e operimeve në aerodrome dhe certifikimin e organizatave për aftësime profesionale, e publikuar në muajin Janar 2021, ka hyrë në fuqi 6 muaj pas nënshkrimit (Qershor 2022). Arsyeja e kërkesës për zgjatje ishte e bazuar në rrethanat dhe kufizimet e krijuara pas përhapjes së pandemisë COVID-19, të cilat rrethana kanë pasur ndikim

në çështje logjistike të operimeve në LKIA në përgjithësi dhe rrjedhimisht edhe organizimin dhe vonesën e aplikimit për certifikim si organizate trajnuese.

Bazuar në këtë kërkesë dhe duke pasur parasysh se të gjitha programet e trajnimeve të cilat LKIA i ofron për punonjësit e vet janë aprovuar në vazhdimësi nga AAC-ja, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së më 22 dhjetor 2021 ka lëshuar Vendimin për zgjatjen e afatit për certifikim të LKIA-së si organizatë trajnuese deri më 31 mars 2022, sipas Rregullores përkatëse për dispozitat e fleksibilitetit ku lejohen përjashtime për persona juridikë që i nënshtrohen akteve normative të miratuara në rast të rrethanave të paparashikueshme që mund të paraqiten.

Pavarësisht kësaj, departamenti i aerodromeve në AAC ka bërë rishikimin e aplikacionit për certifikimin e LKIA si organizatë trajnuese duke vlerësuar dokumentacionin e ofruar dhe instruktorët, si dhe duke realizuar një auditim të infrastrukturës së LKIA, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së dispozitave të Rregullores Nr. 07/2020 në lidhje me hapësirat e destinuara për ofrim të ligjëratave teorike dhe ushtrimet praktike, pajimet, veglat, dhe mjetet dhe hapësirat tjera të nevojshme për të kryer aftësimin profesional.



Pamje nga klasa e organizatës për aftësime profesionale

Përmes raportit final përmbledhës është rekomanduar certifikimi i organizatës për aftësim profesional për 10 programe për aftësim nga gjithsej 18 sa ka aplikuar LKIA. Me datë 05.07.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së ka lëshuar certifikatën me të cilën LKIA është autorizuar të ofrojë aftësime profesionale në ANP "Adem Jashari" në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr. 07/2020 për 10 programe për aftësim profesional.

Duke ju referuar Vendimit të AAC-së për shtyrjen e vlefshmërisë të të gjitha programeve të aftësimit të LKIA që janë aprovuar më herët nga AACK deri në certifikimin e tyre sipas rregullores 07/2020, apo deri me datë 31 Tetor 2022, me datën 17 tetor 2022 LKIA ka aplikuar për ndryshimin e certifikatës së organizatës për aftësime profesionale , ku si pjesë e aplikacionit janë dorëzuar:

- Doracakët e programeve për aftësime profesionale; dhe
- Dokumentacioni/evidencat për kualifikimet e instruktorëve që janë të përfshirë në këto programe.

Pas vlerësimit të dokumentacionit dhe instruktorëve, është konstatuar se aplikuesi "LKIA" ka përmbushur kushtet ligjore të parapara me rregullore për të ndryshuar certifikatën e organizatës për aftësime profesionale, prandaj me datë 15 dhjetor 2022, AAC ka lëshuar Aneksin II të certifikatës për organizatën për aftësim profesional, duke i shtuar edhe 8 programe të aftësimin profesional në fushën e aerodromeve.

### 8.3 Projekti i LKIA-së për asfaltimin e krahëve të rrugëve për lëvizjen e aeroplanëve në tokë në ANP "Adem Jashari"

Siç kërkohet me Rregulloren nr. 17/2017 për aerodrome dhe në përputhje me materialin udhëzues TP 27 – "Procedurat për ndryshime të aerodromit", në qershor të vitit 2022, operatori LKIA ka dorëzuar kërkesën zyrtare për ndryshimin e propozuar të infrastrukturës në ANP "Adem Jashari". Ky ndryshim vjen si rrjedhojë e zbatimit të projektit për asfaltim të krahëve të rrugëve për lëvizjen e aeroplanëve në tokë në ANP "Adem Jashari. Pas rishikimit dhe analizimit të kërkesës për ndryshim dhe pas konsultimeve të vazhdueshme me operatorin, aplikacioni është aprovuar me 13.07.2022, kurse LKIA ka njoftuar për fillimin e punëve me 18.07.2022, përkatësisht për implementimin e fazës së parë të projektit, sipas aprovimit nga AAC.

Në bashkëpunim me inspektorët e shërbimeve të navigacionit ajror të AAC-së, në vazhdimësi janë bërë rishikimet dhe aprovimet e vlerësimeve të ndryshme të sigurisë për projektin e ndarë në 3 faza. Inspektorët e aerodromeve kanë përcjellë punimet në baza të rregullta, përmes inspektimeve në ANP "Adem Jashari" dhe takimeve të vazhdueshme me operatorin LKIA, kurse me 11.11.2022 është konfirmuar që të gjitha punimet që lidhen me projektin e asfaltimit të krahëve të rrugëve për lëvizjen e aeroplanëve në tokë janë kryer me sukses.



Pamje nga inspektimi i punimeve të projektit për asfaltimin e krahëve të rrugëve për lëvizjen e aeroplanëve në tokë

## 8.4 Zonat mbrojtëse dhe shënjimi i pengesave

Departamenti i aerodromeve ka vazhduar të ushtrojë rolin koordinues për vlerësimin e ndikimit të ndërtimeve të larta në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës. Sipas Ligjit Nr. 03 / L-051 për Aviacionin Civil, Rregullores (AAC) nr. 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe Rregullores (AAC) Nr. 03/2019 për Shënjimin e pengesave, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) është përgjegjës për të siguruar se të gjitha objektet, të palëvizshme apo të lëvizshme, që gjenden brenda një hapësire me rreze prej 15 km prej një aerodromi apo objekte të larta që mund të konsiderohen si pengesa për aeroplanët në fluturim jashtë kësaj hapësire, janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit aeronautik gjithëpërfshirës nga ana e operatorit të ANP "Adem Jashari" (LKIA) dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA). Varësisht nga rezultatet e vlerësimeve, AAC do të konstatoj se a paraqet pengesë një objekt apo jo, dhe mund të kërkoj nga aplikuesi që të zbatoj procedurat për shënjimin (me ngjyrosje dhe/apo ndriçim) e objekteve, me qëllim për të ngritur sigurinë e fluturimeve, duke i bërë pengesat të dallueshme nga zona përreth dhe të dukshme nga të gjitha drejtimet për aeroplanët.

### a) Vlerësimi i ndikimit, të turbinave të erës dhe ndërtimeve të larta, në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës

Duke i koordinuar veprimet nën përgjegjësinë e saj, AAC duhet të sigurohet se ndërtimi, instalimi dhe operimi i turbinave të erës nuk do të ndikojë në sigurinë e

operimeve të aeroportit dhe në trajektoret e fluturimeve të aeroplanëve në Republikën e Kosovës.

Në korrik të vitit 2022 është pranuar një kërkese nga operatori "SOWI Novobërdë L.L.C" për vlerësim aeronautik të projektit të parkut energjetik me mullinjtë e erës që parashihet të ndërtohet në Jasenovik, Komuna e Artanës. Bëhet fjalë për të njëjtin projekt që është pranuar dhe trajtuar me herët nga AAC, të cilin e ka dorëzuar operatori "StubllaEnergy SH.P.K" gjatë vitit 2021 ku është kërkuar vlerësimi aeronautik të një shtylle të lartë me pajisje meteorologjike për matje të erës, por këtë herë kërkesa për vlerësim është plotësuar me të dhënat për pozicionet/koordinatat e parapara për vendosjen e mullinjve te erës.

Brenda kompetencave të veta, bazuar në Rregulloren 09/2018 për zonat mbrojtëse të aeroportit dhe procedurave të brendshme, AAC ka kërkuar nga operatori i ANP "Adem Jashari" dhe ASHNA të bëjnë vlerësimet aeronautike sipas përgjegjësive të tyre.

Në bazë të vlerësimeve të pranuara nga LKIA dhe ASHNA brenda fushëveprimeve të tyre, LKIA ka konstatuar se vendosja e shtyllës dhe ndërtimi i parkut energjetik në lokacionin e propozuar nuk do të paraqesë pengesë për operimet në ANP "Adem Jashari", kurse ASHNA, fillimisht me 21.07.2022, ka konstatuar se vendosja e shtyllës në lokacionin e caktuar paraqet pengesë për trajektoret e fluturimit dhe mandej me 08.08.2022 ka ripërsëritur se edhe i tërë projekti do të paraqet pengës nëse ndërtohet në atë lokacion. AAC e ka njoftuar operatorin "SOWI Novobërdë L.L.C" për rezultatet e vlerësimeve.



Pamje nga ferma e turbinave të erës në Selac

## 8.5 Shënjimi i linjave transmetuese

Për të bërë verifikimin e implementimit të Rregullores 03/2019 për Shënjimin e pengesave, sipas planit te veprimit për vitin 2022, është vazhduar përcjellja e zbatimit të planit të kompanisë KOSTT për shënjim vizual të linjave 400/220/100 kV të cilat gjenden në kryqëzim të autostradës "Ibrahim Rugova", në aksin rrugor (R7) Arllat – Prizren, dhe autostradës "Arbër Xhaferi" në aksin rrugor (R6) Prishtinë – Hani Elezit.

Shënjimi i largpërçuesve të kompanisë KOSTT përfshinë:

1. Vendosjen e sferave në kabllo,
2. Vendosjen e dritave sinjalizuese në shtylla, dhe
3. Ngjyrosjen e shtyllave (kuq dhe bardh).

Përgjatë vitit 2022 inspektorët eaerodromeve, kanë realizuar tri inspektime në terren, në Autostradën "Ibrahim Rugova" - aksi rrugor (R7) Arllat – Prizren, dhe në autostradën "Arbër Xhaferi" - aksi rrugor (R6) Prishtinë – Hani Elezit, për të verifikuar implementimin e projektit "Shënjimi i pengesave" për shtyllat e linjave transmetuese të KOSTT-it në pikat ku kalojnë sipër autostradës. Inspektimet ishin vazhdimësi e procesit të verifikimit të implementimit të punimeve lidhur me këtë projekt të planifikuar për vitin 2021/2022 e që do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2023.

Pas analizimit të raporteve të pranuara dhe verifikimit në terren, inspektorët e aerodromeve kanë konstatuar se implementimi i projektit për shënjimin e pengesave për pozicionet e realizuara deri me tani është kryer sipas kërkesave të Rregullores (AAC) Nr. 03/2019. Mirëpo, në nëntor 2022, AAC ka kërkuar nga KOSTT të jetë e informuar, lidhur me planin e veprimit për shënjimin e të gjitha linjave të mbetura në këto akse rrugore si dhe në të gjitha lokacionet tjera në territorin e Republikës së Kosovës, në përputhje me kërkesat e rregullores (AAC) 03/2019 për Shënjimin e Pengesave. Në përgjigjen e pranuar nga KOSTT është potencuar se në planin e ardhshëm 5 vjeçar është paraparë buxheti për vazhdimin e këtij projekti, ku në varësi të aprovimit nga ZRRE do të planifikohet vazhdimi i këtij projekti duke i caktuar prioritetet në bashkëpunim me AAC.

## 8.6 Shënjimi i tymtarit në fabrikën e çimentos në Han të Elezit

Në anën tjetër, si vazhdimësi e kërkesës së pranuar gjatë vitit 2021 nga përfaqësuesi i fabrikës së çimentos "Titan Sharrcem" në Han të Elezit lidhur me sqarimet e standardeve që aplikohen për shënjimin e objekteve të larta në territorin e Republikës së Kosovës, veçanërisht oxhaqeve dhe planit zbatues për shënjimin e oxhakut të fabrikës, inspektorët e AAC-së kanë monitoruar implementimin e projektit dhe verifikuar në terren përputhshmërinë me standardet përkatëse.

Pas korrespodencës së vazhdueshme me zyrtarët përgjegjës të fabrikës, me ç 'rast janë dhënë sqarimet dhe interpretimet e nevojshme të standardeve, si dhe pas inspektimeve të shumta në terren, me datë 11.08.2022 inspektorët e AAC-së kanë realizuar një

inspektim përfundimtar ku kanë konstatuar se implementimi i projektit të shënjimit (ngjyrosjes dhe ndriçimit) të oxhakut të fabrikës "Titan Sharrcem" në Han të Elezit është realizuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (AAC) Nr. 03/2019 për Shënjimin e Pengesave.

## 8.7 Ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të ANP "Adem Jashari"

Në kuadër të përgjegjësive për rregullimin e zonave mbrojtëse të aerodromeve, inspektorët e aerodromeve kanë vazhduar me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullores mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe Rregullores për shënjimin e pengesave, brënda zonave mbrojtëse të ANP'Adem Jashari".

Më datën 22.08.2022, AAC ka pranuar nga operatori LKIA vlerësimin e aplikacionit për projektin në Sllatinë të madhe, Komuna Fushë Kosovë, që ka të bëjë me vendosjen e paneleve solare mbi objektin ekzistues. AAC ka vlerësuar dhe rishikuar në hollësi dokumentacionin e pranuar nga LKIA në lidhje me pengesat e mundshme që projekti mund të shkaktojë në sigurinë e operimeve dhe në bazë të dokumentacionit dhe vlerësimeve të pranuara nga LKIA dhe ASHNA, brenda fushëveprimit të tyre, që panelet solare në lokacionin e propozuar nuk paraqesin pengesë për sigurinë e operimeve, AAC ka lëshuar pëlqimin për këtë projekt, me kusht që të zbatohen rekomandimet e LKIA-së.

Më datën 14.11.2022, AAC ka pranuar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" LKIA vlerësimin e aplikacionit për projektin e ndërtimit të një objekti në hapësirat e parkingut të ANP-së "Adem Jashari". Në bazë të dokumentacionit të pranuar, vlerësimeve nga LKIA dhe ASHNA, në përputhje me dispozitat e Rregullores (AAC) Nr. 09/2018 për zonat mbrojtëse të aerodromit, AAC ka vlerësuar se objekti i planifikuar të ndërtohet në hapësirat e parkingut të ANP "Adem Jashari" nuk paraqet pengesë për sigurinë e operimeve, me kusht që plotësohen të gjitha kërkesat e paraqitura në vlerësimin e LKIA-së.

## 8.8 Mirëmbajtja e hapësirave në rrethinën e ANP "Adem Jashari"

Në fillim të muajit mars departamenti i aerodromeve ka organizuar një takim shumë të rëndësishëm lidhur me mundësinë e gjetjes se një zgjidhje për pastrimin kanaleve te drenazhit jashtë rrethojës së ANP "Adem Jashari", për pjesët që shtrihen ne Komunën e Lipjanit dhe në Komunën e Fushë Kosovës. Në këtë takim ishin të pranishëm zyrtarët përgjegjës të LKIA në ANP "Adem Jashari" dhe ata të komunës së Lipjanit dhe F. Kosovës.

Lidhur me këtë çështje, LKIA ka bërë kërkesë me shkrim për intervenim të menjëhershëm të pastrimit të kanaleve të drenazhës jashtë rrethojës së ANP "Adem Jashari" që gjenden brenda territorit te Komunës se Lipjanit dhe ka kërkuar pastrimin e rregullt të kanaleve që shtrihen brenda Komunës së Lipjanit dhe Komunës së Fushë Kosovës. Kërkesa e LKIA-së është përcjellë nga AAC tek përfaqësuesit e komunave, ku përfaqësuesi nga Komuna e Lipjanit ka deklaruar se do të tentojnë te marrin veprime te

menjëhershme për pastrimin e kanaleve për pjesën që shtrihet në territorin e tyre. Gjithashtu, përfaqësuesit e dy Komunave u zotuan se kjo çështje do të trajtohet me seriozitet dhe se do të planifikojnë të bëhet një zgjidhje e përhershme afatgjate për fazat e mëtutjeshme.

# 9. RREGULLIMI EKONOMIK I AVIACIONIT

Në bazë të nenit 15, pika e) e LAC-it, AAC-ja është përgjegjëse për rregullimin e ekonomisë së aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Rregullimi ekonomik i këtyre operatorëve nënkupton masat që merr një rregullator i aviacionit për t'u siguruar se tarifat të cilat i vendos aeroporti dhe ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror për kompanitë ajrore janë të vendosura në mënyrë të arsyeshme, transparente dhe jodiskriminuese. Për më tepër, rregullatori siguron që këto tarifa janë vendosur vetëm pasi që ofruesit dhe shfrytëzuesit e shërbimeve janë konsultuar mes veti duke i ofruar njëri-tjetrit të dhëna në mënyrë transparente. AAC-ja i rregullon dhe i miraton vetëm tarifat aeronautike të cilat kanë lidhje me shërbimet që aeroporti dhe ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror i ofrojnë ekskluzivisht, pa pasur kurrfarë konkurrence, siç janë tarifa e shërbimit të udhëtarëve, tarifa e aterrimit apo ajo terminale e navigacionit. Poashtu, rregullatori mbikëqyr nëse qëndrueshmëria financiare e operatorëve është në nivel të duhur që të mos e dëmtojë sigurinë e operimeve. Këto përgjegjësi ushtrohen nga zyrtarët përgjegjës për rregullim ekonomik të aviacionit brenda Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik në AAC.

## 9.1 Aprovimi i tarifave aeroportuale

Deri më tani, AAC-ja ka nxjerrë tre rregulloret e mëposhtme implementuese për të përcaktuar nivelin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve të aeroportit:

- Rregulloren nr. 3/2008 për tarifën e shërbimit të udhëtarëve që udhëtojnë me fluturime komerciale nga Kosova, të datës 26 dhjetor 2008. Kjo rregullore është shfuqizuar me rregulloren në vijim;
- Rregulloren nr. 1/2011 mbi Tarifat e Aeroportit, të datës 18 janar 2011. Kjo rregullore është shfuqizuar me rregulloren në vijim; dhe
- Rregulloren nr. 3/2015 mbi Tarifat e Aeroportit, të datës 08 qershor 2015, e cila ka hyrë në fuqi më 23 qershor 2015 dhe është ende në fuqi.

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së ka kërkuar disa sqarime lidhur me implementimin e Rregullores nr. 3/2015 mbi Tarifat e Aeroportit nga Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik i AAC-së, dhe gjatë korrespondencave është kuptuar se AAC-ja asnjëherë nuk i ka aprovuar tarifat e aeroportit dhe se ato janë të njëjta që nga periudha para themelimit të AAC-së si institucion i Republikës së Kosovës. Pra, përkundër ekzistimit të kërkesave rregullative, AAC-ja asnjëherë nuk ka bërë aprovimin e tarifave ekzistuese dhe asnjëherë nuk ka bërë rishikimin e nivelit të tarifave.

Me qëllim të sqarimit të situatës nga aspekti juridik dhe procedural, Autoritet i Aviacionit Civil i ka bërë kërkesë Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) më 17.08.2022 për një auditim të jashtëzakonshëm lidhur me implementimin e Rregullores nr.

03/2015 për Tarifat e Aeroportit. Gjatë vitit 2022, AAC-ja nuk ka marrë përgjigje nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Niveli i lartë i tarifave të aplikuara nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" (LKIA) është raportuar të jetë ndër më të lartët në rajon dhe shumë kompani ajrore kanë shprehur shqetësimin se këto tarifa po ndikojnë negativisht në planet e tyre për ta rritur numrin e fluturimeve në këtë aeroport.

AAC-ja do të angahohet për sqarimin e situatës lidhur me përgjegjësitë për përcaktimin e tarifave aeroportuale dhe nëse vërtetohet se kjo kërkohet, do të fillojë procesin e përcaktimit të tarifave gjatë vitit 2023.

## 9.2 Mbikëqyrja e vazhdueshme ekonomike e aeroportit

Analiza e pasqyrave të audituara financiare të operatorit të ANP "Adem Jashari" për gjendjen financiare në fund të vitit 2021, për dallim nga viti pandemik 2020, ka vërtetuar që LKIA sh.a. ka kaluar një vit të mirë financiar për shkak të rritjes së trafikut ajror. Gjatë vitit 2021, kompania ka zvogëluar shtrirjen financiare nga borxhi dhe ka rritur nivelin e të ardhurave në raport me mundësinë e pagesës së interesit. Kompania ka rritur margjinën e operimit nga -30.3 në 11.2 që do të thotë se kompania është duke performuar mirë financiarisht. Gjithashtu, margjina e profitit është rritur nga -41.11% në 5.81%, që do të thotë se kompania e ka rritur fitimin në krahasim me vitin paraprak. Raporti i mbikëqyrjes ekonomike për vitin 2021 ka konkluduar rikuperimin e gjendjes financiare pas humbjeve për shkak të pandemisë dhe se qëndrueshmëria financiare e operatorit të aeroportit LKIA, si element shumë i rëndësishëm për mirëmbajtjen e standardave të sigurisë, është evidente.

Përndryshe, ANP "Adem Jashari" është ndër aeroportet e vetme që në fund të vitit 2021 ka arritur ta rikuperojë 92% të trafikut të vitit 2019, përderisa aeroportet në rajon ia kanë dalë ta rikuperojnë vetëm rreth 50% të trafikut të vitit 2019. Ky trend pozitiv ka vazhduar edhe në vitin 2022 meqë trafiku ajror ka pasur rritje signifikante prej 37% në krahasim me vitin 2021.

Në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve, në muajin mars është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të LKIA-së për operimet në ANP. Polica për përgjegjësi në aviacion mbulon periudhën 4 prill 2022 - 3 prill 2023 dhe ka mbulesë prej 100,000,000 EUR për cilindo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet.

## 9.3 Miratimi i Programit Nxitës 2020-2022 të LKIA-së për kompanitë ajrore

Më 1 shkurt 2022, AAC-ja ka pranuar kërkesën e ndryshuar dhe të plotësuar të LKIA-së për marrjen e aprovimit për Programin Nxitës 2022-2024 së bashku me dokumentacionin përkatës që kërkohet në Rregulloren e AAC-së nr. 3/2015 mbi tarifat e aeroportit duke përfshirë edhe dëshminë për konsultimin me kompanitë ajrore. Më 10 mars 2022, Drejtori i Përgjithshëm, pas Rekomandimit nga Departamenti BNRREA,

përmes Vendimit 03/ZDP/VE/2022 ka aprovuar Programin Nxitës të ANP "Adem Jashari" për periudhën 27 mars 2022 - 30 mars 2024. Produktet që përmban ky program nxitës e që janë subjekt i aprovimit të AAC-së janë: Nxitja për stacionimin e aeroplanëve dhe nxitja për zhvillimin e destinacioneve të largëta. Kompanitë që plotësojnë kriteret për të përfituar nxitjen për stacionimin e aeroplanëve do të lirohen 100% nga tarifa e parkimit të aeroplanëve ndërsa sa i përket produktit për zhvillimin e destinacioneve të largëta, kompanitë ajrore që operojnë një destinacion të largët përfitojnë 100% lirim nga tarifa e aterrimit, mbështetje për marketing në vlerë prej 50,000 EUR dhe 20% zbritje në pakon e shërbimeve në tokë.

## 9.4 Përmbledhja e realizimit të Programit Nxitës 2021-2022 të LKIA-së

Analiza e rezultateve të Programit Nxitës të miratuar nga AAC-ja, i cili i është ofruar kompanive ajrore në ANP "Adem Jashari" në periudhën kohore 1 qershor 2021 - 26 mars 2022, në bazë të raportit që ka dorëzuar LKIA në qershor 2022, ka treguar që programi ka pasur ndikim në shtimin e frekuencave (4 sosh), në shtimin e destinacioneve të reja (1 destinacion) dhe në rritjen e trafikut në përgjithësi, me përfitime për vendin.

Vlera e përfituar nga LKIA si rrjedhojë e programit nxitës është 796,913 EUR, ndërsa vlera e përfitimit nga kompanitë ajrore për të njëjtën periudhë është 179,777 EUR, që tregon se operatori LKIA dhe kompanitë ajrore kanë përfituar nga ky program nxitës. Gjithashtu në këtë raport janë kalkuluar edhe të hyrat e ASHNA-s dhe AAC-së si rezultat i këtij programi.

## 9.5 Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s

Në bazë të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, ASHNA çdo vit i propozon AAC-së për miratim një vlerë të tarifës terminale, njësi e cila do të jetë e aplikueshme në vitin pasues ndaj të gjitha kompanive ajrore që marrin shërbimin terminal të navigacionit nga ASHNA gjatë uljes apo ngritjes nga ANP "Adem Jashari". Me qëllim të vlerësimit të propozimit të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2023, AAC-ja ka pranuar dhe shqyrtuar dokumente nga 3 propozimet e ASHNA-s gjatë vitit 2022. Pasi që në Departamentin BNRREA është përfunduar shqyrtimi rregullator i propozimit të ASHNA-s për koston e ofrimit të shërbimit gjatë vitit 2023, duke marrë parasysh edhe dëshmitë për konsultime me kompanitë ajrore si dhe parashikimin e trafikut për vitin 2023, Departamenti ka lëshuar një rekomandim me datën 5 dhjetor 2022 për Drejtorin e Përgjithshëm përmes të cilit kanë bërë përcaktimin e secilës prej kostove të pranueshme, siç janë përcaktuar në Rregulloren e AAC-së nr. 3/2016. Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së më 16 dhjetor 2022 ka nënshkruar Vendimin Ekzekutiv nr. 11/ZDP/VE/2022, përmes të cilit përcaktohet tarifa njësi terminale në Republikën e Kosovës në vlerë prej 380 EUR, duke filluar nga 1 janari 2023, e vlefshme për një vit. Kjo vlerë e përcaktuar nga AAC-ja është më e vogël se ajo e propozuar nga ASHNA (508 EUR) dhe më e vogël se tarifa njësi terminale e vitit 2022 (418 EUR). Nën supozimin se rritja e numrit të njësive terminale të shërbyera gjatë vitit 2023 do të jetë

7% në krahasim me vitin 2022, kjo tarifë pritet të sjellë të hyra afro 5.6 milionë EUR për ASHNA-n.

Tarifa terminale e navigacionit u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që kjo i ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Shërbimet për aeroplanët që mbikalojnë Kosovën do të vazhdojë t'i ofrojë HungaroControl, prandaj edhe të hyrat për këtë shërbim i shkojnë ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë. Gjatë përcaktimit të tarifave aeronautike, AAC-ja kujdeset që të miratojë vetëm kostot e pranueshme dhe të nevojshme për ofrimin e shërbimit në përputhje me rregulloren në fuqi në mënyrë që të ruhet edhe interesi i udhëtarëve dhe konkurrueshmëria e aeroportit.

Në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve, më 9 shkurt 2022 është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të ASHNA-s e datës 20 dhjetor 2021. Polica për përgjegjësi në aviacion mbulon periudhën 1 janar 2022 - 31 dhjetor 2022 dhe ka mbulesë prej 200,000,000 EUR për cilindo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet ndërsa 20,000,000 EUR për lëndim personal.

Në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike, AAC-ja ka gjetur se pjesët rezervë për sistemet radarike nuk kanë ardhur për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të ASHNA-s dhe problemeve që operatori ekonomik Leonardo kishte pasur me dokumentet e transportit. Sidoqoftë, pjesët rezervë pritej të arrinin në ASHNA në fillim të vitit 2023.

AAC-ja ka informuar ASHNA-n se në rast të mosrealizimit të projekteve, kjo ka impakt në tarifën terminale të vitit n+2 dhe mjetet e projekteve që nuk janë realizuar duhet t'u kthehen kompanive ajrore.

### 9.6 Mbikëqyrja e vazhdueshme ekonomike e shërbyesve në tokë

Në ANP operojnë dy ofrues të shërbimeve në tokë, të cilët janë aprovuar nga AAC-ja për këtë qëllim: operatori i ANP "Adem Jashari", LKIA, si ofrues i një game të gjerë shërbimesh (shërbimet e udhëtarëve, të përpunimit të bagazhit dhe aeroplanëve në tokë, etj.), si dhe kompania "Ex Fis" sh.p.k., e cila bën furnizimin e aeroplanëve me derivate. Gjatë vitit 2022, organit menaxhues të ANP "Adem Jashari" LKIA i është vazhduar Aprovimi prej 30 mars 2022 deri më 31 mars 2023 dhe kompanisë "Ex Fis" i është vazhduar Aprovimi prej 1 shkurt 2022 deri më 31 janar 2023. Të dy operatorët janë në mbikëqyrje të vazhdueshme nga AAC-ja për mirëmbajtjen e kritereve të sigurisë dhe atyre ekonomike.

Analiza e pasqyrave të audituara financiare 2021 e LKIA-s, sa i përket segmentit të shërbimeve në tokë, ka treguar se me përmirësimin e trafikut në vitin 2021 është përmirësuar edhe shëndeti financiar i operatorit i cili ishte ndikuar negativisht gjatë vitit 2020. Si pasojë e pandemisë dhe uljes drastike të trafikut edhe të ardhurat totale nga shërbimet në tokë ishin ulur për 48% gjatë vitit 2020. Ndërsa gjatë vitit 2021, trafiku është përmirësuar dukshëm si dhe të hyrat nga shërbimet në tokë. Margjina e

operimit është rritur nga -12.2% në 39.6% që do të thotë se kompania është duke performuar mirë financiarisht. Margjina e profitit është përmirësuar nga -59% në -3.5%.

Përmes raporteve financiare të audituara të vitit 2021 për tarifat e rregulluara nga AAC-ja dhe për tarifat e shërbimeve në tokë, AAC-ja ka vërtetuar përmes deklaratës së auditorit që llogaritë financiare të LKIA-s sa i përket shërbimeve në tokë janë të ndara nga llogaritë e tjera të biznesit ashtu siç kërkohet me Nenin 4 të Rregullores nr. 4/2011 të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren e AAC-së nr. 5/2019 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

Organi menaxhues i aeroportit si ofrues i disa shërbimeve në tokë në ANP "Adem Jashari" gjatë vitit 2022 ka mirëmbajtur kushtet ekonomike në bazë të të cilave është aprovuar, në pajtim me Nenin 11.4 të Rregullores nr. 4/2011 për shërbimet në tokë të ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019.

Analiza e pasqyrave financiare të audituara të operatorit "Ex Fis" sh.p.k. për gjendjen financiare në fund të vitit 2021 ka vërtetuar se kompania e aprovuar nga AAC-ja për furnizim me karburant të mjeteve ajrore në ANP "Adem Jashari" vazhdon të ketë shëndet të mirë financiar dhe të jetë biznes rentabil. Përmes Deklaratës së auditorit, është vërtetuar që është përmbushur kërkesa nga Rregullorja nr. 4/2011 e AAC-së të ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 për ndarje të llogarive të biznesit që zhvillohet në aeroport nga aktivitetet tjera biznesore që zhvillon kjo kompani.

Gjithashtu, është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të "Ex fis" sh.p.k., e cila ka mbulim prej 500,000,000 USD për cilindo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet dhe mbulon periudhën 26 maj 2022 - 25 maj 2023. Ky është një element tjetër i rëndësishëm i mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve në fushën e aviacionit civil.

## 9.7 Kërkesat drejtuar Komitetit të PPP-së

AAC-ja i ka drejtuar disa shkresa Komitetit të PPP-së dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të adresimit të çështjeve të aviacionit civil që janë në kuadër të fushëveprimit të AAC-së dhe përgjegjësive të qeverisë sipas kontratës së PPP-së.

Deri më tani, AAC-ja nuk kam marrë përgjigje përkundër kërkesës së vazhdueshme adresuar Komitetit të PPP-së.

Çështjet e adresuara te Komiteti i PPP-së janë:

- **Qasja në tregun e shërbimeve në tokë në aeroport:**

  Bazuar në Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), përkatësisht nenin 14.2, nenin 15.1 pikat (e) dhe (f) dhe nenin 69, Autoriteti i Aviacionit Civil është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve

dhe shërbimeve të navigimit ajror në Republikën e Kosovës. Neni 69 i Ligjit përcakton që Trajtimi në tokë në aeroporte rregullohet sipas Direktivës së Këshillit të Evropës 96/67/EC të datës 15 tetor 1996 për qasjen në tregun e trajtimit në tokë në aeroportet e Bashkimit Evropian dhe të gjitha ndryshimeve dhe plotësimeve të kësaj Direktive. AAC-ja ka traspozuar në rendin e brendshëm juridik Direktivën 96/67/EC përmes Rregullores (AAC) nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019.

LKIA deri më tani ka refuzuar që të zbatojë Rregulloren nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë si dhe vendimin 01/ZDP/VE/2021 të AAC-së të datës 19 janar 2021, lidhur me lejimin e qasjes në treg të ofrueseve të tjerë të shërbimeve në tokë.

- **Aplikimi i tarifave në kundërshtim me Rregulloren nr. 04/2011**

  Vendimi i AAC-së 01/ZDP/VE/2021 dhe shkresat e dërguara nga AAC-ja tek Komiteti i PPP-së, ndër tjerash, evidentojnë faktin që për një periudhë gati 10 vjeçare aeroporti ka aplikuar tarifa që janë në kundërshtim me Rregulloren nr. 04/2011, për implememtimin e së cilës është përgjegjëse AAC-ja, si dhe në kundërshtim me Marrëveshjen për PPP-në, përkatësisht me Pjesën B të Aneksi 11 të kësaj Marrëveshjeje, e cila përcakton tarifën fikse prej 2 EUR cent (0.02 EUR) për çdo litër të shitur të derivateve në aeroport, dhe e cila sipas Marrëveshjes nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e dhënësit (Komitetit të PPP-së).

  Ndërsa sipas evidencave që posedon AAC-ja (Kontratës ndërmjet LIMAK-ut dhe Ex Fis-it, si dhe Raporteve të Auditit të Pavarur), tarifa e aplikuar nga LIMAK-u është 0,12 EUR, pra është 500% më e lartë se ajo e paraparë në Marrëveshjen e PPP-së. Duke iu referuar raportit të auditit të "Ex Fis" të publikuar në internet, tarifa ose komisioni siç i referohet raporti, që operatori "Ex Fis" i ka paguar organit menaxhues LIMAK për vitin 2018 ka qenë 2,355,000 EUR, dhe për vitin 2017 ka qenë 2,002,000 EUR. Nëse tarifa e aplikuar ka qenë 500% më e lartë se tarifa sipas Marrëveshjes, mund të llogaritet se vetëm për vitin 2018 dhe 2017, organi menaxhues i aeroportit LIMAK ka përfituar potencialisht 3,6 milionë EUR më shumë se sa që i lejohet sipas Marrëveshjes së PPP-së ose sipas Rregullores së AAC-së nr. 04/2011.

Çështjet e mësipërme i janë adresuar Komitetit për Partneritet Publiko Privat nga AAC-ja përmes shkresave të shumta. AAC-ja, përmes vendimin 01/ZDP/VE/2021, ka evidentuar edhe veprime të mundshme të keqpërdorimit, dhe rasti është raportuar edhe në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Por pavarësisht të gjitha këtyre veprimeve të AAC-së, LKIA sh.a. vazhdon të mos zbatojë detyrimet ligjore dhe rregullatore në lidhje me rregulloren për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë të palëve të treta.

# 10. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

AAC-ja ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse për aviacionin civil në Republikën e Kosovës në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Poashtu, sipas nevojës, është ofruar përkrahje profesionale në fushën e aviacionit civil për institucionet tjera të shtetit.

## 10.1 Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet AAC-së dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Gjatë muajit dhjetor të vitit 2021, është realizuar një takim ndërmjet AAC-së dhe Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit te Kosovës (AMMK) ku janë diskutuar mënyrat e arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet dy palëve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe impaktit që mjedisi mund të ketë në sigurinë e aviacionit civil, me theks të veçantë në fushën e menaxhimit të botës shtazore në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe në rrethinën tij. Ky bashkëpunim do të shtrihej kryesisht në dy fusha, në atë të monitorimit dhe studimit të habitatit dhe gjendjes në aeroport dhe në rrethinën e tij (Ligatina e Hencit, kodra e Goleshit etj.) si dhe monitorimi i aktiviteteve të ndërtimit, që mund të jenë atraktive për shpezët, (p.sh ndërtimi i deponive të mbeturinave, basenet për kultivimin e peshqve etj.) në një perimetër prej 13 km nga aeroporti.

Gjatë vitit 2022, AAC ka vazhduar të komunikoj me përfaqësues së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me ç' rast janë mbajtur disa takime ndërmjet përfaqësuesve të AAC-së, Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI, inspektorëve të mbrojtjes së natyrës në kuadër të MMPHI dhe përfaqësueseve të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (ANMK), ku është diskutuar për menaxhimin e rrezikut nga bota shtazore në ANP "Adem Jashari".

Në këto takime është konkluduar se është e domosdoshme që të bëhet një studim i habitatit në Ligatinën e Hencit dhe rrethinë, në mënyrë që të kuptohet saktësisht se çfarë lloj i botës shtazore jeton në ato zona dhe cilat janë lëvizjet e tyre gjatë vitit. Ky studim është i domosdoshëm si për mbrojtjen e ligatinës si zonë e mbrojtur ashtu edhe për menaxhimin e rrezikut nga bota shtazore në ANP "Adem Jashari" dhe rrethinën e tij. Për kryerjen e këtij studimi, përfaqësuesit e AMMK-së dhe MMPHI-së u deklaruan që nuk kanë kapacitete të brendshme, pasi kërkohen ornitologë (ekspertë për shpezë) dhe puna disa vjeçare në terren për të realizuar studimin siç duhet. Gjithashtu, do të shikohen edhe mundësitë tjera, alternative, në institucione tjera të vendit dhe jashtë vendit.

Në anën tjetër, është ngritur shqetësimi që Ligatina e Hencit, që përmes Vendimit të Qeverisë nr. 08/178 të dt. 18.03.2014 është shpallur zonë e mbrojtur e zogjve, vazhdon të jetë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore dhe menaxhohet nga AKP. Përfaqësuesi i AMMK konfirmoj që rekomandimi për të kërkuar menaxhimin e kësaj zone nga

Ministria është bërë paraprakisht, por ende nuk ka ndodhur. Mbetet interes i përgjithshëm që kjo zonë të mos të lejohet të privatizohet.

AAC është shprehur se përmes një memorandumi të bashkëpunimit do të kërkojë mbështetje nga MMPHI në fushën e menaxhimit të botës shtazore në ANP dhe në rrethinën tij.

Si përfundim, për të parë mundësitë e mëtutjeshme për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e menaxhimit të botës shtazore në ANP "Adem Jashari" dhe në rrethinën tij (Ligatina e Hencit, kodra e Goleshit etj.), është rekomanduar që të mbahet një takim i nivelit më të lartë (sekretarë i përgjithshëm, kryeshef ekzekutiv), ku do të përcaktohej një agjendë dhe veprimet e mëtutjeshme lidhur me këtë proces.

## 10.2 Mbështetja e MPB-së në hartimin e strategjisë kombëtare për menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë

AAC-ja, përmes Drejtorit për Siguri dhe Cilësi, ka mbështetur grupin formal, i cili merret me rishikimin e dokumentacionit në fuqi për rrezikshmërinë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në nivel vendi. Grupi punues është emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME). Gjatë vitit 2022, grupi punues ka mbajtur disa takime dhe ka hartuar draft strategjinë për ulje të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera së bashku me planin e veprimit për zbatim të kësaj strategjie. Puna e grupit punues synon ofrimin e ekspertizës dhe mbështetjes nga të gjitha fushat e mbuluara në këtë grup, në zbatimin e Rregullores (QRK) nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.

## 10.3 Mbështetja e MPB-së në zbatimin e Rregullores për kërkim dhe shpëtim në aviacionin civil

Gjatë vitit 2022, Departamenti për Siguri dhe Cilësi në AAC ka qenë në komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) në mbështetje të kësaj ministrie për t'u dakorduar e koordinuar për veprimet në kuadër të zbatimit nga MPB-ja të Rregullores (MPB) nr. 01/2018 që transpozon Aneksin 12 të ICAO-s për kërkim dhe shpëtim në aviacionin civil.

Është planifikuar dhe realizuar një vizitë e ekspertit ndërkombëtar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kroacisë, z. Mato Šimičić, për të mbështetur Kosovën në hartimin e Planit për kërkim-shpëtim në territorin jashtë rrezes prej 8 km nga aeroporti si dhe për mënyrat e zbatimit të këtij plani. Gjatë fazës planifikuese janë mbajtur takimet me 16 institucione relevante për reagim në kërkim-shpëtim në rast të një aksidenti ajror, ndërsa gjatë vizitës së ekspertit është mbajtur një punëtori për kërkim-shpëtim me të gjitha palët e përfshira në këtë proces, si dhe janë mbajtur takime me secilën palë veç e veç për t'i ritheksuar rolet e secilit institucion në reagimin në rast të një aksidenti ajror në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit janë mbajtur edhe shumë takime me përfaqësues të zyrës së NATO-s në Kosovë, me pjesëtarët e Kërkim Shpëtimit të Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në bazën në Pomozotin, me shërbimin e zjarrfikjes të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", etj.

Përveç vizitës së ekspertit kroat dhe takimeve të shumta, është përcjellur dhe është përditësuar edhe Plani i veprimit, i hartuar për zbatimin e Rregullores për kërkim dhe shpëtim. Bartëse e procesit të zbatimit të Kërkim Shpëtimit në Republikën e Kosovës është AME në kuadër të MPB-së.

## 10.4 Bashkëpunimi me Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), në Zyrën e Kryeministrit, është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L- 051 për Aviacionin Civil. KHAIA është përgjegjëse për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacion brenda Kosovës ose ku përfshihen avionët e regjistruar në Kosovë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës kudo qofshin ata.

KHAIA është e autorizuar që të kërkojë nga cilido autoritet publik i Kosovës dhe/ose person privat ose organizatë në Kosovë që t'i japë asaj përkrahjen e nevojshme për kryerjen e një hetimi të përcaktuar me ligjin për aviacionin civi dhe hekurudhave, ose një hetimi i cili kërkohet sipas një marrëveshje ndërkombëtare ose organizate ndërkombëtare të aviacionit ose hekurudhave.

AAC dhe KHAIA kanë marrëveshje sipas të cilës dy institucionet ndajnë informacione mbi ndodhitë dhe japin përkrahje të ndërsjellët profesionale sipas nevojës së dy institucioneve

Në përputhje me Rregulloren nr. 09/2017 për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil, cdo person, gjatë ushtrimit të detyrave të tij/saj i raporton Autoritetit të Aviacioni Civil të Republikës së Kosovës për të gjitha ndodhitë të cilat e rrezokojnë ose të cilat mund të rrezikojnë avionin, udhëtarët ose ndonjë person tjetër.

Gjate vitit 2022 AAC ka raportuar në KHAIA lidhur me një ndodhi që është klasifikuar si incident serioz që sipas procedurave standarde kërkon nisjen e hetimeve sipas përgjegjësive ligjore të KHAIA.

Poashtu, gjatë vitit 2022, Drejtori i Pergjithsehm i AAC ka dërguar kërkesën për nisje të hetimit edhe për dy raste tjera që ndërlidhen me ndodhi të përsëritura.

## 10.5 Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës

Qëllimi i këtij Memorandumi bashkëpunimi është përkrahja administrative dhe profesionale ndërmjet të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) në fushën e rregullave financiare në shpenzimin e parasë publike, përkatësishtë në fushat në të cilat Zyrtarët Kryesorë Administrativë të këtyre dy institucioneve kanë të drejtë të lidhin marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të zyrtarëve sipas dispozitave të LMFPP-së dhe marrëveshjes për shërbime të dyanshme ndërmjet institucioneve, sipas Nenit 37 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Zyrtarët, shërbimet e të cilëve ndahen ndërmjet AAC-së dhe AIP-së, janë: Zyrtari i Auditimit të Brendshëm, Zyrtari Kryesor Financiar, Zyrtari për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyrtari për TI, Zyrtari i Prokurimit, Zyrtari Çertifikues, Zyrtari Shpenzues, Zyrtari Zotues, Zyrtari i Pasurisë, Zyrtari për Pranimin e Mallit dhe Zyrtari i të Hyrave.

Memorandumi i bashkëpunimit është duke u shfrytëzuar përmes angazhimit të Zyrtares së Prokurimit të AAC-së për AIP-në, që nga viti 2021 dhe i cili ende vazhdon.

# 11. PUBLIKIMET TEKNIKE PËR INDUSTRINË

Për t'i përkrahur operatorët në zbatimin e legjislacionit në fuqi, AAC-ja në vazhdimësi nxjerr publikime teknike për industrinë e aviacionit civil. Gjatë 2022 nuk ka pasur publikim të reja.

# 12. INFORMIMI I PUBLIKUT DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

## 12.1 Qasja në dokumente publike

Përmes Vendimit nr. 40/2022, Drejtori i Përgjithshëm ka emëruar zyrtarin per qasje ne dokumente publike të AAC-së, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike. Raporti vjetor per qasjen e dokumente publike eshte dorëzuar ne AIP sipas afatit ligjor.

## 12.2 Faqja zyrtare e AAC-së në internet

Faqja zyrtare e AAC-së në internet vazhdimisht freskohet për të reflektuar rregulloret dhe udhëzimet e reja të publikuara nga AAC-ja si dhe versionet e fundit të formularëve online që shërbejnë për aplikim ose për raportim vullnetar dhe të obligueshëm të ndodhive. Raportimi direkt online lehtëson procedurën e raportimit të ndodhive të aviacionit dhe e inkurajon atë.

# 13. BURIMET NJERËZORE

AAC-ja aktualisht ka 30 pozita të aprovuara me buxhet dhe statusi i tyre është nëpunës të shërbimit civil gjegjësisht pozita të karrierës me akt emërime. Ndërsa pozita e Drjetorit të përgjithshem zgjedhet në pajtim me nenin 24 të Ligjit përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Plani i personelit për vitin 2023 është konuliduar nga DMZP dhe planifikuar kemi dy pozita të lira të cilat priten të plotësohen sipas nevojave qe janë paraqitur.

Me hyrje në fuqi të Ligjit për Racionalizimin e Agjencive të Pavarura, ka përfunduar mandati i Bordit të AAC-së në muajin shtator, ndërsa mandati zv/drejtori i përgjithshem ka përfunduar në janar dhe kjo pozitë është shuar me ligjin për racionalizim.

Përgjatë vitit 2022 kemi pasur dy Monitorim/Auditime nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili ka audituar vitin 2020 dhe vitin 2021 monitorime të rregullta. Sipas kërkesave në raport me pyetsorin janë përgatitur dokumentet dhe janë dorëzuar pranë KPMSHCK. Ndërsa për Zyrën e Auditorin Kombëtar sipas kërkesave për vitin 2022 pas vizitës që kemi pas në AAC për veç kopjeve të dokumeteve të marrura gjatë procesit janë dërguar edhe dokumente shtesë

Në zbatim të kerkesave të DMZP/MPB për reformat në Administratë janë përgatitja e Listës së stafit të AAC-së dhe kopjet e Akt emërimeve sipas pozitave që mbajnë.

Mbështetja e grupit punues për draftin e Rregullores së brendshme sipas Vendimit përmbledhja e bazës ligjore për konsultim gjatë draftimin.

Në fund të muajit dhjetor ka filluar procesi i vlerësimit për vazhdimin e kredencialeve të inspektorë për të cilin NJBNJ ka pranuar formularët ka përgatit raportin për konfirmim te Drejtori i Përgjithshëm dhe ka proceduar ID kartelat në ASHI pas konfirmimet të vazhdimet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Mbështetja profesionale për kërkesat e pushimeve në sistemin për menaxhimin e Burimeve Njerëzore HIRMS dhe procesimin e kërkesave në dosje personale. Si dhe monitorimi i vijushmerisë në punë përmes Sistemit të Vijueshmërisë në Punë (SVP) dhe raportet e evidencës. Gjatë vitit 2022 kemi dy kërkesa për pushime pa pagesë per aftesim të larte të cilat janë procesuar me Vendime sipas akteve ligjore në fuqi.

Njoftimi i zyrtareve të AAC-së të cilët bëjnë deklarimin e pasurisë dhe informimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit për ndryshimet dhe përgatitja e listave sipas kërkesë së AKK-së.

## 13.1 Pagat e personelit të AAC-së

Niveli i pagave të personelit të AAC-së është miratuar më 20 mars 2009 dhe 25 mars 2010 nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së. Pagat e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të AAC-së janë caktuar nga Qeveria në përputhje me Nenin 20.2 të Ligjit bazik. Me hyrjen ne fuqi te Ligjit nr 08/L-196 per pagat ne sektorin publik, pagat e personelit te AAC-se do te përcaktohen bazuar me kete ligj.

Komisioni Disiplinor: Gjatë vitit 2022 ka pasuar dy raste të paraqitura një i cili i është mbyllur në komision. Ndërsa rasti dytë është mbyllur si proces nga vet komisioni.

Sa i përket ankesave ju kemi përgjigjur në kërkesat për dokumente të plotësimit të ankesave në KPMSHCK-së ne total 24 kërkesave për ankesa dhe prej ketyre kemi pranuar 20 Vendim ( një vendim i ka bashkuar 3 lëndë meqë qëllimi ankesës ka qenë i njëjtë):

Vendimet: Tetë (8) të refuzuara, Gjashtë (6) të aprovuara, tri (3) përfundim të procedurës dhe Tri (3) i detyrohen Drejtorit të Përgjithshëm për nxjerrje akt administrativ.

## 13.2 Trajnimet

AAC-ja investon në ngritjen profesionale dhe përditësimin e njohurive të specializuara të nëpunësve, në përputhje me standardet dhe praktikat e rekomanduara ndërkombëtare dhe bazuar ne Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Në kuadër të planit të trajnimeve/workshop për vitin 2022 i AAC-së dhe trajnime të mbështetura nga EASA IPA2020 ka ndjekur si më poshtë shënuar ku gjithësejt janë shtatëmbdhjet (17): Realizimi i planit të trajnimeve sipas propozimeve të zyrtareve të AAC-së dhe buxhetit të planifikuar po gjithashtu të përfshira trajnimet që mbahen në IKAP dhe të mbështetur nga IPA.

# 14. PROKURIMI

Gjatë vitit 2022 janë realizuar 11 aktivitetet e poshtëshenuara të prokurimit për furnizim dhe shërbime për nevojat e AAC-së, për të cilat janë lidhur kontratat nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Aktivitetet janë realizuar nga Departamenti për Procedura të Centralizuara dhe Departamenti për Prokurime të AQP-së në emër të autoriteteve kontraktuese në bazë të nenit 21/A të LPP-së.

1. Furnizimi me teknologji informative (TI);
2. Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative (TI) dhe pajisje tjera përcjellëse;
3. Furnizimi me ujë për pije;
4. Furnizimi me goma dimërore për vetura zyrtare;
5. Furnizimi me material të shtypur dhe shërbimet e dizajnimit;
6. Furnizimi me karburante;
7. Furnizimi me tapeta muri me foto të ndryshme;
8. Shërbimet e sigurimit të veturave;
9. Sallë për aktivitete (konferenca dhe trajnime);
10. Spote publicitare; dhe
11. Shërbime të transportit ajror.

# 15. RAPORTI FINANCIAR

AAC-ja është organizatë e vetëfinancuar buxhetore, sipas Nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, por në praktikë kjo nuk është zbatuar, edhe përkundër kërkesave te vazhdueshme nga AAC-ja. Tani dhe viteve të mëparshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e ndanë buxhetin AAC-së si grant qeveritar dhe jo si të hyra të dedikuara sipas kodit përkatës buxhetor, rrjedhimisht vetëm 47% e të hyrave vetanake i lejohen AAC-së për buxhetin e saj vjetor. Pjesa tjetër derdhet në arkën e shtetit si edhe të hyrat e tjera nga taksat dhe tatimet.

Sipas Nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ardhurat e dedikuara të AAC-së përbëhen nga:

- taksat të cilat ndërlidhen me aviacionin, detyrimet dhe tarifat;
- një përqindje nga shërbimet e navigacionit ajror që ofrohen brenda hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës;
- tarifat për sigurinë e pasagjerëve dhe tarifat e certifikimit dhe licencimit; dhe
- donacionet, grantet dhe përkrahjet (mbështetjet) tjera financiare ose teknike të caktuara për AAC-në.

Që nga 1 janari 2009, zbatohet Rregullorja nr. 2008/7 e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për përcaktimin e tarifës së sigurisë së udhëtarëve që udhëtojnë me fluturime komerciale nga Kosova. Kjo Rregullore përcakton një tarifë sigurie prej 2 euro për çdo udhëtar që niset nga Kosova me fluturime komerciale. Sipas Ligjit për Aviacionin Civil dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje, fondet e mbledhura nga kjo tarifë sigurie janë të ardhura të dedikuara për AAC-në me qëllim të mbulimit të shpenzimeve operative.

Duke filluar nga gjysma e vitit 2011, AAC-ja përmes Rregullores nr. 7/2011, e cila më pas është shfuqizuar me Rregulloren nr. 2/2015, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 5/2018, ka siguruar bazën ligjore për mbledhjen e tarifave për shërbimet të cilat ajo i ofron, që përfshijnë dhënien e licencave, lejeve, certifikatave të ndryshme dhe kryerjen e inspektimeve dhe auditimeve, në përputhje me kompetencat e AAC-së për rregullimin e aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

## 15.1 Raporti i buxhetit me shpenzime

Buxheti i miratuar i AAC-së për vitin 2022 ishte 1,004,947.47 €, pas rishikimit të buxhetit për vitit fiskal 2022, AAC-ja ka paraqitur kursime buxhetore në kategoritë ekonomike të Mallrave dhe shërbimeve dhe Shpenzimeve kapitale. Gjatë tremujorit të fundit të vitit fiskal 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendime për shkurtime dhe ndarje buxhetore, si dhe për transfere dhe rialokime të mjeteve nëpër organizatat buxhetore për vitin 2022 sipas Vendimit nr. 14/106 datë 09.11.2022, dhe Vendimit nr. 01/117 datë 29.12.2022. Pas vendimeve të Qeverisë për kursime, ndarje dhe

harmonizim, buxheti final i AAC-së ka qenë 890,447.00 €, si dhe donacioni nga Komisioni Evropian i bartur ka qenë 5,928.21 €.

Buxheti final i AAC-së në sistemin SIMFK ka qenë 896,375.21 €, duke përfshirë edhe mjetet e bartura nga donacioni i Komisionit Evropian.

Gjatë vitit fiskal 2022 AAC-ja ka shpenzuar 750,068.38 €, që rezulton se përqindja e realizimit të buxhetit final të alokuar është 84%. Në Tabelën 1 më poshtë është paraqitur buxheti final pas rishikimit dhe shkurtimeve, si dhe vlera e shpenzimeve për secilën kategori dhe përqindja e realizimit të tyre.

**Tabela 1 - Buxheti dhe shpenzimet e shprehura në përqindje (%)**

